

MIGRACIONI NË SHQIPËRI

Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave 2001

Ndalohet riprodhimii këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Copyright © INSTAT 2004



Instituti i Statistikes
Rr. Lek Dukagjini, Nr.5, Tiranë
Tel: +355 4 222411/230484
Fax: +355 4 228300
E-mail: botim_difuzion@instat.gov.al
www.instat.gov.al

ISBN 99927-973-7-1

Nxjerrja e kësaj serie studimesh me karakter social përbën një moment të rëndësishëm në jetën profesionale të INSTAT.

Informacioni i mbledhur gjatë Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2001 si dhe të dhënat e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës 2002, u përdorën si burime kryesore të dhënash për të analizuar fenomene të tilla si migracioni i dekadës së fundit, lëvizja e brendshme e popullsisë, gjendja e tregut të punës, impakti që kanë keto çështje në jetën e grave dhe burrave, në problemet e pabarazisë dhe të situatës së nivelit të jetesës, si dhe u përdor në projeksionet e popullsisë për periudhën 2001-2021.

Këto studime kanë rëndësi të veçantë për hartuesit e politikave dhe për hulumtues të disiplinave të ndryshme. Ato mund të përdoren për të kuptuar se si duhet të punohet për zbutjen e pabarazisë, si mund të investohet në infrastrukturën e shërbimeve, se si mund të ndihmohet autoritetet lokale për të hartuar politika të veçanta për grupet në nevojë.

Studimet gjithashtu hedhin dritë edhe në situatën e objektivave të mileniumit në Shqipëri dhe japin më shumë elemente për monitorimin e tyre të vazhdueshëm. Këto studime janë fryt i bashkëpunimit disamujor të ekspertëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve lokale. Gjithashtu ato janë edhe dëshmi e një rrjeti lokal studiuesish që fillon të bashkëpunojë me INSTAT, në analizimin e fenomeneve sociale.

INSTAT përfiton nga ky rast për të falenderuar Agjencinë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Zyrën për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Italisë, të cilët mbështeten dhe koordinuan punën për kryerjen e këtyre botimeve.

Milva Ekonomi

Drejtor i Përgjithshëm

HYRJE	9
1. MIGRIMI I BRENDSHËM NË SHQIPËRI	11
1.1 Gjeografia e zhvendosjeve të brendshme të migrimit.	11
1.2 Bilanci i migrimit, imigrimi, emigrimi.	14
1.3 Migrimi ndërmjet prefekturave sipas zonave urbane. rurale dhe statusi i migrimit.	15
1.4 Migracioni i popullsisë mbi bazë rrethi brenda prefekturës.	16
1.5 Migrimi neto ndërmjet rretheve.	18
2. FAKTORËT E MIGRIMIT TË BRENDSHËM	21
2.1 Struktura moshore dhe gjinore tek migrantët e brendshëm	21
2.2 Niveli arsimor i migrantëve të brendshëm	23
2.3 Gjendja ekonomike e migrantëve të brendshëm.	23
2.4 Karakteristikat e migrantëve në bazë të drejtimit të zhvendosjes	24
2.4.1 Migrimi nga verilindja në Tiranë.	24
2.4.2 Migrimi nga prefekturat e Beratit, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Shkodrës drejt Tiranës dhe Durrësit.	26
2.4.3 Migrimi nga bregdeti drejt Tiranës dhe Durrësit.	27
2.4.4 Migrimi nga prefekturat Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër drejtqendrave dytësore të Shqipërisë.	28
3. NDIKIMI I MIGRIMIT NË EVOLUCIONIN E POPULLSISË SHQIPTARE	31
3.1 Ndikimi i lëvizjeve migratore në popullsinë në përgjithësi.	31
3.1.1 Ndryshimet në strukturën e popullsisë.	31
3.1.2 Një model për të matur ndikimin e emigracionit ndërkombëtar.	34
3.2 Një ndikim i diferencuar i migracionit që varet nga tipi i vendosjes.	36
3.3 Ndikimi i migracionit në prefekturat dhe rrethet individuale.	38
3.3.1 Tirana.	40
3.3.2 Tropoja.	41
3.3.3 Saranda.	44
4. NDIKIMI I LËVIZJEVE MIGRATORE MBI ECURINË E EKONOMISË.	47
4.1 Ndikimi i migrimit mbi popullsinë në moshë pune.	47
4.1.1 Prirjet kryesore të tregut të punës.	47
4.2 Migrimi dhe zhvillimi i tregut të punës.	50
4.2.1 Ndikimi i migrimit mbi kapitalin njerëzor dhe nivelin e kualifikimit.	50
4.2.2 Ndikimi i migrimit mbi krahun aktiv të punës.	52
4.3 Ndikimi i migrimit mbi popullsinë rurale dhe urbane në moshë pune.	52
4.3.1 Ndikimi i migrimit të brendshëm mbi punësimin nëpër rrethe.	52
4.3.2 Ndikimi i migrimit të brendshëm mbi kapitalin njerëzor të rretheve.	55
4.4 Ndikimi i migrimit mbi gjendjen ekonomike të prefekturave.	56
4.4.1 Rrethi i Tiranës	56
4.4.2 Rrethi i Tropojës	58
4.4.3 Rrethet Sarandë dhe Delvinë	60
5. PËRFUNDIMET DHE GJETJET KRYESORE	63
BIBLIOGRAFIA	65

TREGUESI I GRAFIKËVE DHE I TABELAVE

Tabela 1:	Lëvizjet ndër-rajonale të migracionit (1989-2001) numri i njerëzve dhe shpërndarja në %.	12
Tabela 2:	Migracioni nga prefektura në prefekturë. Në numra dhe në përqindje, 1989-2001. Shqipëria.	13
Tabela 3:	Migracioni neto(1989-2001) dhe raporti I tij me popullsinë viteve 1989 dhe 2001 sipas prefekturave. Shqipëri.	14
Tabela 4:	Popullsia sipas statusit të migracionit (1989-2001) në bazë të vendbanimit urban/rural. Shqipëria 2001	16
Tabela 5:	Popullsia sipas statusit të migracionit (2000-2001) në bazë të zonës së vendbanimit urbane/rurale. Shqipëria 2001	16
Tabela 6 :	Zhvendosja migratore në numër dhe përqindje e emigrantëve në bazë rrethi në prefekturën e Shkodrës	17
Tabela 7:	Flukset në numër dhe në përqindje të emigracionit të përgjithshëm sipas rretheve në prefekturën e Vlorës, 1989-2001	17
Tabela 8:	Flukset në numër dhe përqindje të emigracionit të përgjithshëm sipas rretheve në prefekturën e Dibrës, 1989-2001	18
Tabela 9:	Treguesit e migracionit të brendshëm neto sipas rretheve në periudhën 1989 – 2001, prefekturat e Shkodrës, Vlorës dhe Dibrës	19
Tabela 10:	Migracioni i brendshëm neto për disa rreth në periudhën 1989-2001, Shqipëria.	19
Tabela 11.	Migrantët e brendshëm në Shqipëri në periudhën 1989-2001 sipas moshës dhe gjinisë, 2001.	22
Tabela 12:	Migrantët e brendshëm (më moshë 32 e lartë) në Shqipëri në periudhën 1989-2001 sipas gjinisë dhe nivelit të shkollimit, 2001.	23
Tabela 13:	Migrantët e brendshëm (nga moshë 22-31 vjeç) në Shqipëri në periudhën 1989-2001 sipas gjinisë dhe nivelit të arsimit, 2001.	23
Tabela 14:	Shpërndarja (në numër dhe përqindje) e migrantëve të brendshëm në Shqipëri (15 vjeç e sipër në 2001), në periudhën 1989-2001 sipas gjinisë dhe gjendjes ekonomike, 2001	24
Tabela 15:	Karakteristikat e migrimit të brendshëm nga verilindja e Shqipërisë drejt qendrës në periudhën 1989-2001, krahasuar me jo migrantët, 2001.	25
Tabela 16:	Karakteristikat e migrimit të brendshëm nga Berati, Elbasani, Gjirokastra, Korça dhe Shkodra drejt qendrës së Shqipërisë në periudhën 1989- 2001 krahasuar me jo migrantët, 2001	26
Tabela 17:	Karakteristikat e migrimit të brendshëm nga qendrat dytësore drejt qendrave kryesore të Shqipërisë në periudhën 1989-2001, krahasuar me jo migrantët, 2001.	27
Tabela 18:	Karakteristikat e migrimit të brendshëm nga zonat e brendshme të vendit drejt qendrave dytësore të Shqipërisë në periudhën 1989-2001, krahasuar me jo migrantët, 2001.	29
Tabela 19:	Treguesit kryesorë demografikë, Shqipëri 1989 dhe 2001.	33
Tabela 20:	Ndikimi i migracionit: treguesit demografikë që burojnë nga popullsia vëzhguar dhe e simuluar. 1989-2001	35
Tabela 21:	Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit dhe gjinisë, Shqipëria 1989 dhe 2001	38

Tabela 22:	Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit, gjinisë dhe moshës, shqipëri 1989-2001	38
Tabela 23:	Treguesit demografikë sipas prefekturave dhe rretheve të vendbanimit, Shqipëri 1989 dhe 2001	39
Tabela 24:	Treguesit e krahut të punës, Shqipëria 1989 dhe 2001	49
Tabela 25:	Shpërndarja e popullsisë së punësuar sipas gjinisë dhe moshës, Shqipëria 1989 dhe 2001	49
Tabela 26:	Shpërndarja e popullsisë 6 vjeç e lart sipas nivelit të arsimit, Shqipëria 1989 dhe 2001	51
Tabela 27:	Shpërndarja e popullsisë në moshë pune sipas nivelit të arsimit, Shqipëria, 2001.	51
Tabela 28:	Treguesit e krahut të punës sipas vendbanimit, Shqipëria 1989 dhe 2001	53
Tabela 29:	Ecuria dhe shpërndarja e popullsisë të punësuar sipas vendbanimit, gjinisë dhe moshës, Shqipëria 1989-2001.	54
Tabela 30:	Shpërndarja e popullsisë me moshën 6 vjeç e lart sipas nivelit të arsimit dhe vendbanimit, Shqipëria, 1989-2001	55
Tabela 31:	Popullsia e arsimuar në moshë pune, sipas nivelit arsimor, gjinisë dhe vendbanimit, Shqipëria 2001.	56
Tabela 32:	Treguesit e krahut të punës (sipas përkufizimit në 1989 dhe 2001). Rrethet e Shqipërisë 1989 dhe 2001.	57
Tabela 33:	Treguesit e krahut të punës. Rrethi i Tiranës, 1989 dhe 2001.	57
Tabela 34:	Treguesit e krahut të punës. Rrethi i Tropojës, 1989 dhe 2001.	59
Tabela 35:	Treguesit e krahut të punës. Rrethet e Sarandës dhe Delvinës, 1989 dhe 2001.	60
Figura 1:	Migrantët e brendshëm të Shqipërisë në periudhën 1989-2001 sipas gjinisë dhe moshës, 2001.	22
Figura 2.	Ecuria e popullsisë së Shqipërisë 1950-2000.	32
Figura 3:	Piramida e moshës, Shqipëri 1989-2001.	33
Figura 4:	Ecuria e madhësisë së grupmoshave në periudhën 1989-2001, Shqipëri	34
Figura 5:	Krahasimi i strukturës së moshës të popullsisë shqiptare me dhe pa migrim, 2001	35
Figura 6.	Piramida e moshës sipas banimit, Shqipëri 1989- 2001	37
Figura 7:	Piramida e moshës, rrethi i Tiranës 1989, 2001	41
Figura 8:	Piramida e moshës, rrethi i Tropojës 1989, 2001	43
Figura 9:	Raporti gjinor i popullsisë vendase dhe popullsisë që emigroi ose vdiq (1989-2001), Rrethi i Tropojës, 2001	44
Figure 10:	Piramida e moshës, rrethi i Sarandës 1989, 2001	45
Figura 11.	Piramida e moshës së popullsisë në moshë pune, Albania 1989 dhe 2001	48
Figura 12.	Piramida e popullsisë të punësuar (15 vjeç e lart), sipas vendbanimit, Shqipëria 1989 dhe 2001.	54
Figura 13.	Piramida e moshës e popullsisë në moshë pune. Rrethi i Tiranës, 1989 dhe 2001.	58
Figura 14.	Piramida e moshës e popullsisë në moshë pune. Rrethi i Tropojës, 1989 dhe 2001.	59
Figura 15.	Piramida e moshës e popullsisë në moshë pune. Rrethi i Sarandës dhe Delvinës, 1989 dhe 2001.	61

Popullsia shqiptare ka pësuar ndryshime të thella gjatë 12 viteve të fundit për shkak të procesit të tranzicionit drejt demokratizimit të strukturave politike dhe ekonomike. Ky proces u vu re gjatë periudhës së trazirave politike dhe ekonomike, të cilat nxitën shumë të rinj shqiptarë të linin vendin.

Ky studim përqipet të analizojë migrimin e popullsisë shqiptare, një fenomen madhor që ka shoqëruar periudhën e tranzicionit në Shqipëri duke u bazuar në të dhënat e Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave të 2001.

Studimi synon të analizojë migrimin e brendshëm (migrimi brenda vendit Kapitulli 1 dhe 2) si edhe migrimi ndërkombëtar (Kapitulli 3 dhe 4). Duke u bazuar në faktin që emigracioni shqiptar gjatë viteve '90 ishte një nga ngjarjet demografike më dramatike që u vërejt në Evropë, studimi i lëvizjeve të migrimit merr një rëndësi të madhe. Për këtë arsye, përshkrimi i emigracionit si edhe migrimit të brendshëm në Shqipëri mbi bazën e të dhënave të vrojtimit paraqet një interes të veçantë. Kapitulli i parë analizon shpërndarjen në hapësirë të migrimit të brendshëm; Kapitulli i dytë studion karakteristikat sociale dhe ekonomike të migrantëve në krahasim me ata që nuk migrojnë. Ai gjithashtu përshkruan katër shpërnguljet kryesore të brendshme. Kapitulli 3 bën vlerësimin e ndikimit të migrimit ndërkombëtar në madhësinë dhe strukturën e popullsisë shqiptare. Ai, gjithashtu, jep disa informacione mbi ndikimin e migrimit të brendshëm dhe ndërkombëtar në situatën demografike të rajoneve dhe të prefekturave. Kapitulli 4 tenton të bëjë lidhjen ndërmjet migrimit dhe zhvillimit ekonomik për të bërë vlerësimin e ndikimit të migrimit në ekonominë rajonale dhe kombëtare. Migrimi i brendshëm dhe ai ndërkombëtar në Shqipëri karakterizohet nga disa faza të ndryshme. Tradicionalisht, Shqipëria është një vend emigracioni. Në shekujt 15-17 si rezultat i pushtimit të

Shqipërise nga perandoria turke, pati një emigracion masiv të shqiptarëve përtej brigjeve, në Itali. Më vonë, gjatë pjesës së parë të shekullit të 20, u vunë re tri periudha emigracioni: ndërmjet viteve 1912 dhe 1923, ekonomia bujqësore ishte rrënuar si pasojë e Luftës së Parë Botërore. Përveç kësaj, mungesa e industrisë dhe shpërdorimi i pasurive natyrore solli si pasojë faktin që 21 000 familje shqiptare lanë atdheun e tyre. Ndërmjet 1923 dhe 1939, prapambetja ekonomike dhe pasiguria politike detyroi 110 000 persona të emigrojnë. Dhe së fundi, gjatë periudhës

1940-1945, afërsisht 19 000 persona kanë emigruar, shumë nga të cilët ishin kundërshtarë politikë të regjimit komunist që erdhi në pushtet (PZHKB, 2000). Me vendosjen e regjimit komunist, pas luftës së dytë botërore, emigracioni nga Shqipëria ishte i ndaluar, ndërsa migrimi i brendshëm ishte i kufizuar¹.

Faza e parë (1950-1960), karakterizohet nga strategjia komuniste e përshpejtimit të zhvillimit të një sektori dytësor (industrisë dhe ndërtimit), më shumë se sa të sektorit tercial, migrimi i brendshëm nga zonat rurale në ato urbane ishte i kontrolluar dhe i orientuar, por jo totalisht i ndaluar. Faza e dytë (1961-1990) u karakterizua nga një strategji kufizimesh të migrimit të brendshëm nga zonat rurale në ato urbane, duke provuar, por pa sukses, të shpërnguljen popullsisë nga zonat rurale në ato urbane.

Kjo politikë thelloi shumë vetizolim nga bota e jashtme nga njëra anë dhe nga ana tjetër, burimet e investimeve ranë si për shembull procesi i zhvillimit ekonomik dhe social. Rënia e regjimit komunist, shkaktoi lëvizje të mëdha të popullsisë. Kjo fazë që filloi në 1991, përkoi më periudhën e tranzicionit dhe u karakterizua nga mungesa e politikave përsa i përket migrimit të brendshëm dhe atij

¹ Raporti i Zhvillimit Njerëzor për Shqipërinë - 2000

ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhe, si rezultat i ndryshimeve në vend, kontrolli i lëvizjes së lirë të popullsisë u hoq dhe zonat urbane, veçanërisht Tirana, në krahasim me ato rurale, patën një zhvillim disproporcional. Nga zonat rurale, afërsisht 900 000 persona migruan drejt zonave urbane në brendësi të vendit gjithashtu edhe drejt vendeve të tjera. Kjo gjë solli, sipas të dhënave të Regjistrimit të 2001, rënie të popullsisë në zonat rurale (13%) në krahasim me të dhënat e Regjistrimit të 1989, ndërkohë që, në periodat e mëparshme, rritja e popullsisë në zonat rurale ishte rritur me 20%.

Për më tepër, migrimi ndërkombëtar i shqiptarëve, më së shumti në vendet perëndimore dhe veçanërisht në Greqi dhe Itali, është një nga shpërnguljet më mbresëlënëse gjatë shekullit të 20 në Evropë. Si rezultat i shumë faktorëve politikë, ekonomikë dhe socialë, në fund të vitit 1990 u vunë re disa fenomene që paralajmëruan shpërthimin migrues të qyteteve shqiptare. Në korrik të vitit 1990, afërsisht 5 000 persona hynë në ambasadat italiane, gjermane dhe franceze në Tiranë dhe kërkuan viza. Në fund të vitit 1990, afërsisht 20 000 shqiptarë lanë vendin duke u drejtuar për në Greqi dhe kërkuan strehim politik. Në mars 1991, shumë qytetarë shqiptarë hynë në portin e Durrësit, më i madhi në Shqipëri, në mënyrë që të largoheshin nga Shqipëria me anije. Ata arritën në portet e Italisë së Jugut. Një tjetër zhvendosje që përfshiu rreth 18 000 njerëz ndodhi në të njëjtin vit në gusht. Qeveria italiane i refuzoi ata në mënyrë kategorike dhe brenda një periudhe të shkurtër, pjesa dërrmuese e këtyre emigrantëve u kthye në Shqipëri. Emigracioni i padokumentuar u rrit gjatë viteve në vijim. Gjatë periudhës 1989-2001, afërsisht 700 000 shqiptarë u larguan nga vendi (shih menjëherë Mbret et al., 1998; Bajraba et al 1992; Bajraba et Peronne, 1996).

Këto lëvizje migratore patën një ndikim jo vetëm në numrin absolut të popullsisë dhe të

shpërndarjes së saj gjeografike, por gjithashtu edhe në strukturën e brendshme të popullsisë (në lidhje me raportet e seksit dhe moshës si dhe me përbërjen e saj shoqërore-ekonomike), dhe në funksionimin e përgjithshëm të ekonomisë dhe në infrastrukturën e vendit duke përcaktuar kështu potencialin e mëtejshëm të zhvillimit të vendit. Migracioni gjithashtu pati një ndikim të madh në ekonomi si një faktor që ushtron ndikim në bilancin tregtar (duke transferuar para brenda vendit nga jashtë). Pa dyshim, është e vështirë të bësh një vlerësim të përpiktë se cili ka qenë ndikimi i migrimit të brendshëm dhe migracionit ndërkombëtar, meqenëse ekzistojnë faktorë të tjerë politiko-shoqëror që ndikojnë gjithashtu në veprimtarinë e ekonomisë shqiptare.

Emigraconi shqiptar ende vazhdon dhe është në periudhën e tranzicionit nga emigracioni ilegal dhe i paorganizuar, në një emigracion legal dhe të organizuar. Emigrantët shqiptarë në të shumtën e rasteve punojnë në sektorë që nuk janë të preferuar nga vendasit dhe pjesa dërrmuese e tyre kanë paga të papërcaktuara, ata shërbejnë si mekanizëm rregullues në tregun e punës dhe kontribuojnë në rritjen e prodhimit vendas të vendit pritës. Megjithatë, në proceset migratore është përfshirë gjerësisht edhe elita intelektuale, e cila ka disa tipare të ndryshme nga ato të grupeve të ndryshme sociale që kanë emigruar.

Njohja e realitetit të migrimit eventualisht është një element i rëndësishëm për të formuluar politikat dhe për të realizuar një zhvillim social dhe ekonomik. Për më tepër, në kuadrin e zgjerimit evropian dhe të formulimit të një politikë të migrimit evropian, migrimi nga Shqipëria, është bërë një përparësi për shkak të numrit të migrantëve dhe të pozicionit gjeografik të Shqipërisë.

1

Migrimi i Brendshëm në Shqipëri**1.1 Gjeografia e zhvendosjeve të brendshme të migrimit.**

Migrimi i brendshëm mund të përkufizohet duke u bazuar në dy dimensione: dimensionin hapësinor, (migrimi ndërmjet dy rajoneve, dy prefekturave ose dy rretheve), dhe migrimi i përkohshëm, (sipas të dhënave në dispozicion, migrimi nga data e lindjes deri në vitin 2000, nga 1989 në 2001, nga 2000 në 2001). Disa analiza flasin qartë për një ndërvarje të fortë ndërmjet migrimit afatshkurtër ose migrimit të kohëve të fundit (2000-2001) dhe migrimit afatmesëm (1989-2001). Për këtë arsye, ne vendosëm të bëjmë komente vetëm për migrimin afatmesëm dhe të japim informacion përse i përket migrimit të kohëve të fundit, vetëm kur ky informacion mund të plotësojë analizën. Përse i përket migrimit afatgjatë, vendi i lindjes është një tregues i qartë i zhvendosjes gjatë të gjithë jetës, por ky variabël është i vështirë të interpretohet për shkak të mungesës së informacionit lidhur me biografinë e migrantëve. Migranti këtu është përkufizuar si

Shqipëria pësoi lëvizje ndërkombëtare të migrimit gjatë dekadës së fundit, por ajo, gjithashtu pati edhe lëvizje të mëdha të migrimit të brendshëm. Përse i përket migrimit të brendshëm, nuk është e lehtë të përshkruash shumëllojshmërinë e lëvizjeve. Megjithatë, në këtë kapitull ne do të përpiqemi të parashtrojmë një pikëpamje për zhvendosjen në hapësirë të popullsisë shqiptare mbi bazën e informacionit të Regjistrimit të 2001². Migrimi i brendshëm, nga pikëpamja demografike, së pari tregon për shkallën e ndryshimit të shpërndarjes në hapësirë gjatë një periudhe të caktuar. Së dyti, në vlera absolute, migrimi është pjesë e një rritjeje ose uljeje numerike të popullsisë. Për këto arsye, migrimi është pjesë e zhvillimit demografik të rajoneve si edhe tregues i ndryshimeve sociale si urbanizimi. Pjesa e parë e këtij kapitulli përshkruan tendencat kryesore të migrimit të brendshëm; paragrafi i dytë merret me bilancin e migrimit brenda prefekturave, ndërsa pjesa e tretë i referohet karakteristikave urbane dhe rurale të migrimit.

person, i cili ka ndryshuar prefekturën e vendbanimit ndërmjet viteve 1989-001. Disa analiza flasin për një ndërvarje ndërmjet migrimit afatmesëm dhe migrimit që nga lindja deri më 2001, ndaj dhe ky i fundit nuk është komentuar në këtë kapitull. Tabela 1 paraqet shifra absolute të migrantëve ndërrajonale në bazë të drejtimit të zhvendosjes. Duke analizuar këtë tabelë e cila

²Këtu duhet të marrim parasysh disa kufizime të të dhënave: së pari të dhënat e vrojtimit na lejojnë vetëm të përcaktojmë lëvizjet e brendshme mbi bazë të vendbanimit në lindje, në 1989, në 2000, dhe në 2001. Për pasojë ka një numër të panjohur të lëvizjeve ndërmjet këtyre datave të cilat ne nuk mund t'i vëzhgojmë. Së dyti ne jemi në gjendje të përcaktojmë vetëm migrantët e brendshëm, të cilët akoma jetojnë në Shqipëri në 2001. Çdo migrant i cili doli jashtë shtetit (si hapi i dytë i projektit të tij për migrimin) ose ka vdekur nuk mund të vrojtohej në 2001.



Tabela 1: Lëvizjet ndër-rajonale të migracionit (1989-2001)

– Numri i njerëzve dhe shpërndarja në %

Rajoni i nisjes	Rajoni i mbërritjes			
	Veri-Lindje	Qendër-Bregdet	Jug-Lindje	Gjithsej
Veri-Lindje	-	107433	1465	108898
në %		98.7	1.3	100.0
Qendër/Bregdet	2491	-	11721	14212
në %	17.5		82.5	100.0
Jug-Lindje	1273	58256	588967	59529
në %	2.1	97.9	-	100.0
Gjithsej	410180	1341509	602153	182639

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

i referohet periudhës 1989-2001, ne mund të përmendim fenomenin e mëposhtëm; Sipas Regjistrimit 2001; 182 600 persona që jetonin në Shqipëri në 2001 u zhvendosën nga një rajon³ tek tjetri ndërmjet 1989 dhe 2001. Këta migrantë përfaqësojnë 5.7% të popullsisë së përgjithshme në 1989. Migrimi i brendshëm në Shqipëri është qartësisht një migrim në një drejtim: rreth 91% e migrantëve ndër-rajonalë kanë lëvizur drejt qendrës dhe bregdetit; verilindja dhe juglindja pësuan vetëm 2% dhe 7% të zhvendosjeve totale të imigrimit. Rreth 60% e migrantëve jetonin në veri në 1989, 32% në jug dhe 8% në qendër-bregdet. Ndaj dhe rajoni i qendrës dhe ai bregdetar ka një rritje të lartë të popullsisë si rezultat i migrimit ku popullsia imigrante për periudhën 1989-2001 ka qenë 44 herë më e madhe se sa ajo në rajonin verilindje dhe 13 herë më e madhe se sa ajo në rajonin juglindor. Këtu ne mund të nxjerrim disa konkluzione:

- Rajonet veriore dhe jugore kanë të njëjtin profil migrator dhe popullsia e brendshme e rajoneve është drejtuar kryesisht drejt rajonit qendror/bregdetar.

- Ka një lëvizje relativisht të madhe nga qendra/bregdeti në juglindje. Kjo tregon që

³Këtu janë përfshirë 3 rajone: qendrore/bregdetare (përfshirë prefekturat e Tiranës, Durrësit, Lezhës, Fierit, Elbasanit; verilindja (përfshirë Shkodër, Kukës, Dibër); juglindja (përfshirë Berat, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë).

Rajoni i Jugut gjithashtu ka pësuar zhvillim, 82,5% e popullsisë se qendrës/bregdetit e cila emigroi, u vendos në rajonin jugor.

- Duke mbajtur parasysh intensitetin e emigracionit ndërkombëtar që ka qenë i lartë në rajonin juglindor (shih kapitullin 3), migrimi brendshëm drejt rajonit të jugut dhe emigracioni i lartë nga rajonet e veriut drejt qendrës, flasin për një shkallë të lartë të prapambetjes ekonomike të rajonit të veriut, ku investimet kanë qenë relativisht të kufizuara. Zhvillimi ekonomik i rajonit nuk është, megjithatë, faktori i vetëm i migrimit veri-qendër (shih për shembull Massey et al., 1993). Faktorë të tjerë si strategjia e familjes, arsimit ose shëndetësia mund të luajnë, gjithashtu, një rol. Ndërsa 182 600 persona u zhvendosën nga një rajon në tjetrin (Tabela 2), migrimi ndërmjet prefekturave⁴ numëron 252 700 persona (Tabela 3). Kjo do të thotë që dy migrimeve ndër-rajonale ju përgjigjën një migrim ndër-rajonal dhe një ndër-prefekturë. Kjo, logjikisht, të çon në faktin që sa më e detajuar të jetë ndarja administrative aq më e lartë është shkalla e migrimit.

Zhvendosjet e brendëshme migratore nuk u bënë vetëm ndërmjet prefekturave, por edhe ndërmjet rrethëve të së njëjtës prefekturë, ndërmjet komunave dhe ndërmjet fshatrave dhe qytetit. Migrimi ndërmjet prefekturave përcaktohet pjesërisht nga niveli i prapambetjes ekonomike të prefekturave nga ku bëhet zhvendosja, si prefektura e Dibrës ashtu edhe e ajo Kukësit ku banonin 37% e popullsisë së migruar në 1989⁵. Të dy këto rajone karakterizohen nga varfëri ekonomike. Këto rrethë kanë një numër të madh familjesh që marrin ndihmë ekonomike: 40% e familjeve në Kukës dhe 34% e familjeve në Dibër, krahasuar më mesataren për 12% në të gjithë vendin, (INSTAT 2000). Këto

⁴Shqipëria aktualisht ka 12 prefektura dhe 36 rrethë.

⁵Duhet të theksohet përsëri se faktorë të tjerë mund të shpjegojnë një pjesë të këtyre zhvendosjeve të migrimit. Mungesa e pyetjeve në Vrojtim lidhur më arsyet pse migrohet, nuk na jep mundësi për të zhvilluar këtë diskutim.

Tabela 2: Migracioni nga prefektura në prefekturë. Në numra dhe në përqindje, 1989-2001. Shqipëria

Prefektura e nisjes	Prefektura e mbërritjes												
	Berat	Dibër	Durrës	Elbas.	Fier	Gjirok.	Korce	Kukes	Lezhe	Shkod.	Tiranë	Vlorë	Gjithsej
Berat	0	97	4241	951	5824	1034	1148	348	164	529	8773	2567	25676
në %	0.0	0.4	16.5	3.7	22.7	4.0	4.5	1.4	0.6	2.1	34.2	10.0	100.0
Dibër	72	0	10997	964	1144	47	116	153	2134	281	32898	278	49084
në %	0.1	0.0	22.4	2.0	2.3	0.1	0.2	0.3	4.3	0.6	67.0	0.6	100.0
Durrës	51	62	0	149	221	38	232	18	902	108	5397	110	7288
në %	0.7	0.9	0.0	2.0	3.0	0.5	3.2	0.2	12.4	1.5	74.1	1.5	100.0
Elbasan	826	64	5191	0	5618	197	2313	38	197	105	11076	1020	26645
në %	3.1	0.2	19.5	0.0	21.1	0.7	8.7	0.1	0.7	0.4	41.6	3.8	100.0
Fier	1881	117	2042	1201	0	443	444	39	126	65	7560	2618	16536
në %	11.4	0.7	12.3	7.3	0.0	2.7	2.7	0.2	0.8	0.4	45.7	15.8	100.0
Gjirokaster	600	5	1817	183	2074	0	705	15	30	85	7634	3950	17098
në %	3.5	0.0	10.6	1.1	12.1	0.0	4.1	0.1	0.2	0.5	44.6	23.1	100.0
Korce	324	31	3718	2170	1545	272	0	8	99	44	13848	1410	23469
në %	1.4	0.1	15.8	9.2	6.6	1.2	0.0	0.0	0.4	0.2	59.0	6.0	100.0
Kukes	42	287	6728	79	1489	47	117	0	1106	1285	31769	229	43178
në %	0.1	0.7	15.6	0.2	3.4	0.1	0.3	0.0	2.6	3.0	73.6	0.5	100.0
Lezhe	62	361	3390	184	693	38	163	79	0	1137	5522	316	11945
në %	0.5	3.0	28.4	1.5	5.8	0.3	1.4	0.7	0.0	9.5	46.2	2.6	100.0
Shkodër	47	543	2670	79	726	30	180	223	5758	0	8892	260	19408
në %	0.2	2.8	13.8	0.4	3.7	0.2	0.9	1.1	29.7	0.0	45.8	1.3	100.0
Tiranë	142	81	3647	667	632	139	309	95	138	122	0	379	6351
në %	2.2	1.3	57.4	10.5	10.0	2.2	4.9	1.5	2.2	1.9	0.0	6.0	100.0
Vlorë	213	34	418	140	1377	401	147	23	43	54	3207	0	6057
në %	3.5	0.6	6.9	2.3	22.7	6.6	2.4	0.4	0.7	0.9	52.9	0.0	100.0
Gjithsej	4260	1682	44859	6767	21343	2686	5874	1039	10697	3815	136576	13137	252735
në %	1.7	0.7	17.7	2.7	8.4	1.1	2.3	0.4	4.2	1.5	54.0	5.2	100.0

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

prefektura kanë pasur një nivel të ulët ekonomik të zhvillimit si për shembull: industri te vjetra, të cilat u shkatërruan krejtësisht gjatë periudhës së tranzicionit në rrethe si Elbasani, Berati dhe Korça. 29% e numrit të përgjithshëm të emigrantëve kanë ardhur nga këto prefektura.

Vlora, Tirana dhe Durrësi kanë nivelin më të ulët të migrimit që përfaqëson 7% të numrit të përgjithshëm të migrimit. Në vlera relative, prefekturat që kanë pasur numrin më të lartë të popullsisë së përgjithshme që kanë emigruar janë: së pari Dibra, e ndjekur nga Kukësi, Elbasani dhe Berati. Për sa i përket prefekturave pritëse, Tirana renditet e para, e ndjekur nga Durrësi, Fieri dhe Vlora. 72% e numrit të përgjithshëm të emigrantëve jetojnë në Tiranë dhe në Durrës sipas Regjistrimit të 2001. Rajoni tjetër i rëndësishëm pritës është

Fieri, i ndjekur, sipas rëndësisë, nga Vlora, Lezha dhe Elbasani. Duke analizuar tabelën e migracionit nga prefektura në prefekturë gjatë periudhës 12 vjeçare 1989-2001, dallojmë dy tipe të ndryshëm të migrimit: i pari, migrim në distanca të gjata, i drejtuar në polet kryesore ekonomike në qendër të vendit; i dyti, migrim në distanca disi të shkurtra në drejtim të bregdetit, i cili është një rajon imigrimi dhe emigrimi.

Tirana përbën më shumë se gjysmën e zhvendosjeve ndër-prefektura ndërmjet viteve 1989-2001 (136 600 migrantë kanë ardhur nga prefekturat e tjera nga i gjithë vendi). Durrësi që është zona e dytë më tërheqëse dhe ka më shumë se 18% të migrantëve (44 900). 36.5% (92 300) e migrantëve jetonin në prefekturën e Kukësit dhe të Dibrës në 1989; 70% e migrantëve nga Kukësi dhe Dibra



shkuan në Tiranë dhe 20% në Durrës. Një tjetër prefekturë, ajo e Korçës, në 1989 ishte prefektura e 10% e migrantëve që shkonin në Tiranë dhe 8% e atyre që shkonin në Durrës. Rajonet e tjera patën një numër të ulët të migrantëve që lëvizën nga prefektura në prefekturë dhe në-rajon. Kjo do të thotë që kishte një komunitet homogjen dhe dominues emigrantësh, me një lloj solidariteti të vecantë, që ndikon në drejtimin e zhvillimit të rajonit.

Lloji i dytë i migrimit është ai që bëhet në distancë të afërt. Në të vërtetë, një numër i madh i poleve të vendosur pranë bregdetit thithin popullsinë migruese që vjen nga pjesët e brendshme të vendit dhe të prefekturave fqinje. Në jug të vendit, Fieri paraqitet të jetë një prefekturë tërheqëse për migrantët e ardhur nga Berati (23% e migrantëve shkojnë në Fier), Elbasani (21%) dhe Vlora (23%). Edhe Vlora mund të konsiderohet si një pol në vetvete, mëqenëse prefektura ishte vendi i mbërritjes së 10% të migrantëve që linin prefekturën e Beratit, 16% e atyre që linin Fierin dhe 23% e atyre që linin Gjirokastrën. Në veri të vendit, Lezha është destinacioni i 30% të emigrantëve nga Shkodra dhe 12% e tyre nga Durrësi. Nëse marrim parasysh vetëm periudhën 2000-2001, duket që gjeografia e migrimit ishte

lehtësisht e ndryshme. U vu re një tendencë për të ekuilibruar lëvizjet dhe Tirana numëron vetëm për 44% të imigrantëve, (10% më pak se sa gjatë periudhës 1989-2001). Disa prefektura si Gjirokastra, Shkodra, Kukësi dhe Dibra flasin për një rritje të imigrimit krahasuar në të gjithë periudhën 1989-2001. Kjo situatë, që duhet të verifikohet në të ardhmen, mund të shpjegohet me dy arsye; së pari, politikën ekonomike pas rënies së firmave piramidale në 1997, kanë shumë mundësi të ketë çuar drejt një decentralizimi. Së dyti, ka mundësi që të jenë kthyer disa nga të zhvendosurit. Këto janë hipoteza që duhet të vërtetohen.

1.2 Migrimi neto, imigrimi, emigrimi.

Krahasimi i migrimit të brendshëm neto (imigrantë – emigrantë), sipas prefekturave dhe numrit të përgjithshëm të popullsisë banuese në 1989, është paraqitur në tabelën 3. Pra siç vumë re, prefekturat që janë pranë zonave verilindore të vendit kanë një emigracion neto negativ⁶ (bilanci i migracionit), i cili përfaqëson më shumë se 20% të popullsisë vendase të vitit 1989 (-29% në Kukës –21% në Dibër). Më fjalë të tjera, më pak se 1/3 e popullsisë së tyre u largua nga prefektura për t'u vendosur në një prefekturë

Tabela 3: Migracioni neto (1989-2001) dhe raporti i tij me popullsinë e viteve 1989 dhe 2001 sipas prefekturave. Shqipëri.

Prefektura	Popullsia 1989	Popullsia 2001	Imigrantë të brendshëm	Emigrantë të brendshëm	Bilanci i migrimit të brendshëm	Emigrimi i popullsisë në % 1989	Imigrimi i popullsisë në % 2001	Indeksi i efikasitetit të migrimit
			1989-2001	1989-2001				
Berat	222901	193020	4260	25676	-21416	11.5	2.2	-0.7
Dibër	226324	189854	1682	49084	-47402	21.7	0.9	-0.9
Durrës	218530	245179	44859	7288	37571	3.3	18.3	0.7
Elbasan	357497	362736	6767	26645	-19878	7.5	1.9	-0.6
Fier	379342	382544	21343	16536	4807	4.4	5.6	0.1
Gjirokastrë	155998	112831	2686	17098	-14412	11.0	2.4	-0.7
Korçë	311448	265182	5874	23469	-17595	7.5	2.2	-0.6
Kukës	146081	111393	1039	43178	-42139	29.6	0.9	-1.0
Lezhë	165254	159182	10697	11945	-1248	7.2	6.7	-0.1
Shkodër	285258	256473	3815	19408	-15593	6.8	1.5	-0.7
Tiranë	449228	597899	136576	6351	130225	1.4	22.8	0.9
Vlorë	264556	192982	13137	6057	7080	2.3	6.8	0.4

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 1989 dhe 2001

tjetër brenda vendit. Prefekurat e vendosura në pjesën e brendshme të Shqipërisë kanë humbur 11% (Berat dhe Gjirokastrë) dhe 7% (Korçë, Elbasan dhe Shkodër) për shkak të migrimit të brendshëm.

Migrimi, teorikisht, mund të ndikojë në dallimet e të ardhurave dhe të standarteve të jetesës, duke krijuar në këtë mënyrë një ekuilibër relativ ndërmjet burimeve natyrore dhe potencialeve të prodhimit në rajon. Duket që karakteri kaotik dhe shpërthyes i emigracionit të brendshëm në Shqipëri ka krijuar disa çrregullime ekonomike, sociale dhe demografike në prefekurat pritëse. Në të gjitha prefekurat janë vërejtur dallime të mëdha në nivelet e imigrimit, të cilat mund të shihen në raportin e migrantëve kundrejt popullsisë rezidente në 2001, siç është paraqitur edhe në Tabelën 3. Imigrantët e prefekurave të Tiranës dhe të Durrësit përbëjnë përkatësisht 23% dhe 18% të popullsisë së përgjithshme banuese në 2001. Në prefekurat e Vlorës, Lezhës dhe Fierit, ky tregues është përkatësisht 9%, 7% dhe 6% ndërsa në prefekurat e tjera ky tregues është në një nivel të papërfillshëm, nën 3%. Më gjithë faktin që migrimi në përgjithësi mendohet të ketë ndikim pozitiv në popullsinë pritëse, këto nivele të imigrimit në zonat si Tiranë dhe Durrës, kanë pasur pasoja negative ndër të cilat mund të përmendim:

1. Procesi i integritit të imigrantëve është i vështirë dhe pothuajse i pamundur. Përvoja ka treguar që është i mundshëm një nivel i mirë i integritit vetëm në qoftë se imigrimi është i rregullt dhe jo në nivele të larta.
2. Imigrantët kanë krijuar disekuilibër në të gjithë elementët e ekosistemit të pajisjeve urbane si: banesat, kanalizimet, ujësjellësat, infrastruktura, energjia elektrike, arsimit etj. Ky disekuilibër përkeqëson treguesit e standartit urban të jetesës. Kjo do të thotë që ne do të kemi një rritje të nivelit të urbanizimit dhe ulje

të nivelit të urbanizimit që përfaqëson mënyrën urbane të jetesës.

3. Një dinamikë e tillë e imigrimit bën të nevojshme rritjen e investimeve të karakterit demografik dhe gjithashtu është i shoqëruar me fenomenet e tilla si rritje e papunësisë dhe e tregut informal, etj.

1.3 Migrimi ndërmjet prefekurave sipas zonave urbane / rurale dhe statusi i migrimit.

Migrim gjithashtu do të thotë një modifikim i mënyrës së jetesës, veçanërisht kur migrantët vijnë nga zonat rurale dhe vendosen në zonat urbane⁷. Në disa vende, lëvizjet migruese janë shpesh rezultat i eksodit rural dhe çojnë në urbanizimin e shoqërisë. Duke përkrahur migrimin ndërmjet prefekurave në bazë të zonave urbane dhe rurale për periudhën 1989-2001, Tabela 4 tregon se 253 700 persona kanë migruar në total, nga të cilët, afërsisht 146 000 persona kanë migruar në zonat urbane (58%). Kjo flet për një përfshirje relativisht të barabartë nga qyteti dhe fshati. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin që vetëm 22% e jo migrantëve jetojnë në qytet, migrimi ka intensifikuar urbanizimin e qytetit. Pothuajse të gjitha prefekurat më një bilanc pozitiv migrator kanë pësuar një rritje të popullsisë urbane. Për më tepër 62% të imigrantëve në Durrës dhe 62% e atyre të Elbasanit janë vendosur në zonat urbane (Tabela 4). Gjatë periudhës 1989-2001, Dibra, Fieri dhe Lezha patën nivelin më të lartë të imigrimit më karakter rural. Vlora, Durrësi dhe Tirana patën nivelet më të ulta. Në këto prefektura, përveç Tiranës, është vënë re një përforcim i urbanizimit të migracionit. Krahasimi me periudhën 2000 - 2001 (shih Tabelën 5), flet për imigrim rural që është veçanërisht i lartë në zonat e vjetra të emigrimit: Dibra,

⁶Përcaktuar si diferenca ndërmjet imigrimit dhe emigrimit

⁷Në këtë tekst janë përdorur përkufizimet shqiptare për zonat urbane dhe rurale.



Tabela 4: Popullsia sipas statusit të migracionit (1989-2001)
në bazë të vendbanimit urban/rural. Shqipëria 2001

Prefektura e mbërritjes	Jo migrantë				Migrantë*			
	Rurale		Urbane		Rurale		Urbane	
	në %	Numrat	në %	Numrat	në %	Numrat	në %	Numrat
Berat	58.9	85875	41.1	59802	57.0	2428	43.0	1832
Dibër	80.2	108780	19.8	26800	76.0	1278	24.0	404
Durrës	46.4	66118	53.6	76225	37.7	16898	62.3	27961
Elbasan	65.1	173425	34.9	93079	38.2	2585	61.8	4182
Fier	66.2	180963	33.8	92448	71.7	15298	28.3	6045
Gjirokaster	60.8	52831	39.2	34016	48.9	1314	51.1	1372
Korce	63.0	129261	37.0	76060	53.4	3136	46.6	2738
Kukes	75.5	58372	24.5	18991	67.9	706	32.1	333
Lezhe	69.6	75634	30.4	33106	61.7	6597	38.3	4100
Shkodër	61.8	117913	38.2	72788	53.1	2025	46.9	1790
Tiranë	33.2	109543	66.8	220726	37.2	50748	62.8	85828
Vlorë	48.0	66437	52.0	71914	28.2	3710	71.8	9427
Total	58.3	1225152	41.7	875955	42.2	106723	57.8	146012

* Banorë të një prefekturë tjetër në 1989.

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

Gjirokastra dhe Shkodra, të cilat kanë patur një nivel të lartë migrimi rural. Duke patur parasysh faktin që popullsia mbi 65 vjeç e sipër është përfaqësuar më shumë nga sa duhet në këto lëvizje, lind dyshimi për një migrim rikthyes. Durrësi, Tirana dhe Vlora kanë nivelet më të ulta të migracionit rural. Në këto prefektura është vënë re një theksim i

urbanizimit nga migrimi. Prefekturat e Tiranës, Durrësit dhe Fierit priten 53% të numrit të përgjithshëm të migrantëve në zonat rurale. Ndërsa përsa i përket migracionit urban, Tirana dhe Durrësi priten për afërsisht 74% të numrit të përgjithshëm të migrantëve.

1.4. Migracioni i popullsisë mbi bazë rrethi brenda prefekturës

Përveç vlersimit të situatës së migrimit ndërmjet rajoneve dhe prefekturave, interes paraqet gjithashtu migrimi ndërmjet rretheve të së njëjtës prefekturë. Lidhur me këtë, në kemi analizuar prefekturat e Shkodrës, Vlorës dhe Dibrës.

Zhvendosja migratore në shifra absolute dhe në përqindje sipas rretheve në prefekturën e Shkodrës për periudhën 12 vjeçare 1989-2001 është paraqitur në tabelën 6.

Tabela 6 tregon që 85% e emigrantëve lanë këto prefektura. Zhvendosjet brenda prefekturave janë të pakta dhe pjesa dërrmuese e njerëzve në këtë zhvendosje

Tabela 5: Popullsia sipas statusit të migracionit (2000-2001) në bazë të zonës së vendbanimit urbane/rurale. Shqipëria 2001

Prefektura e mbërritjes	Jo migrantë				Migrantë*			
	Rurale		Urbane		Rurale		Urbane	
	në %	Numrat	në %	Numrat	në %	Numrat	në %	Numrat
Berat	60.2	112340	39.8	74189	39.4	227	60.6	349
Dibër	79.9	145554	20.1	36652	91.9	1020	8.1	90
Drurrës	46	106869	54	125612	34.1	1865	65.9	3597
Elbasan	65.6	230146	34.4	120929	59.1	608	40.9	421
Fier	67.6	249632	32.4	119837	69.3	1776	30.7	786
Gjirokastër	60.8	66137	39.2	42628	71.7	769	28.3	304
Korçë	63.4	162939	36.6	94004	43.9	449	56.1	574
Kukës	75.4	80578	24.6	26311	77.5	590	22.5	171
Lezhë	69.1	105805	30.9	47332	59.7	725	40.3	489
Shkodër	62.6	155406	37.4	92901	73.3	804	26.7	293
Tiraneë	36.2	205080	63.8	361852	35.2	4818	64.8	8886
Vlorë	46.2	85665	53.8	99609	34	491	66	953
Total	57.9	1706151	42.1	1241856	45.5	14142	54.5	16913

* Banorë të një prefekturë tjetër në 1989.

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

lëvizin drejt Shkodrës. Mbi 50% e migrantëve brenda prefekturës lëvizin nga Malësia e madhe në Shkodër dhe 11% lëvizin në drejtim të kundërt. Zhvendosja ndërmjet Pukës dhe Shkodrës përbën 10% dhe zhvendosja në drejtim të kundërt 2%. Migrimi ndërmjet Pukës dhe Malësisë së madhe është i papërfillshëm. Numri i vogël i migrantëve nga Puka në rrethe të tjera të prefekturës shpjegohet me faktin se emigrantët nga Puka shkojnë drejt Tiranës, Lezhës dhe Durrësit dhe përfaqësojnë 42%, 18% dhe 13% të numrit të përgjithshëm të migrimit të këtij rrethi. E njëjta gjë vihet re sa i përket emigracionit nga Shkodra: emigrantët më shpesh shkojnë drejt Tiranës, Lezhës, Durrësit dhe Kurbinit, respektivisht 44%, 22%, 6% dhe 4% të të gjithë rrjedhës së zhvendosjes të emigracionit.

Duke analizuar prefekturën e Vlorës, tabela 7, paraqet zhvendosjen migratore të rretheve brenda kësaj prefekturë gjatë periudhës 12 vjeçare 1989-2001 në përqindje.

Tabela 7 tregon se 86% e migrantëve lëvizin jashtë prefekturës së Vlorës. Pjesa më e madhe e migracionit ndër-prefektura përbëhet nga migracioni nga Delvina në Sarandë. Vetëm 2% e migrantëve nga kjo prefekturë lëvizin drejt qendrës së prefekturës (qyteti dhe rrethi i Vlorës), ndërsa 9% lëvizin drejt Sarandës. Kjo do të thotë se ndryshe nga prefektura e Shkodrës, qendra e prefekturës nuk është poli për imigrimin.

Përsa i përket Dibrës (shih Tabelën 8), migrimi i brendshëm ndodh për shkak të afërsisë me Tiranën dhe karakterizohet nga një raport më i lartë i zhvendosjeve nga prefektura në prefekturë (në total 94%, nga e cila 63% lëvizin drejt Tiranës). Dibra, qendra e prefekturës, tërheq më pak se 1% të zhvendosjeve, meqenëse 5% lëvizin drejt Bulqizës që është më pranë Tiranës. Për vlerësimin e situatës dhe të proceseve migratore, një rëndësi e veçantë i vihet analizës së treguesve të migracionit të mirëfilltë (neto). Për periudhën 12 vjeçare

Tabela 6: Zhvendosja migratore në numër dhe përqindje e emigrantëve në bazë rrethi në prefekturën e Shkodrës

Vendbanimi 1989	Vendbanimi 2001				
	Malësi	Pukë	Shkodër	Jashtë prefekturës	Gjithësej
Malësi	-	...	1167	1153	2321
në %		0	50.3	49.7	100
Pukë	12	-	1418	12911	14341
në %	0.1		9.9	90	100
Shkodër	688	135	-	5344	6167
në %	11.2	2.2		86.7	100
Të gjitha	700	136	2585	19408	22829
në %	3.1	0.6	11.3	85	100

Burimi: "Regjistrimi i Popullsisë 2001". Shembull: 1 167 persona që jetonin në malësi në 1989 u regjistruan me banim në Shkodër në 2001, që përbën 50.3% të të gjithë emigrantëve nga Malësia.

1989 - 2001, ky tregues në bazë rrethesh për prefekturat e Shkodrës, Vlorës dhe Dibrës paraqitet në Tabelën 9. Ndërsa në rrethet e zonave veriore dhe verilindore të vendit migracioni neto është negativ, në rrethet e zonave jugore dhe bregdetare (Sarandë dhe Vlorë), migracioni neto është pozitiv. Ndërmjet prefekturave, përveç tipareve të përbashkëta, ka ndryshime ndërmjet rretheve. Analiza e treguesve të migracionit neto të popullsisë në bazë rrethi, na jep një pasqyrë më të qartë të nivelit të proceseve migratore në të gjithë vendin si edhe në njësi të tjera më të vogla si zonat dhe prefekturat.

Tabela 7: Flukset në numër dhe në përqindje të emigracionit të përgjithshëm sipas rretheve në prefekturën e Vlorës, 1989-2001

Vendbanimi 1989	Vendbanimi 2001				
	Delvinë	Sarandë	Vlorë	Jashtë prefekturës	Gjithësej
Delvinë	-	418	38	423	879
në %		47.6	4.3	48.1	100
Sarandë	199	-	90	980	1269
në %	15.7		7.1	77.2	100
Vlorë	6	228	-	4654	4888
në %	0.1	4.7		95.2	100
All	205	646	128	6057	7036
në %	2.9	9.2	1.8	86.1	100

Burimi: "Regjistrimi i Popullsisë 2001". Shembull: 418 persona që jetonin në Delvinë në 1989 u regjistruan me banim në Sarandë në 2001, që përbën 47.7% të të gjithë emigrantëve nga Delvina.



Tabela 8. Flukset në numër dhe përqindje të emigracionit të përgjithshëm sipas rretheve në prefekturën e Dibrës, 1989-2001

Vendbanimi 1989	Vendbanimi 2001				
	Bulqizë	Diber	Mat	Jashtë prefekturës	Gjithësej
Bulqizë	-	412	121	6258	6791
në %		6.1	1.8	92.2	100
Dibër	1378	-	156	29524	31058
në %	4.4		0.5	95.1	100
Mat	1044	62	-	13302	14408
në %	7.3	0.4		92.3	100
Të gjitha	2422	474	277	49084	52257
në %	4.6	0.9	0.5	93.9	100

Burimi: "Regjistrimi i Popullsisë 2001". *Shembull:* 412 persona që jetonin në Bulqizë në 1989 u vrojtuan më banim në Dibër në 2001 që përbën 6.1% të të gjithë emigrantëve nga Bulqiza.

1.5 Migrimi neto ndërmjet rretheve.

Tabela 10 paraqet migrimin neto të popullsisë në bazë rrethesh për periudhën 12 vjeçare 1989-2001. Duket se, vetëm 9 nga 36 rrethe të vendit (25%) kanë një bilanc pozitiv të migrimit, ndërsa 27 rrethe (75%) kanë një bilanc negativ. Nga numri i përgjithshëm i rretheve me bilanc negativ të migrimit neto, 15 prej tyre (56%) variojnë ndërmjet niveleve 9%-34%. Katër prej tyre janë vendosur në zonat veriore dhe verilindore (Tropojë, Kukës, Dibër dhe Pukë), dhe kanë tregues të migrimit të brendshëm neto që varion nga 27-34%. Karakteristikat kryesore të këtyre rretheve janë situata e vështirë ekonomike dhe sociale e trashëguar nga e kaluara. Grupi i rretheve me bilanc negativ varion në nivelet minus 15% dhe minus 23% dhe nuk paraqet interes. Këtu kemi të bëjmë me rrethe që i takojnë tre zonave kryesore të vendit (verilindje, qendër/bregdet, juglindje). Këto rrethe kanë patur të përbashkët, përveç problemeve sociale dhe ekonomike të trashëguara, edhe një faktor tjetër nxitës për emigrimin, de-industrializimin gjatë periudhës së tranzicionit. Deri në 1989, qendrat kryesore të këtyre rretheve kanë patur një industri relativisht të zhvilluar, veçanërisht sa i përket industrisë minerare, (ku ishte përfshirë popullsia rurale dhe urbane), e cila

ndërpreu aktivitetin e saj gjatë periudhës së tranzicionit. Në grupin e rretheve me bilanc negativ ndërmjet minus 9% dhe minus 15%, faktori kryesor nxitës për emigrim ka qenë ndërprerja e aktiviteteve të ndërmarrjeve industriale të tilla si Berati dhe Bulqiza. Ndër rrethet me bilanc pozitiv, pesë ndodhen në zonën jugore të vendit, (Gjirokastrë, Sarandë, Vlorë, Kuçovë, dhe Lushnjë), dhe katër ndodhen në zonën qendrore (Tiranë, Durrës, Lezhë, dhe Kurbin). Rrethet me një nivel relativisht më të lartë imigrimi, siç treguam më lart, në nivel prefekturë, janë Tirana dhe Durrësi. Këto të dhëna flasin për karakterin shpërthyes dhe kaotik të këtij migrimi si rezultat i nivelit të lartë të erozionit demografik, të shoqëruar me shkallë të lartë të varfërisë dhe nivel të ulët të zhvillimit ekonomik. Nga ana tjetër, niveli i lartë i imigrimit në pjesën dërrmuese të rretheve të vendit shoqërohen me një sërë fenomenesh negative përsa i përket procesit të urbanizimit, nga të cilat si më i rëndësishmi mund të përmendet shkatërrimi i elementëve të shërbimit urban si: shtëpitë, sistemet e furnizimit më ujë të pijshëm dhe me energji, sistemet e kanalizimeve, pastrimi qytetit, shërbimi shëndetsor, arsimit etj. Si përfundim, mund të përmendim një përqëndrim të madh të rrjedhës së migrimit në drejtim të qendrës e cila tërheq njerëzit nga i gjithë vendi (veçanërisht nga zonat e veriut), por edhe në drejtim të bregdetit, i cili thith kryesisht zhvendosjet në distanca të shkurtra. Këto zhvendosje të brendshme të popullsisë, sollën dy ndryshime të rëndësishme demografike: nga njëra anë zonat jugore dhe veçanërisht ato veriore humbën deri në 34% të popullsisë që u regjistrua në 1989, dhe nga ana tjetër, zonave bregdetare dhe qendrore iu desh të përballen me presionin e dendur demografik, si p.sh. integrimi në Tiranë i njënumri të madh migrantësh të cilët përfaqësojnë një të tretën e popullsisë së regjistruar në 1989. Zhvendosjet e kohëve të fundit kanë tentuar me tepër drejt një shpërndarje të ekuilibruar të migrantëve në territorin shqiptar.

Tabela 9: Treguesit e migracionit të brendshëm të mirëfilltë sipas rretheve në periudhën 1989 – 2001, prefekturat e Shkodrës, Vlorës dhe Dibrës

Prefekturat/ Rrethet	Popullsia vendase 1989	Popullsia vendase 2001	Emigrantët (89-01)	Imigrantët (89- 01)	Migrimi neto (89-01)	Emigrimi në % i pop 1989	Imigrimi në % i pop 2001
Prefektura Shkodër							
Malësi e Madhe	43784	36692	2321	821	-1500	5.3	2.2
Pukë	48969	34386	14341	724	-13617	29.3	2.1
Shkodër	192505	185395	6167	5691	-476	3.2	3.1
Prefektura Vlorë							
Saranda	63983	35089	1269	4071	2802	2.0	11.6
Vlorë	176788	147128	4888	9366	4478	2.8	6.4
Delvinë	23785	10765	879	679	-200	3.7	6.3
Prefektura Dibër							
Bulqizë	50282	42968	6791	2603	-4188	13.5	6.1
Dibër	99368	85699	31058	919	-30139	31.3	1.1
Mat	76674	61187	14408	1333	-13075	18.8	2.2

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

Tabela 10: Migracioni i brendshëm neto për disa rrethe në periudhën 1989-2001, Shqipëria.

Rrethe	Popullsia 1989	Migracioni neto	
		Numrat	Në % të popullsisë të 1989
Tregues negativë			
1. Kukësi	79421	-26965	-34.0
2. Tropoja	44779	-13617	-30.4
3. Dibra	99368	-30139	-30.3
4. Pukë	48969	-13617	-27.8
5. Skrapar	46503	-10576	-22.7
6. Mirditë	50447	-10703	-21.2
7. Gramsh	43565	-8931	-20.5
8. Tepelenë	49850	-8792	-17.6
9. Mat	76674	-13075	-17.1
10. Kolonjë	24781	-3946	-15.9
11. Përmet	39775	-6118	-15.4
12. Has	21881	-3168	-14.5
13. Librazhd	71982	-9069	-12.6
14. Bulqizë	50282	-4188	-8.3
15. Berat	136461	-12242	-9.0
Tregues Pozitivë			
1. Tirana	368213	130819	35.5
2. Durrës	164484	37598	22.9
3. Lezhë	62001	5573	9.0
4. Kurbin	52806	3882	7.4
5. Saranda	63983	2802	4.4
6. Kuçovë	39937	1402	3.5
7. Lushnjë	134280	4709	3.5
8. Vlorë	176788	4478	2.5
9. Gjirokastrë	66373	498	0.8

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 1989 dhe 2001

2

Faktorët e migrimit të brendshëm.**2.1 Struktura moshore dhe gjinore tek migrantët e brendshëm.**


Popullsia migrante është relativisht e re: 115 700 persona që përfaqësojnë 46% të të gjithë migrantëve ndërmjet prefekturave nuk kanë arritur moshën 30 vjeç në 2001, dhe vetëm 6% janë në moshën e pensionit. Pra, migrimi i brendshëm është një fenomen që prek popullsinë e re aktive: 72% e personave të migruar sipas "Regjistrimit të Popullsisë 2001" ishin në moshën ndërmjet 20 dhe 65 vjeç. Pra, në disa zona, migrimi çoi në përqëndrimin e krahut të punës, domethënë të popullsisë potencialisht aktive. Mund të vërejmë gjithashtu se, gratë janë më shumë të predispozuar të migrojnë brenda kufijve të Shqipërisë se sa burrat. 54% e migrantëve janë gra (136 600 gra kundrejt 116 100 burra). Raporti gjinor i migrantëve është 85 burra për 100 gra. Ky mbizotërim i grave, sidoqoftë, nuk është i vertet për të gjitha moshat. Ne vumë re një raport gjinor prej 93 ndër adoleshentët (12-19 vjeç) dhe prej 60 ndër migrantët me moshë nga 20-29 vjeç. Për migrantët me moshë 40-

Pasi kemi nxjerrë në pah zhvendosjet e ndryshme të migrimit të brendshëm, në këtë pjesë, do të synojmë t'i karakterizojmë këto zhvendosje. Njohja e përbërjes demografike dhe social-ekonomike e zhvendosjeve është, në të vërtetë, shumë e rëndësishme për të ngritur një strukturë të mirë të ardhjeve të migrantëve në zonat e imigrimit dhe për të vepruar ndaj eksodeve tepër të mëdha në zonat e emigrimit. Në këtë kapitull ne do të analizojmë së pari, përbërjen e të gjithë popullsisë së migrimit në bazë të informacioneve që lidhen me moshën, gjininë dhe karakteristikat social profesionale në 2001. Në fazën e dytë të analizës, ne do të paraqesim situatën e tipeve të ndryshme të zhvendosjeve krahasuar me jo-migrantët.

64 vjeç, burrat përbëjnë pjesën më të madhe. Ka disa arsye të ndryshme që mund të përmenden për të shpjeguar mbizotërimin e grave që migrojnë në moshë të re. Së pari, gratë e reja të lindura në zonat rurale shtyhen të emigrojnë, sepse ato në përgjithësi nuk kanë të drejtë të trashëgojnë nga prona e familjes në fshat. Meqënëse ato nxiten që të gjejnë punë jashtë territorit të familjes, ato zhvendosen më shpejt sesa burrat e së njëjtës moshë. Ky migrim, gjithashtu, nxitet nga mundësia e punësimit në sektorët terciarë në zonat urbane. Këto lloje punësh, përgjithësisht, nuk kërkojnë ndonjë kualifikim të veçantë. Së dyti, sic do ta tregojmë edhe në kapitujt që lidhen me migracionin ndërkombëtar, ky mbizotërim është kryesisht artifakt, sepse migrantët burra më shpesh migrojnë jashtë vendit pas një migrimi të



Figura 1: Migrantët e brendshëm të Shqipërisë në periudhën 1989-2001 sipas gjinisë dhe moshës, 2001.



brendshëm (dhe për këtë arsye ato nuk reflektohen në vrojtim), ndërsa gratë më shpesh preferojnë migrimin afatshkurtër siç është vënë re në Teorinë e Ravensteinit (Ravenstein, 1885). Rritja e numrit të meshkujve në zhvendosjet pas 40 viteve, flet për një motiv tjetër për të emigruar: meshkujt e moshës 40-64 vjeç, në të shumtën e rasteve, për shkak të normave shoqërore kanë përgjigjësi për të siguruar mjetet e jetesës

për familjet e tyre (shih gjithashtu Kapitullin 3.3.2). Gjendja e tyre familjare nuk i lejon ata që të rrezikojnë një jetë klandestine të pa dokumentuar jashtë vendit (Dahinden, 1998), dhe për rrjedhojë, ata përpiqen të gjejnë punë brenda vendit. Migrimi familjar është një realitet në Shqipëri. Rreth 10% e fëmijëve nga 0-4 vjeç në 1989, jetonin në një prefekturë tjetër në 2001. Ky fenomen vihet re, kryesisht, në zonat rurale dhe periferike të vendit. Në verilindje, 29.2% e fëmijëve kanë emigruar; ndërsa në qendrat dytësore të bregdetit Adriatik (Vlorë, Fier dhe Lezhë) janë zhvendosur vetëm 4% e fëmijëve.

Tabela 11. Migrantët e brendshëm në Shqipëri në periudhën 1989-2001 sipas moshës dhe gjinisë, 2001.

Moshë	Numrat		Gjithsej	Raporti gjinor	Në % sipas grupmoshës		
	Meshkuj	Femra			Meshkuj	Femra	Gjithsej
0-19	27679	29726	57405	93.1	23.8	21.8	22.7
20-29	21910	36418	58328	60.2	18.9	26.7	23.1
30-39	23884	29509	53393	80.9	20.6	21.6	21.1
40-49	17853	17196	35049	103.8	15.4	12.6	13.9
50-65	18002	16184	34186	111.2	15.5	11.8	13.5
65+	6771	7603	14374	89.1	5.8	5.6	5.7
Gjithsej	116099	136636	252735	85.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

Dallimet lidhur me probabilitetin e migrimit vihen re, gjithashtu, por në mënyrë jo shumë të theksuar. Ndër migrantët në vitet 2000 - 2001: numërohen 92 burra kundrejt 100 grave në numrin e përgjithshëm të migrantëve, dhe 71 burra kundrejt 100 ndër migrantët e moshës 20-29 vjeç.

2.2 Niveli arsimor i migrantëve të brendshëm.

Për të bërë një analizë sa më të mirë të nivelit arsimor të migrantëve të viteve 1989-2001, është e nevojshme që të studiohen veç e veç personat të cilët në 1989 ishin mbi moshën 20 vjeç (për të cilët mendohet se edukimi tyre ishte kompletuar në 1989) dhe ata moshës 10-19 vjeç. Kategoria e parë i takon moshës 32 vjeç e sipër, në vitin 2001, dhe numëron 124 000 persona (49% e numrit të përgjithshëm të migrantëve). Kjo kategori përbëhet nga një numër relativisht i madh i personave të pakualifikuar ose me kualifikim

nuk ndodh me fëmijët e migrantëve të parë ose të migrantëve të rinj (mosha 10-19 vjeç në 1989) që përfaqësojnë ¼ e zhvendosjeve. Në këtë grup ka më shumë gra, pavarësisht nga shkollimi dhe, në total, ato numërojnë 40

Tabela 12: Migrantët e brendshëm (më moshë 32 e lartë) në Shqipëri r në periudhën 1989-2001 në bazë të gjinisë dhe nivelit të shkollimit, 2001.

(mosha 32 vjeç e sipër)	Numrat			Raporti gjinor	në %		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej		Meshkuj	Femra	Gjithsej
Nr. i diplomave	2934	7363	10297	39.8	4.8	11.8	
Arsimi fillor	8646	11168	19814	77.4	14.1	17.8	16
Arsimi 8-vjeçar	21579	24550	46129	87.9	35.2	39.2	37.2
Arsimi i mesëm	18471	15079	33550	122.5	30.1	24.1	27
Arsimi i lartë	9759	4491	14250	217.3	15.9	7.2	11.5
Gjithsej	61389	62651	124040	98	100	100	100

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

Tabela 13: Migrantët e brendshëm (nga mosha 22-31 vjeç) në Shqipëri në periudhën 1989-2001 sipas gjinisë dhe nivelit të arsimimit, 2001.

(mosha 22-31 vjeç)	Numrat			Raporti gjinor	në %		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej		Meshkuj	Femra	Gjithsej
Nr. i diplomave	359	472	831	76.1	1.5	1.2	
Arsimi fillor	425	735	1160	57.8	1.7	1.8	1.8
Arsimi 8-vjeçar	11988	21944	33932	54.6	49	54.2	52.2
Arsimi i mesëm	9230	13253	22483	69.6	37.7	32.7	34.6
Arsimi i lartë	2468	4099	6567	60.2	10.1	10.1	10.1
Gjithsej	24470	40503	64973	60.4	100	100	100

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

të ulët: 8% nuk kanë diplomë dhe 16% kanë mbaruar shkollën fillore. Kjo gjendje është për shkak të faktit që personat e moshës 50 vjeç e sipër i përkasin kësaj kategorie të migrantëve. Ata përfaqësojnë 90% të migrantëve pa arsim dhe 84% të migrantëve me arsim fillor. Vlerat kulturore, ndër faktorët e tjerë, kanë kushtëzuar përbërjen e migrantëve në bazë gjinie dhe nivelit të shkollimit. Migrantët e brendshëm me nivel të ulët profesional janë kryesisht gra (40 burra për 100 gra në këtë grup). Migrantët me nivel të lartë profesional janë kryesisht burra (217 burra për 100 gra ndër migrantët me nivel arsimi universitar). Në total, 70% e migrantëve me nivel të lartë profesional janë burra nga mosha 32 deri 49 vjeç. Dallimi në bazë gjinie

500 persona, kundrejt 24 500 persona burra. Ky numër i madh i grave në zhvendosjen e migrimit të brendshëm vihet re në të gjitha nivelet e arsimit (Tabela 13). Tani migrimi është një fakt për personat e kualifikuar, por edhe atyre në kualifikim e sipër. Migrantët me kualifikim të ulët janë të paktë ndër migrantët e rinj. 96% e tyre kanë të paktën diplomë të shkollës tetëvjeçare.

2.3. Gjendja ekonomike e migrantëve të brendshëm.

Megjithëse 86% e migrantëve janë në moshë aktive (15-64 vjeç), raporti i migrantëve që punojnë është vetëm 60% (151 300 persona). Migrimi i brendshëm në Shqipëri nuk është



vetëm migrim i punëtorëve. Së pari, 12% e migrantëve deklaruan se ishin pensionistë ("të tjerë"); së dyti, më shumë se ¼ e migrantëve gra janë shtëpiake (edhe ndër gratë e reja-Tabela 14), të cilat ka shumë mundësi të kenë migruar me familjet e tyre për t'u ribashkuar më familjet.

Kjo karakteristikë familjare e migrimit vihet re gjithashtu edhe në raportin e lartë të burrave në popullsinë aktive: ndërsa popullsia ekonomike aktive përbën 79% të burrave, ky grup përfaqëson vetëm 53% të grave migrante. Për më tepër, duket që burrat e kanë më të lehtë të gjejnë një punë pasi kanë migruar; shkalla e papunësisë për gratë është 41% kundrejt 23% për burrat.

Pra, sipas këtyre shifrave, migrimi për punësim është një migrim i burrave dhe lëvizjet migruese mund të lidhen më migrimin tradicional, domethënë të ndërmarrë nga kryetari i familjes. Një shpërbërje e gjendjes ekonomike të migrantëve në bazë të moshës dhe gjinisë, tregon se koeficienti i papunësisë ndër moshat 15-19 vjeç është më pak e rëndësishme për gratë sesa për burrat (24% kundrejt 33%). Ndërsa burrat aktivë të punësuar, janë proporcionalisht më të shumtë në numër në moshat 30-49 vjeç; gratë kanë shkallën më të lartë aktive të punësimit në moshën 15-19 vjeç dhe ndërmjet 40-49 vjeç. Interesant është të theksohet gjithashtu, fakti

që, ndër migrantët mbizotërojnë gratë të cilat janë arsimuar, veçanërisht në migrantët e viteve 2000-2001. Kjo ndoshta tregon se ka më shumë mundësi migrimi për gratë, mundësi që lidhen më kushtet sociale ekonomike të përmenduara më sipër.

2.4 Karakteristika e migrantëve në bazë të drejtimin të zhvendosjes.

Në mënyrë që të studiojmë migrimin e brendshëm sa me efektivisht duke marrë gjithashtu parasysh kontekstin social-ekonomik, do të dallojmë katër zhvendosje: tri zhvendosje në drejtim të qendrës së vendit (prefekturat e Tiranës dhe Durrësit), dhe një zhvendosje në drejtim të bregdetit (Vlorë, Fier, Lezhë). Këto dallime në drejtimet e zhvendosjes burojnë nga dallimet ekonomike të rajoneve nga të cilat largohen te zhvendosurit. Zhvendosjet janë:

1. Migrantët që vijnë nga malësitë dhe zonat lindore të Kukësit dhe të Dibrës dhe drejtohen për në qendër të vendit.
2. Migrantët nga rajonet e brendshme (Berat, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë dhe Shkodër) drejt qendrës së vendit.
3. Migrantët nga qendrat dytësore të vendosura në bregdet (Vlorë, Fier, Lezhë) të cilët drejtohen për në qendër të vendit.
4. Migrantët nga zonat e brendshme që drejtohen për në qendrat dytësore të bregdetit të vendit.

Në bazë të teorive neoklasike të migrimit, lëvizjet migruese ndodhin për shkak të disbalancimeve strukturore ndërmjet zonave. Ato presupozojnë një ribalancim të faktorëve të prodhimit (krahu i punës, kapitali), ndërmjet zonave, falë zhvendosjes së personave, (mallrave dhe kapitalit). Në këtë mënyrë, migrimi perceptohet si një fenomen i cili rivendos një bilanc strukturor ndërmjet zonave

Tabela 14: Shpërndarja (në numër dhe përqindje) e migrantëve të brendshëm në Shqipëri (15 vjeç e sipër në 2001), në periudhën 1989-2001 sipas gjinisë dhe gjendjes ekonomike, 2001

	Numrat			Raporti gjinor	në %		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej		Meshkuj	Femra	Gjithsej
Të punësuar	64519	39641	104160	162.8	60.7	31.1	44.6
Të papunësuar	19312	27877	47189	69.3	18.2	21.9	20.2
Shtëpiake	0	34787	34787	0.0	0.0	27.3	14.9
Studentë	6417	7603	14020	84.4	6.0	6.0	6.0
Të tjerë	15980	17371	33351	92.0	15.0	13.6	14.3
Gjithsej	106228	127279	233507	83.5	100.0	100.0	100.0

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ne atëherë, do ta shqyrtojmë këtë hipotezë me rastin e Shqipërisë, duke krahasuar disa karakteristika demografike dhe social profesionale (në bazë gjinie, moshe, niveli arsimor dhe gjendjeje ekonomike) të migrantëve dhe jo migrantëve (shih gjithashtu, seksionin 2.3).

2.4.1 Migrimi nga verilindja në Tiranë dhe Durrës.

Prefekturat e qendrës së vendit (Tiranë dhe Durrës), tërheqin migrantë, të cilët vijnë nga i gjithë vendi. Pjesa më e madhe e imigrantëve, megjithatë, vijnë nga veri-lindja (Kukës dhe Dibër- 47% dhe 40% e imigrantëve në Tiranë dhe Durrës përkatësisht). Struktura e kësaj zhvendosjeje tregohet në Tabelën 15.

Migrantët e ardhur nga verilindja drejt qendrës karakterizohen nga një strukturë e moshës së re: 68% e migrantëve janë nën moshën 12-39 vjeç, kundrejt 45 % të popullsisë së të gjithë vendit. Kjo zhvendosje çliroi zonat e largimit të njerëzve nga presioni i madh demografik për shkak të faktit se 65% e popullsisë jomigrante ka një moshë më pak

se 40 vjeç. Migracioni ka ulur moshën e popullsisë së prefekturave të Tiranës dhe të Durrësit, ku 53% e banorëve nuk kanë arritur ende moshën 40 vjeç. Meqenëse migrantët janë shpesh të rinj, kapitali i tyre njerëzor është mesatarisht më i lartë ose sa ai i popullsisë jomigrante. Personat me diplomë të shkollës së mesme ose me diplomë universiteti përbëjnë vetëm 26% të popullsisë jomigrante në zonat verilindore të vendit, dhe ata janë 34.5% e popullsisë migrante. Ndikimi kryesor i kësaj zhvendosjeje për zonat pritëse lidhet me pjesën më të madhe të migrantëve më formim të nivelit të mesëm (arsimi tetëvjeçar), të cilët përfaqësojnë 48% të migrantëve, kundrejt 36% të popullsisë pritëse. Koeficienti i papunësisë së popullsisë së origjinës (që jetojnë në verilindje), është mjaft e lartë me 25.5%. I njëjti tregues arrin shifrën 33% ndër burrat dhe 46% ndër gratë migrante. Në përgjithësi, presionet mbi tregun e punës përbëjnë një shqetësim të veçantë lidhur me grupe të veçanta të forcës së punës: Meqenëse 90% e të papunëve kanë nivele shkollimi tetëvjeçar dhe të mesëm, mund të flasim për një strukturë papunësie e cila tenton të përqëndrohet tek destinacionet e ardhjes. Duket që migrantët kanë më shumë vështirësi

Tabela 15: Karakteristikat e migrimit të brendshëm nga verilindja e Shqipërisë drejt qendrës në periudhën 1989-2001, krahasuar me jo migrantët, 2001.

	Rajoni i origjinës (Jo migrantë)			Migrantë			Rajoni i destinacionit (Jo migrantë)		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Struktura e moshës									
12-19	27.5	26.8	27.1	26.3	26.3	26.3	20.3	20.2	20.3
20-39	37.3	37.8	37.6	41.5	42.1	41.8	31.9	33.0	32.5
40-49	14.4	13.3	13.8	14.1	13.1	13.6	18.4	17.5	17.9
50-65	14.4	13.8	14.1	13.3	12.9	13.1	19.7	18.5	19.1
65+	6.5	8.2	7.4	4.8	5.7	5.2	9.7	10.7	10.2
Niveli i arsimimit (20 vjeç e sipër)									
I ulët	19.4	28.6	24.0	13.8	21.9	17.8	15.5	23.5	19.6
I mesëm	49.9	50.7	50.3	45.3	50.3	47.8	36.0	35.9	36.0
I lartë	30.8	20.8	25.7	40.9	27.9	34.5	48.5	40.7	44.5
Statusi ekonomik (15 vjeç e sipër)									
Koeficienti i aktivitetit	75.1	42.0	58.4	81.0	49.2	65.3	72.2	49.7	60.7
Koeficienti i papunësisë	24.9	26.6	25.5	26.0	45.6	33.4	17.3	26.5	21.2
Përpjesa e shtëpiakëve	0.0	34.6	17.4	0.0	31.6	15.6	0.0	19.7	10.1

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001



për të gjetur punë në vendet e reja të banimit. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht me disavantazhet që i karakterizonte migrantët që përpara migrimit të tyre (eksportimi i papunësisë), ose disavantazhet e reja që hasen në zonat pritëse, të cilat i bëjnë ata më pak konkures sesa popullsia vendase. Fatkeqësisht, të dhënat e Regjistrimit 2001 nuk i japin përgjigje kësaj çështjeje. Është po aq interesante të vëresh karakteristikat e tjera të migrimit nga Kukësi dhe Dibra, drejt qendrës së Shqipërisë. Së pari, vemë re një numër i njëjtë burrash dhe grash që kanë emigruar drejt qendrës. Së dyti, pothuajse të gjithë fëmijët e migruar nga prefekturat e Kukësit (mosha 0-4 vjeç në 1989), i përkasin kësaj zhvendosjeje. Kjo strukturë familjare është në kundërshtim me mënyrat e jetesës në rajonet pritëse, të cilat karakterizohen nga një raport më i ulët i kryefamiljareve.

2.4.2 Migrimi nga prefekturat e Beratit, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Shkodrës drejt Tiranës dhe Durrësit.

Migrantët që vijnë nga Berati, Elbasani, Gjirokastra, Korça, Shkodra drejt Tiranës dhe Durrësit shfaqin ngjashmëri me ata që vijnë nga Kukësi dhe nga Dibra, por kanë githashtu, disa karakteristika të veçanta. Kjo zhvendosje karakterizohet nga një pjesë dërrmuese grash dhe një pjesë e madhe migrantësh të rinj (shih Tabelën 16). Niveli arsimor i këtyre migrantëve është, megjithatë, i ndryshëm nga migrantët që vijnë nga verilindja e vendit, me nivel më të lartë shkollimi. Atëherë, popullsia jo migrante flet për të njëjtin nivel shkollimi me popullsinë jo migrante të verilindjes. Këtu mund të vërehet një emigrim i trurit: vetëm 30% e personave që jetojnë në të njëjtën prefekturë ndërmjet viteve 1989- 2001, kanë diplomë të shkollës së mesme, kundrejt 47% ndër migrantët. Në qoftë se pjesa qendrore e vendit, pati një rritje të popullsisë me kualifikim të lartë, mund të themi që edhe ata, gjithashtu vuajtën nga papunësia. Niveli i papunësisë është e njëjtë si në zonat e ardhjes, ashtu edhe në zonat e largimit (ndërmjet 21% dhe

Tabela 16: Karakteristikat e migrimit të brendshëm nga Berati, Elbasani, Gjirokastra, Korça dhe Shkodra drejt qendrës së Shqipërisë në periudhën 1989- 2001 krahasuar me jo migrantët, 2001

	Rajoni i origjinës (Jo migrantë)			Migrantë			Rajoni i destinacionit (Jo migrantë)		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Struktura e moshës									
0-19	23.0	23.2	23.1	21.7	21.7	21.7	20.3	20.2	20.3
20-29	16.8	16.3	16.6	18.7	22.2	20.5	13.8	14.7	14.3
30-39	17.6	18.0	17.8	19.9	19.3	19.6	18.1	18.3	18.2
40-49	16.7	16.3	16.5	16.3	15.2	15.7	18.4	17.5	17.9
50-65	17.4	16.4	16.9	17.0	14.4	15.7	19.7	18.5	19.1
65+	8.4	9.8	9.1	6.4	7.2	6.8	9.7	10.7	10.2
Niveli i arsimimit (20 vjeç e sipër)									
I ulët	19.1	27.7	23.3	11.8	19.3	15.6	15.5	23.5	19.6
I mesëm	47.7	45.7	46.7	36.4	38.0	37.2	36.0	35.9	36.0
I lartë	33.2	26.6	29.9	51.8	42.8	47.2	48.5	40.7	44.5
Statusi ekonomik (15 vjeç e sipër)									
Koeficienti i aktivitetit	75.3	51.5	63.4	77.4	54.5	65.7	72.2	49.7	60.7
Koeficienti i papunësisë	18.0	27.7	21.9	23.1	42.2	31.2	17.3	26.5	21.2
Përpjesa e shtëpiakëve	0.0	19.9	9.9	0.0	20.6	10.5	0.0	19.7	10.1

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

22%), por migrantët ndikohen më shumë nga fenomeni që arrin shifrën 31% të papunësisë. Këta migrantë janë, kryesisht, me nivel arsimimi të shkollës tetëvjeçare dhe të mesme. Ashtu sic është dhe rasti për migrantët që vijnë nga Kukësi dhe nga Dibra, problemi i papunësisë është problem strukturor, mëqenëse tregu i punës i zonës së mbërritjes nuk është në gjendje të integrojë migrantët.

2.4.3 Migrimi nga bregdeti drejt Tiranës dhe Durrësit.

Migrimi ndërmjet prefekturës së Vlorës, Fierit, Lezhës, Tiranës dhe Durrësit është mjaft interesant për faktin se prefekturat nga ku largohen kanë një strukturë demografike që është e ngjashme me atë të Tiranës dhe të Durrësit. Ato pasqyrojnë një popullsi të plakur, e me një numër të kufizuar të rinjve, fenomen, i cili ndodh ndoshta, për shkak të migrimit ndërkombëtar të individëve të moshës 20-35 vjeç. (shih gjithashtu seksionin 3). Të gjitha karakteristikat e përshkuara për

dy zhvendosjet e para (domethënë: migrimi i të rinjve dhe i grave si edhe një pjese të madhe të migrantëve të kualifikuar), vihen re në një mënyrë më të dukshme për migracionin nga bregdeti në qendër. Ky migrim është më i pakët në numër, por më selektiv: 12 300 gra dhe vetëm 9 800 burra (79 burra kundrejt 100 grave), kanë lëvizur drejt Tiranës dhe Durrësit gjatë periudhës 1989-2001. Mungesa e ekuilibrit ndërmjet gjinive vihet re veçanërisht për moshat 20-39 vjeç. Një specifikë tjetër e zhvendosjes së migracionit është përbërja e saj në bazë të nivelit të shkollimit. Raporti i personave me nivel të lartë shkollimi i popullsisë migrante është dy herë më i lartë se ai i popullsisë nga ku largohen migrantët (61% kundrejt 31% ndër personat e moshës 20 vjeçare e sipër) dhe në të njëjtën kohë, grupi më i arsimuar i migrantëve që banojnë në qendër në 2001. Numri i personave me arsim të lartë është më i madh në popullsinë migrante sesa në popullsinë e qendrës, përkatësisht 61% dhe 45%. Kjo tregon për specializimin e grupit që i përket hierarkisë rajonale dhe lidhet me funksionet ekonomike

Tabela 17: Karakteristikat e migrimit të brendshëm nga qendrat dytësore drejt qendrave kryesore të Shqipërisë në periudhën 1989-2001, krahasuar me jo migrantët, 2001.

	Rajoni i origjinës (Jo migrantë)			Migrantë			Rajoni i destinacionit (Jo migrantë)		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Struktura e moshës									
12-19	22.5	22.8	22.7	21.1	18.6	19.7	20.3	20.2	20.3
20-29	14.8	15.1	15.0	16.2	26.4	21.9	13.8	14.7	14.3
30-39	18.3	18.4	18.4	19.7	22.3	21.1	18.1	18.3	18.2
40-49	17.5	16.5	17.0	17.4	14.1	15.6	18.4	17.5	17.9
50-65	18.1	17.0	17.5	19.0	13.0	15.7	19.7	18.5	19.1
65+	8.8	10.1	9.4	6.6	5.5	6.0	9.7	10.7	10.2
Niveli i arsimimit (20 vjeç e sipër)									
I ulët	18.3	27.6	23.0	8.6	11.8	10.4	15.5	23.5	19.6
I mesëm	47.4	44.0	45.7	25.1	31.7	28.8	36.0	35.9	36.0
I lartë	34.3	28.4	31.4	66.3	56.5	60.8	48.5	40.7	44.5
Statusi ekonomik (15 vjeç e sipër)									
Koeficienti i aktivitetit	74.8	48.5	61.6	74.7	56.0	64.2	72.2	49.7	60.7
Koeficienti i papunësisë	16.8	24.5	19.9	20.2	41.8	30.8	17.3	26.5	21.2
Përpjesa e shtëpiakëve	0.0	23.1	11.6	0.0	20.7	11.7	0.0	19.7	10.1

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001



dhe administrative, të cilat janë kryesisht të përqëndruara në Tiranë dhe në Durrës. Duke marrë parasysh faktin që niveli i shkollimit të popullsisë së tyre është pak a shumë i njëjtë më atë të qendrave dytësore, migrimi është shumë më selektiv. Tek kjo popullsi migrantësh të kualifikuar, 61% janë gra nga të cilat 65% janë nga mosha 20-39 vjeç, kundrejt 46% ndër burra. I njëjti problem, siç u përmend më sipër, vërehet për këtë popullsi të migrantëve në rajonet pritëse lidhur me mundësinë e tregut të punës. Shkalla e papunësisë është në të vërtetë disi më e ulët sesa për migrantët që vijnë nga zonat e tjera të vendit, por gjithsesi është 31% (kundrejt 20% në rajonet e largimit dhe 31% në rajonin e destinacionit).

2.4.4 Migrimi nga prefekturat Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, dhe Shkodër drejt qendrave dytësore të Shqipërisë.

Zhvendosjet në distanca të shkurtra ndërmjet pjesëve të brendshme të vendit (me përjashtim të Kukësit dhe të Dibrës), dhe bregdetit (Fier, Vlorë, Lezhë), janë shumë të ndryshme krahasuar me zhvendosjet drejt Tiranës dhe Durrësit. Popullsia migrante është më e re (70% me moshë 12-39 vjeç) dhe në pjesën dërrmuese e përbërë nga gra. Ky migracion ka një ndikim të rëndësishëm në krahun e punës të zonave të largimit dhe të ardhjes meqenëse pjesa dërrmuese e të zhvendosurve përbëhet nga të rinj. Këto zhvendosje gjithashtu, karakterizohen nga një strukturë më pak e kualifikuar.

Persona me një nivel formimi të mesëm kanë emigruar më shpesh drejt bregdetit (53% kanë frekuentuar shkollat të tejeçare). Duket që integrimi në punë është më i lehtë për këta migrantë, sesa për ata që shkojnë në qendër të qytetit. Shkalla e aktivitetit është mjaft e lartë (80%), dhe shkalla e papunësisë është relativisht e ulët (24% kundrejt 22% ndër

vendasit). Megjithatë, migrantet gra shpesh e ndërpresin aktivitetin e tyre për t'u bërë amvisa (31% kundrejt 20% në zonat e largimit dhe 23% në zonat e ardhjes).

Në përfundim, mund të përmendim një përzgjedhje progresive të migrimit të brendshëm në Shqipëri, që varet nga niveli i zhvillimit ekonomik i secilës zonë të largimit. Kjo përzgjedhje e popullsisë së origjinës, nuk është vetëm e dukshme në përbërjen e zhvendosjeve të migrantëve përse i përket gjinisë dhe moshës, duke tregon gjithashtu, për një ndryshim në vlerat e traditës, por ndikon edhe në nivelin e shkollimit në popullsinë migrante. Sa më i zhvilluar ekonomikisht të jetë një rajon krahasuar me qendrën e vendit, aq më shumë popullsia migruese ka tendencën të jetë në moshë të re, e mirëshkolluar, dhe e përbërë nga gratë.

Për shkak të përqëndrimit të tejskajshëm në hapësirë të migrantëve në vend, aktualisht në disa qendra tërheqëse, si kryesisht në Tiranë dhe në Durrës dhe në qytetet kryesore dytësore që ndodhen në bregdet, të gjithë migrantët përballen me të njëjtin problem, atë të integritit të tyre në tregun lokal të punës.

Në kundërshtim me hamendësimet e teorisë neoklasike, migrimi i brendshëm në Shqipëri kontribuoi në përqëndrimin e forcës së re të punës, e cila çoi në nxitjen e një presioni të rëndësishëm demografik dhe ekonomik në një numër shumë të kufizuar të zonave të vendit si edhe emigrimin e rëndësishëm të trurit bashkë me plakjen e popullsisë në rajonet nga largohen emigrantët. Në këtë mënyrë, të dy fenomenet mund të pengojnë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të rajoneve përkatëse—Pjesa e popullsisë më të re dhe më të shkolluar është përgjithësisht më përparimtare.

Pasi u njohën me zhvendosjet e popullsisë së brendshme në Shqipëri, gjithashtu ka rëndësi, të përmendet që lëvizjet migratore

shpesh janë bërë hap pas hapi me to. Pas një migrimi të brendshëm, dikush mund të vendosë të largohet nga vendi. Nuk është çudi të vërehet se zhvendosjet u drejtuan nga bregdeti. Përzgjedhja ka rolin e vet në këto hapa të migrimit. Vendimi për t'u larguar nga vendi, shpesh nënkupton një farë rreziku, (për shembull të jetës pa dokumentë), si edhe një motiv të fortë (të lësh familjen dhe jetën sociale). Ndaj, është edhe interesante të analizohet se sa shqiptarë lanë vendin në vitet 1989-2001 nga njëra anë, dhe cilët janë këta migrantë nga ana tjetër. Këto çështje janë subjekti kryesor i seksionit që vijon lidhur me ndikimin e migracionit në evolucionin e popullsisë shqiptare (Seksioni 3), si edhe në veprimtarinë e ekonomisë ndërkombëtare (Seksioni 4).

Tabela 18: Karakteristikat e migrimit të brendshëm nga zonat e brendshme të vendit drejt qendrave dytësore të Shqipërisë në periudhën 1989-2001, krahasuar me jo migrantët, 2001.

	Rajoni i origjinës (Jo migrantë)			Migrantë			Rajoni i destinacionit (Jo migrantë)		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Struktura e moshës									
12-19	23.0	23.2	23.1	24.6	21.5	22.9	22.5	22.8	22.7
20-29	16.8	16.3	16.6	18.6	29.4	24.7	14.8	15.1	15.0
30-39	17.6	18.0	17.8	20.5	22.3	21.5	18.3	18.4	18.4
40-49	16.7	16.3	16.5	15.0	11.4	13.0	17.5	16.5	17.0
50-65	17.4	16.4	16.9	15.3	10.4	12.5	18.1	17.0	17.5
65+	8.4	9.8	9.1	6.0	5.0	5.4	8.8	10.1	9.4
Niveli i arsimimit (20 vjeç e sipër)									
I ulët	19.1	27.7	23.3	17.2	19.1	18.2	18.3	27.6	23.0
I mesëm	47.7	45.7	46.7	49.0	55.3	52.6	47.4	44.0	45.7
I lartë	33.2	26.6	29.9	33.8	25.7	29.1	34.3	28.4	31.4
Statusi ekonomik (15 vjeç e sipër)									
Koeficienti i aktivitetit	75.3	51.5	63.4	79.6	52.5	64.3	74.8	48.5	61.6
Koeficienti i papunësisë	18.0	27.7	21.9	19.5	32.2	25.4	16.8	24.5	19.9
Përpjesa e shtëpiakëve	0.0	19.9	9.9	0.0	31.1	17.6	0.0	23.1	11.6

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

3

Ndikimi i migrimit në evolucionin e popullsisë shqiptare.**3.1 Ndikimi i lëvizjeve migratore në popullsinë në përgjithësi.**

Ky seksion përqëndrohet në ndikimin që patën zhvendosjet migratore gjatë periudhës ndërmjet dy Regjistrimeve të popullsisë, në strukturën e popullsisë. Nënseksioni i parë përqëndrohet në evolucionin e strukturës së popullsisë, duke e krahasuar atë me zhvendosjet migratore, ndërsa nënseksioni i dytë paraqet një model prove për të bërë një përcaktim të saktë të rolit që luajnë zhvendosjet migratore.

3.1.1 Ndryshimet në strukturën e popullsisë.

Popullsia shqiptare kaloi përmes ndryshimeve të mëdha në periudhën 1989-2001, duke ndikuar në madhësinë absolute, në shkallën e rritjes dhe në shpërndarjen sipas gjinisë dhe moshës (Tabela 19). Një analizë transversale e rezultateve të të dy Regjistrimeve, nxjerr në pah faktin që ka pasur një ulje të numrit të përgjithshëm të popullsisë që përfaqëson një kthesë të ndjeshme në tendencë, krahasuar me rritjen e fuqishme që

Është shumë e vështirë të analizosh migrimin total të shqiptarëve, veçanërisht zhvendosjet ndërkombëtare, për mungesë të të dhënave. Në këtë kapitull, ne përdorëm një analizë indirekte të ndikimit të migracionit në Shqipëri, i cili, është plotësuar me një model demografik që bën vlerësimin e numrit të personave që lanë vendin ndërmjet viteve 1989-2001. Lëvizjet e mëdha migratore të diskutuara në kapitujt pararendës, si edhe migracioni ndërkombëtar që ndodhi gjatë viteve '90, patën një ndikim jo vetëm në numrin absolut të popullsisë shqiptare dhe shpërndarjes së saj gjeografike, por gjithashtu, edhe në strukturën e brendshme të popullsisë (në bazë të gjinisë, moshës si edhe përbërjes social-ekonomike), në funksionin e përgjithshëm të ekonomisë dhe në infrastrukturën e vendit. Për të përshkruar këto elemente të ndryshme, ky kapitull krahason strukturën demografike në 2001, me Regjistrimin pararendës të popullsisë duke u përqëndruar në ato ndryshime që mund të lidhen me lëvizjet migratore. Kjo procedurë, së pari, zbatohet për të gjithë vendin, dhe më tej për një numër të ndryshëm të rajoneve, të cilat janë përcaktuar ose si funksion i një tipi të vendosjes (urbane ose rurale), ose si nëndarje territoriale (rrethet ose prefekturat). Megjithëse një pjesë e mirë e ndryshimit të modelit përsa i përket strukturës së moshës së popullsisë shqiptare (duke marrë parasysh atë të të gjithë vendit), ndodh për shkak të migracionit ndërkombëtar, kur bëhet fjalë për rajonet, edhe migrimi i brendshëm, natyrisht, mund të luajë rolin e vet. Për këtë arsye, është bërë një përpjekje për të përshkruar ndikimin e këtyre dy lëvizjeve migratore. Më tej, Kapitulli 4, flet për ndikimin që ka pasur migrimi në strukturën social-profesionale të rajoneve të saj. Në këtë rast i jemi referuar, në veçanti, ndryshimeve që kanë ndodhur që nga "Regjistrimi i Popullsisë 1989".

u vu re për shumë dekada deri në vitin 1990 (figura 2)..Ndërsa në Regjistrimin e 1989 numëroheshin 3 282 400 banorë, në atë 2001 numëroheshin vetëm 3 069 300 banorë. Kjo rënie prej 113 100 banorësh që përfaqëson 3,5 % të bazës së krahasimit të 1989, vjen si




një surprizë, duke pasur parasysh që shpërndarja moshore në 1989 ishte në formë të një piramide të rregullt, të karakterizuar nga një bazë e gjërë me brinjë anësore pak konkave, (shih figurën 3). Pra, në 1989, popullsia ishte shumë e re me “potencial të lartë rritjeje”, në kuptimin demografik, si pasojë e koeficientit të lindshmërisë më të lartë, krahasuar me rajonet e tjera të Evropës, (më shumë se tre femije për grua, Kombet e Bashkuara, 2001). Raporti ndërmjet grup-moshës nën 15 vjeç dhe popullsisë aktive (15-60 vjeç) ishte më i madh se 50% (krahasuar me 30% në Evropë në përgjithësi). Ndërsa raporti ndërmjet atyre që ishin në pension (60 dhe më të moshuar) me ata që ishin në moshë pune, nuk ishte as 10%, (krahasuar me pothuaj 20% të Evropës si një e tërë). Piramida e moshore e vitit 2001 tregon një shpërndarje krejtësisht të ndryshme të popullsisë. Ndryshimet kryesore janë në gërryerjet e bazës së piramidës që pasqyrojnë një rënie në numrin e lindjeve dhe një ngushtim të majës së piramidës, që i referohet grup-moshës 20-34 vjeç dhe flet për një shkallë të lartë emigracioni. Asimetria e piramidës në këtë lartësi, tregon që humbja e pjestarëve të popullsisë ka qenë me ekstreme midis të rinjve ekonomisht shumë aktive, në grup-moshën 20-34 vjeç dhe tek fëmijët e tyre.

Duke krahasuar të dhënat e “Regjistrimit të 2001 dhe të 1989”, numri i personave të grup-moshës 0-9 vjeç ra më 21% kundrejt numrit të përgjithshëm dhe për grup-moshat 20-34 vjeç, numri ra me 26% (figura 4). Shifrat tregojnë se grupi i meshkujve që lindën në fillimet e viteve ‘70, gjithashtu kanë pësuar një rënie prej 40%. Më fjalë të tjera, një segment i konsiderueshëm i këtij grupi, të cilët sot do të ishin në moshë për të ngritur familje, u larguan nga Shqipëria gjatë periudhës midis dy Regjistrimeve të popullsisë, duke sjellë një ulje të numrit të lindjeve, (gjatë një dekade, numri vjetor i lindjeve të regjistruara ka rënë më 25%, Kombet e Bashkuara, 2002).

Rënia e numrit të fëmijëve është pjesërisht rezultat i fenomenit të migrimit por edhe të ndryshimit të sjelles ndaj lindshmërisë: numri i të rinjve burrave dhe grave që arritën moshën për të ngritur një familje, aktualisht ka rënë në 22% krahasuar me 1989. Përsa i përket lindshmërisë, indeksi fëmijë për grua flet për një tendencë uljeje nga 3.3 në 1990 në 2.2% në 2000 (INSTAT, 2002). Numri i përgjithshëm i “grupit më të vjetër në moshë pune” (35-59 vjeç), nga ana tjetër, është rritur meqënëse numri i individëve që numërohen në këtë grup në 2001 ishte 886 000 krahasuar me 709 000 të 12 viteve të mëparshme (+25%). Në të njëjtën mënyrë, grup-mosha 60 vjeç e sipër, është rritur me 39% dhe tani numëron 11% të të gjithë popullsisë. Tendenca demografike e vërejtur gjatë viteve 1990 ka çuar në përsheptimin e fenomenit të mplaqjes së popullsisë. Raporti i banorëve me moshë mbi 60 vjeç është rritur nga 8% në 11% në një periudhë kohe ndërmjet dy “Regjistrimeve të Popullsisë”. Kjo rritje ishte më e dukshme tek burrat (+4% pikë), kurse tek gratë (+2.5% pikë), duke shprehur kështu, pabarazi gjinore në zhvendosjet migratore. Ndërsa koeficienti i varësisë së të rinjve nuk ndryshon shumë gjatë periudhës ndërmjet dy Regjistrimeve të popullsisë, koeficienti për të vjetrit u rrit në mënyrë të ndjeshme. Ky paradoks e ka burimin pjesërisht në natyrën përzgjedhëse

Figura 2. Ecuria e popullsisë së Shqipërisë 1950-2000.



Source: INSTAT

Tabela 19: Treguesit kryesorë demografikë, Shqipëri 1989 dhe 2001.

Gjinia	Popullsia 2001	Popullsia 1989	Koeficienti gjinor 2001	Koeficienti i varësisë në total 2001 (%)	Koeficienti i varësisë së të rinjve 2001 (%)	Koeficienti i varësisë së moshuarve 2001 (%)	Koeficienti i urbanizimit 2001 (%)
Meshkuj	1530443	1638074		59.3	48.0	11.2	41.8
Femra	1538832	1544343		57.3	44.7	12.6	42.6
Gjithsej	3069275	3182417	99.5	58.3	46.4	11.9	42.2

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

Koeficienti i varësisë së të rinjve = 0-14/15-64; Koeficienti i varësisë së të vjetërve = 65+/15-64;


Totali i koeficientit të varësisë = me koeficientin e varësisë së të rinjve + të të vjetërve;

Shkalla e urbanizimit = popullsinë urbane/ totali i popullsisë

të emigracionit (të rinjtë potenciale punuesish, e lenë vendin më shpejt se të tjerët), dhe në ndikimin e lëvizjes drejtpërdrejt tek koficienti i lindjeve si dhe pjesërisht në efektet strukturore, (një numër relativ i kohortit që ka lindur gjatë viteve '30, sot janë mbi 65 vjeç). Efekti i migrimit tek vendet e tjera ka qenë, tek zvogëlimi e numrit të popullsisë së të rinjve po edhe fëmijëve në të njëjtin raport me nivelet nën atë që pritej, por nuk ka pasur ndonjë influencë në numrin e popullsisë të moshës në pension. Kjo shpjegon faktin se raporti i të rinjve të varur ka mbetur i pandryshuar, me rëinen së bashku të numëruesit dhe

emëruesi, ndërsa raporti i të moshuarve të varur është rritur për shkak të rënies së emëruesit. Meqënëse zvogëlimi i numrit të të rinjve ishte dy herë më e madhe si për burrat, ashtu edhe për gratë, ka patur një ndryshim në raportin gjinor (i përcaktuar si numri i meshkujve kundrejt numrit të 100 femrave). Duke marrë për bazë popullsinë si një e tërë, në 1989 ka pasur pak më shumë burra se gra (106 burra për 100 gra). Por ky raport arriti një ekuilibër në 2001, me 99 burra për 100 gra. Duke marrë parasysh vetëm popullsinë në moshë pune (15-64 vjeç), ky raport ra me 10% pikë në - 98 burra për 100 gra. Këto


Figura 3: Piramida e moshës, Shqipëri 1989-2001.



Burimi: Regjistrimi i popullsisë të 1989 dhe 2001



Figura 4: Ecuria e madhësisë së grupmohave në periudhën 1989-2001, Shqipëri



Burimi: Regjistrimi i popullsisë të 1989 dhe 2001

rezultate tregojnë se emigrimi ishte, së pari dhe mbi të gjitha, një punë për burrat dhe veçanërisht për ata që ishin në moshë pune. Kjo konfirmon rezultatet e analizës kualitative të bërë nga IOM (1995), dhe Papaganos at Sanfey (2001).


3.1.2 Një model për të matur ndikimin e emigracionit ndërkombëtar.

Në dekadën e fundit, janë bërë një sërë përpjekjesh për të bërë vlerësimin e numrit të emigrantëve shqiptarë. Studimi i kryer nga Instituti i Statistikave në Shqipëri, (Van der Pol, 1992), u përpoq për herë të parë të bënte vlerësimin e këtij numri, duke përdorur një krahasim të popullsisë sipas gjinisë dhe moshës në "Regjistrimin e 1989" dhe të numrit të përgjithshëm të njerëzve të regjistruar në votime për zgjedhjet e përgjithshme të 31 marsit 1991 dhe 22 qershorit 1992. Pasi mori parasysh vdekshmërinë në këtë periudhë, autori vlerësoi se 220 000 emigrantë janë larguar nga Shqipëria, ndërmjet 1989 dhe mars 1992 dhe 300 000 ndërmjet 1989 dhe dhjetorit të 1992.

Në të njëjtën kohë, Instituti i Statistikave vlerësoi se 250 000 individë jetonin jashtë vendit në fund të 2002. Kjo shifër nuk përfshin punëtorët sezonalë në Greqi (INSTAT, 1993).

Për periudhën 1992-2001, nuk janë bërë vlerësime zyrtare. Megjithatë, ekspertët kanë dhënë disa shifra: në 1995 numri i emigrantëve ka mundësi të ketë qenë ndërmjet 450 000 dhe 500 000 (3/5 jetonin në Greqi, 1/5 në Itali dhe 1/5 në Evropën Perëndimore). Në 2002, rreth 750 000 jetonin jashtë vendit (referoju Papanagos, 2001 dhe të tjerë). Përsa i përket statusit të emigrantëve, sipas të dhënave, të paktën gjysma e emigrantëve ishin pa dokumenta. Sardon (2000), sugjeron që rreth 4/5 e 500 000 emigrantëve janë ilegalë, Morakvasic-Muller (2001), mendon se ndërmjet 250 000 dhe 500 000 njerëzve jetonin ilegalisht në Greqi, dhe Bribosia dhe Rea (2001), japin shifrën prej 100 000 deri 150 000 për imigrantët ilegale në Itali. Për të bërë vlerësimin e ndikimit të migracionit ndërmjet 1989-2001, lidhur me madhësinë dhe përbërjen e popullsisë shqiptare, ne sugjerojmë një model që mund të simulojë evolucionin demografik sikur të mos kishte pasur migracion. Vëzhgimet mbi

Figura 5: Krahasimi i strukturës së moshës të popullsisë shqiptare me dhe pa migrim, 2001



Burimi: Regjistrimi i popullsisë 2001 dhe llogaritjet e autorëve

koeficientët e lindjeve dhe të vdekjeve mund të aplikohen tek popullsia banuese më 1 prill 1989, pasi të merret si hipotezë se kufijtë e Shqipërisë ishin të mbyllura (bilanci dhe volumi zero i migrimit - referoju Le Bras, 1991).

Popullsia më 1 prill u vlerësua duke përdorur “Regjistrimin e 1989”. Të dhënat për lindjet e popullsisë u nxorën nga koeficientët e lindshmërisë ndërmjet 1989-2001 në bazë të të dhënave nga INSTAT. Vdekjet u vlerësuan mbi bazën e tabelave të vdekshmërisë, që u nxorën nga databaza e vdekshmërisë së Organizatës Botërore të Shëndetsisë. Duke marrë për bazë natyrën e të dhënave në dispozicion, u desh të bëheshin disa rregullime. Sapo u bë vlerësimi i tabelës së vdekshmërisë, u përlogaritën koeficientët për të ardhmen. Të dhënat e vdekshmërisë, si edhe të dhënat e lindshmërisë parashikojnë një koeficient pasaktësie, për faktin se shkalla e vlerësimit dhe koeficienti varen nga përfaqësia e “popullsisë në rrezik”. Mbi bazën

Tabela 20: Ndikimi i migracionit: treguesit demografikë që burojnë nga popullsia vëzhguar dhe e simuluar. 1989-2001

	Vëzhguar	Simuluar
Popullsia në 1989	3181693	3181693
Popullsia në 2001	3069275	3780654
Rritja në numër	-112418	598961
Koeficienti i rritjes në %	-3.5	18.8
Raporti gjinor (1989 : 106.1)	99.5	103.1
Shpërndarja sipas moshës		
0-19 (1989 : 43,1%)	38.9	37.0
20-39 (1989 : 32.8%)	28.7	32.9
40-64 (1989 : 18.8 %)	24.9	23.8
65-79 (1989 : 4,4%)	6.3	5.4
80+ (1989 : 0,9%)	1.3	0.9
Koeficienti i varësisë ¹		
Të rinj (1989 :83,6)	72.6	65.2
Të moshuar (1989 : 10,3)	14.1	11.1
Gjithsej (1989 : 93,8)	86.7	76.3
(1) Të rinj : 0-19 / 20-64; Të moshuar : 65+ / 20-64		

Burimet: Regjistrimi i Popullsisë 2001 dhe llogaritjet e autorëve



e së njëjtës metodologji, metoda e përdorur bazohet në hipotezën se migrantët dhe jo migrantët i nënshtrohen të njëjtit nivel rrezikshmërie për sa i përket vdekshmërisë dhe lindshmërisë, e cila jo gjithmonë vërtetohet në praktikë. Kjo do të thotë që rezultatet e nxjerra duhet të trajtohen me kujdes edhe kur kufijtë e magnitudës mund të jenë një pasqyrim i besueshëm i fenomenit migrator. Ndërkohë që popullsia shqiptare ishte 3.07 milion sipas "Regjistrimit të Popullsisë të 2001", ajo duhej të rritej tek 3,78 milion sikur të mos kishte emigracion. Ndryshimi ndërmjet dy shifrave flet për ndikimin në total të emigracionit, domethënë, afërsisht 710 000 individë (390 000 burra 320 000 gra). Ky ndikim mund të marrë dy forma të ndryshme: ndikim i drejtpërdrejtë (individë që kanë lënë vendin), dhe ndikim jo i drejtpërdrejtë (fëmijët e emigrantëve që kanë lindur jashtë shtetit). Ndikimi i drejtpërdrejtë e përfaqëson bilancin migrator që mund të shkojë deri në 600 000 dhe 650 000 individë, ndërsa ndikimi jo i drejtpërdrejtë është më pak se 100 000 individë. Më fjalë të tjera mund të themi se më shumë se 600 000 persona u larguan nga Shqipëria ndërmjet 1989-2001 dhe jetonin jashtë vendit në 2001 (Tabela 20).

Krahasimi ndërmjet modelit të bazuar në hipotezën e migracionit dhe situatës reale që trajtuam, jo vetëm na jep të dhënat për treguesit lidhur me numrin e popullsisë që do të ishte në qoftë se lëvizjet migratore të viteve '90 nuk do të kishin ndodhur, por gjithashtu paraqesin strukturën e popullsisë mbi bazë gjinie dhe moshe që do të ishte në qoftë se nuk do të kishte emigracion. Piramida e moshës, (figura 6), tregon se si do të ishte struktura e popullsisë shqiptare, nën hipotezën e kufijve të mbyllur dhe nënvizon qartësisht faktin se ishte grupi i moshës ndërmjet 20-40 vjeç në vitin 2001 që përbënin numrin më të madh të kandidatëve për emigracion. Tabela 20 paraqet një numër treguesish demografikë të përlogaritur lidhur me praninë e migracionit (sipas vëzhgimit të



realitetit), dhe si do të ishin ata në mungesë të migracionit (simulim). Përveç aspekteve numerike të përmendura më sipër, del qartë roli që ka luajtur migracioni në ndryshimin e bilancit ndërmjet grup-moshave dhe gjinisë.

3.2 Një ndikim i diferencuar i migracionit që varet nga tipi i vendosjes.

Një nga pasojat e migrimit ndërkombëtar (ashtu si dhe e migrimit të brendshëm) është krijimi i një disekuilibër serioz ndërmjet popullsisë urbane dhe rurale, duke shkaktuar një rishpërndarje në hapësirë të popullsisë së re në moshë pune. Në 1989, piramida e moshës së popullsisë urbane kishte një formë shumë të çrregullt, me tkurrje në majë për moshat nga 10 deri në 30 vjeç (në vigjilje të bumit të lindjeve), ndërsa popullsia rurale kishte një formë të rregullt piramidale.

Në 2001, situata u ndryshua me një ngushtim të ndjeshëm të piramidës së moshës për popullsinë rurale për moshën 25 vjeç, veçanërisht e ndjeshme për burrat dhe një piramidë më shumë në formë trekëndëshi për zonat urbane (figura 6). Rënia e popullsisë që u vërejt kur e marrim vendin si një të tërë, nuk është shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjithë territorin e saj, meqenëse zonat rurale humbën një numër të konsiderueshëm banorësh (-269800 domethënë -13%), ndërsa numri i banorëve në qytete u rrit me 14% (+156600). Për pasojë, popullsia urbane u rrit nga 35% kundrejt numrit të përgjithshëm në 42%. Shifrat flasin për diferenca gjinore: në zonat urbane rritja e popullsisë ka qenë më e madhe ndër gra (plus 94 600 persona - Tabela 21) sesa tek burrat (plus 62 000 persona), nga ana tjetër rënia në popullsinë rurale ka përfshirë më shumë burrat, (minus 169 600 persona), sesa gratë, (minus 100 200 persona). Si pasojë ka pasur një rënie të raportit gjinor me 7% pikë në fshat dhe 5% pikë në

Figura 6. Piramida e moshës sipas vendbanimit, Shqipëri 1989- 2001



Burimi: Regjistrimi i popullsisë të 1989 dhe 2001

qytet për të arritur pak a shumë nivele të njëjta (101 burra për 100 gra në zonat rurale dhe 98 burra për 100 gra në zonat urbane). Po të merret parasysh vetëm popullsia ekonomikisht aktive, rënia e raportit gjinor është 10% pikë në zonat fshatare dhe 7% pikë në zonat urbane (Tabela 21). Këto indekse - në veçanti ndryshimet në raportin gjinor, me më pak burra për 100 gra; flasin për faktin që ka një element predominant mashkullor në migracion. Po të marrim parasysh vëzhgimet në seksionin 2, kryesisht një migrim i brendshëm i dominuar nga gratë, ne mund të arrijmë në përfundimin se migrimi

ndërkombëtar është i dominuar nga burrat. Duke pasur parasysh se migracioni dallohet në bazë të gjinisë dhe vendit të zhvendosjes, raportet ndërmjet moshave ndryshojnë në shkallë të ndryshme për burrat dhe gratë. Duke marrë në konsideratë raportin e banorëve të moshave të ndryshme, vihet re një rënie më e thellë në raportin e burrave të rinj (grup moshat 20-34 vjeç) që jetojnë në zonat rurale se sa në atë të grave (4.5 pikë kundrejt 3 pikëve- Tabela 22). Në të njëjtën mënyrë, duke mbajtur parasysh totalin e popullsisë ekonomikisht aktive, dhe brenda saj, raportin ndërmjet grupit të personave në mosha pune



Tabela 21: Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit dhe gjinisë, Shqipëria 1989 dhe 2001

	Popullsia në 1989		Popullsia në 2001		Ecuria në numër	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Rurale	1060984	983871	891361	883718	-169623	-100153
Urbane	577090	560472	639082	655114	61992	94642
Gjithsej	1638074	1544343	1530443	1538832	-107631	-5511

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 1989 dhe 2001

dhe të të rinjve, situata është më e balancuar për gratë sesa për burrat në zonat rurale. Këto ndryshime janë më të theksuara tek popullsia urbane.

Raporti i grave të reja ekonomisht aktive arrin deri në 22%, ndërsa burrat e rinj ekonomisht aktivë përbëjnë më pak se 1/10 e popullsisë së përgjithshme mashkullore (19%). Me fjalë të tjera, popullsia e re dominohet nga rritja e numrit të femrave. Indeksi i rishikuar i krahut të punës i (përcaktuar si numri i grup-moshës 15 deri 40 vjeç pjestuar me numrin e grup-moshës 40-60 vjeç), konfirmon këtë teori.

Ndërsa ky indeks ka rënë në zonat fshatare me 59% dhe është stabilizuar në 217% për gratë, i njëjti raport ka rënë për burrat nga 275% në 200% (domethënë një rënie prej 75% pikësh). Në zonat urbane, përkundrazi, ka rreth 163 gra të reja për çdo 100 gra të moshuara, ndërsa tek burrat raporti është vetëm 143 kundrejt 100.

3.3 Ndikimi i migracionit në prefekturat dhe rrethet individuale.

Nuk mund të themi që të gjitha prefekturat në Shqipëri janë ndikuar në të njëjtën mënyrë nga lëvizjet migratore në pjesë të tjera të vendit ose në vende të tjera. Ndërsa disa prej tyre kanë pësuar një rritje të popullsisë, të tjerat, kanë pësuar një eksod serioz të shkaktuar nga lëvizja e shqiptarëve në vitet '90. Për ta thjeshtuar çështjen, mund të bëjmë një ndarje të prefekturave shqiptare në tre grupe të dallueshme:

Prefekturat përgjatë bregdetit plus Tiranën, të cilat përgjithësisht kanë fituar banorë në periudhën ndërmjet dy vrojtimeve të popullsisë; prefekturat në jug dhe juglindje të karakterizuara nga një sjellje demografike postranzicion - me shkallë të ulët lindjeje, por të cilat kanë humbur një numër të madh banorësh; dhe ato në veri gjithashtu të karakterizuara nga një zhvendosje e madhe emigracioni e cila më gjatë ka patur një ndikim më të vogël për shkak të sjelljes demografike tradicionale e karakterizuar nga një shkallë e lartë lindjesh. Po të përpiqeshim të përshkruanim secilën nga këto rrethe dhe prefektura, do të dilnim jashtë synimeve të raportit aktual. Në vend të kësaj Tabela 23, jep një ide të përgjithshme për vendin në tërësi dhe do të pasohet nga një vëzhgim më i afërt i tre karakteristikave të tendencave demografike, (Tirana, Tropoja dhe Saranda), të cilat janë të vecanta për Shqipërinë. Tabela

Tabela 22: Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit, gjinisë dhe moshës, shqipëri 1989-2001

Grupmosha	Popullsia në 1989				Popullsia në 2001			
	Urbane		Rurale		Urbane		Rurale	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
0-9 vjeç	20.7	19.5	24.3	24.0	17.5	15.9	20.6	19.7
10-19 vjeç	17.5	16.7	22.3	22.1	18.6	18.1	21.5	21.6
20-34 vjeç	27.9	29.4	26.3	25.2	19.3	22.0	21.8	22.6
35-59 vjeç	26.6	25.5	20.5	19.8	32.7	31.6	26.0	25.1
60 vjeç +	7.2	9.0	6.6	8.9	11.8	12.4	10.1	11.0
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 1989 dhe 2001

Tabela 23. Treguesit demografikë sipas prefekturave dhe rretheve të vendbanimit, Shqipëri 1989 dhe 2001

Prefektura/ rrethe	Popullsia 1989	Popullsia 2001	Ecuria	Migrimi i brendshëm neto	Koefiçienti gjinor	Koefiçienti i varësise në Gjithsej	Koefiçienti i varësise së të rinjve	Koefiçienti i varësise së të moshuarve	Koefiçienti i urbanizimit
Tiranë	368213	519720	151507	130819	100.1	53.0	40.8	12.2	67.8
Kavajë	81015	78179	-2836	-594	85.5	66.3	53.1	13.2	36.0
Gjithsej	449228	597899	148671	130225	98.1	54.6	42.3	12.3	63.7
Durrës	164484	181662	17178	37598	94.9	57.6	45.5	12.1	62.5
Krujë	54046	63517	9471	-27	99.8	61.9	51.9	9.9	30.5
Gjithsej	218530	245179	26649	37571	96.2	58.7	47.2	11.5	54.2
Elbasan	211948	221635	9687	-274	102.3	56.5	46.6	9.9	43.1
Gramsh	43565	35750	-7815	-8931	103.5	61.6	52.1	9.5	29.5
Librazhd	71982	72387	405	-9069	104.1	62.3	52.7	9.5	16.0
Peqin	30002	32964	2962	-1604	100.0	63.1	53.6	9.5	22.0
Gjithsej	357497	362736	5239	-19878	102.6	58.7	49.0	9.8	34.4
Fier	204137	199082	-5055	-2891	98.7	57.2	45.5	11.7	38.3
Lushnje	134280	143933	9653	4709	101.3	56.7	45.9	10.8	26.6
Mallakatër	40925	39529	-1396	2989	105.2	58.1	47.9	10.1	23.2
Gjithsej	379342	382544	3202	4807	100.3	57.1	45.9	11.2	32.3
Lezhë	62001	67734	5733	5573	95.4	61.1	49.5	11.6	24.5
Kurbin	52806	54392	1586	3882	97.2	61.7	51.5	10.2	43.1
Mirditë	50447	37056	-13391	-10703	95.5	61.8	49.6	12.2	24.9
Gjithsej	165254	159182	-6072	-1248	96.0	61.5	50.2	11.3	31.0
Berat	136461	127837	-8624	-12242	102.4	54.4	44.4	10.0	35.6
Kucovë	39937	35338	-4599	1402	99.0	54.0	42.8	11.2	51.0
Skrapar	46503	29845	-16658	-10576	102.6	52.6	41.7	10.9	44.4
Gjithsej	222901	193020	-29881	-21416	101.8	54.1	43.7	10.4	39.8
Shkodër	192505	185395	-7110	-476	97.0	60.4	46.8	13.7	46.3
Pukë	48969	34386	-14583	-13617	101.4	67.1	56.0	11.1	17.5
Malësi e madhe	43784	36692	-7092	-1500	93.8	67.1	52.5	14.7	11.1
Gjithsej	285258	256473	-28785	-15593	97.1	62.2	48.8	13.5	37.4
Kukës	79421	63786	-15635	-26006	100.9	73.4	64.1	9.2	26.1
Has	21881	19660	-2221	-3168	97.1	80.8	72.1	8.7	16.4
Tropojë	44779	27947	-16832	-12965	100.6	66.0	54.6	11.4	26.8
Gjithsej	146081	111393	-34688	-42139	100.2	72.7	63.0	9.7	24.5
Dibër	99368	85699	-13669	-30139	102.3	68.3	58.8	9.5	16.4
Bulqizë	50282	42968	-7314	-4188	98.8	68.8	59.4	9.4	23.2
Mat	76674	61187	-15487	-13075	99.2	65.1	53.9	11.2	22.8
Gjithsej	226324	189854	-36470	-47402	100.5	67.4	57.3	10.0	20.0
Gjirokastër	66373	54647	-11726	498	101.1	55.0	40.1	14.9	41.8
Përmet	39775	25780	-13995	-6118	102.1	56.8	40.8	16.0	38.2
Tepelenë	49850	32404	-17446	-8792	102.0	58.3	45.5	12.8	34.8
Gjithsej	155998	112831	-43167	-14412	101.6	56.3	41.8	14.5	39.0
Korcë	177127	142909	-34218	-9288	100.7	53.3	38.0	15.3	41.2
Kolonjë	24781	17161	-7620	-3946	102.7	55.5	39.6	15.9	43.6
Devoll	38094	34641	-3453	-1186	101.4	53.5	38.0	15.5	19.4
Pogradec	71446	70471	-975	-3175	103.6	56.4	45.3	11.1	33.7
Gjithsej	311448	265182	-46266	-17595	101.7	54.3	40.0	14.3	36.5
Vlorë	176788	147128	-29660	4478	96.9	58.4	44.5	13.9	57.9
Delvinë	23785	10765	-13020	-200	103.1	60.0	35.6	24.4	38.1
Sarandë	63983	35089	-28894	2802	103.2	58.6	40.8	17.8	41.5
Gjithsej	264556	192982	-71574	7080	98.3	58.5	43.4	15.2	53.8
Gjithsej	3182417	3069275	-113142	0	99.5	58.3	46.4	11.9	42.2

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 1989 dhe 2001



23, ka përfshirë një numër treguesish demografikë të cilët qartësisht nxjerrin në pah tendencat më të rëndësishme migratore të viteve '90 veçanërisht lëvizjen sipas të cilës popullsia u përqëndrua më shumë në bregdetin shqiptar (popullsia e rrethit të Tiranës u rrit me 41% dhe prefektura e Durrësit me 12%). Të dy këto rajone qendrore tani strehojnë rreth 30% të popullsisë së vendit krahasuar me 23% në 1989.

Prefekturat e Fierit dhe Elbasanit gjithashtu pësuan një rritje të popullsisë. Vlen të përmendet, gjithashtu, një farë polarizimi i lëvizjes së brendshme migratore shpesh mashkullore drejt dy porteve kryesore detare të Shqipërisë në Durrës dhe në Vlorë, të cilat janë si vendndalim për nisjen jashtë vendit. Paralelisht me to, rajonet rurale në veri dhe lindje të vendit po humbasin popullsinë si rezultat i migrimit të brendshëm dhe në një shkallë më të ulët të migrimit ndërkombëtar.

Rrethi i Lezhës përbën një përjashtim nga kjo tendencë, meqënëse ai shërben si një magnet për të gjithë rajonin duke tërhequr migrantët nga rrethet pranë tij. Sa i përket rajoneve të jugut ato karakterizohen nga një rënie shumë e ndjeshme e popullsisë kryesisht për shkak të emigrimit ndërkombëtar, pjesa dërrmuese e të cilët shkon në drejtim të Greqisë, dhe nga një përshpejtim i vjetërsimit të popullsisë dhe koeficientit të ulët të lindjeve.

Të tre rrethet që do të diskutohen më poshtë janë më përfaqësueset dhe flasin për shumëllojshmërinë e efekteve socio-demografike për shkak të migracionit të brendshëm dhe ndërkombëtar. Shembulli i Tiranës flet për efektet e përqëndrimit të popullsisë në rajonet qendrore të vendit, shembulli i Tropojës si një nga rrethet më veriore të vendit tregon efektet e emigracionit në shkallë të lartë në drejtim të qendrës së vendit dhe shembulli i Sarandës, i vendosur në pjesën ekstreme jugore në kufi me

Greqinë, përfaqëson të dhënat demografike të rajonit që janë ndikuar nga migracioni i rëndësishëm ndërkombëtar.

3.3.1 Tirana

Rrethi i Tiranës është një nga katër rajonet e Shqipërisë që kanë fituar nga një rritje popullsisë gjatë kohës ndërmjet dy Regjistrimeve. Të tjerat janë prefekturat e Elbasanit, Lezhës dhe Fierit. Popullsia e Tiranës aktualisht u rrit me 151 500 banorë ndërmjet dy Regjistrimeve, domethënë (41%), me një mbizotërim të lehtë të grave (rritje prej 78 200 dhe 73 300 burra). Rreth 88% e kësaj rritjeje të popullsisë mund t'i atribuohet bilancit pozitiv të zhvendosjeve të brendshme migratore drejt Tiranës. 2/3 e këtyre migrantëve të brendshëm, domethënë, (105 000 individë) jetojnë sot brenda në qytet, 1/3 jeton në zonat rurale të rrethit të Tiranës. Raporti i popullsisë së rrethit që jeton në zonën urbane ka mbetur konstant në 68%. Tirana, në këtë mënyrë, ka përfituar nga lëvizjet e brendshme që ndodhën gjatë viteve '90 dhe ka luajtur një rol qendror në eksodin rural që ka qenë karakteristik për Shqipërinë.

Shpërndarja moshore e popullsisë në rrethin e Tiranës, natyrisht, ka ndryshuar shpejt si rezultat i shtesave migratore që vinin nga pjesë të tjera të vendit. Kjo tregohet qartë në piramidën e moshës në figurën 7. Ndërsa në vitin 1989, kjo piramidë paraqiste brinjë konkave në majë të moshës më pak se 25 vjeç, e plotësuar më një bazë të gjerë, 12 vjet e kanë ndryshuar strukturën e lartësisë së moshës së re, meqënëse sot është grup-mosha 5-19 vjeç që përfshin këto breza më numrin më të madh, grup-moshat 20-24 vjeç dhe 0-4 vjeç janë më të pakta. Për një numër të ndryshëm grup-moshash mbi 40 vjeç, struktura e piramidës është më pak e dhëmbëzuar sesa ishte në të kaluarën. Në përgjithësi, raporti i moshave 0-19 vjeç në

popullsi mbetet, praktikisht, i njëjti me atë të viteve 1989-2001, ndërkohë që raporti i të rinjve ka rënë dhe raporti i më të vjetërve në moshë pune është rritur. Ky përsëri, është një fenomen që hap rrugën e interpretimit nën dritën e migracionit. Ajo që ka ndodhur është se emigracioni i brendshëm që buron nga prefekturat e tjera, ka mbushur boshllëkun e krijuar nga emigracioni ndërkombëtar i një pjese të të rinjve që banojnë në Tiranë. Vlen gjithashtu të përmendet se piramida e moshës flet për një rritje të numrit të grave, që vjen si rezultat i faktit që burrat më shumë se sa grate, emigrojnë jashtë vendit.

Popullsia rurale dhe urbane e rrethit të Tiranës paraqet karakteristika të modeleve antagoniste që janë prezente në popullsinë shqiptare. Shpërndarja moshore e popullsisë rurale ka mbetur përafërsisht e qëndrueshme dhe ka një strukturë relativisht të re. Brenda popullsisë urbane, nga ana tjetër, procesi i mplakjes ka përparuar ndjeshëm në bazën e piramidës, që flet për një formë konkave që rritet vazhdimisht. Kjo sjell si pasojë një koeficientë varësie të një të riu për çdo tre të


rritur në moshë pune në zonat urbane, krahasuar përafërsisht me dy të rinj për çdo të rritur në moshë pune në zonat rurale (shifra e saktë është 1 person për çdo 1.6 të rritur).

3.3.2 Tropoja

Rrethi i Tropojës kryesisht malor dhe bujqësor, i vendosur në kufi me Kosovën, është një shembull i evolucionit të popullsisë në veri të Shqipërisë. Në 1989, popullsia ishte shumë e re dhe karakterizohej nga një piramidë moshore me një bazë shumë të gjerë (me rreth 50% të popullsisë me moshë nën 20 vjeç). Kjo është në kundërshtim me situatën në 2001, kur baza e popullsisë së piramidës moshore u përgjysmua, kur secili grup është më i vogël se grupi paraardhës.

Maja e piramidës hollohet duke pasqyruar moshën e re të forcës së punës dhe grupmosha 50-64 vjeç konfirmon ekzistencën e fenomenit të migracionit masiv. Tropoja ka humbur 16 800 banorë (30%) brenda një

Figura 7: Piramida e moshës, rrethi i Tiranës 1989, 2001



Burimi: Regjistrimi i popullsisë të 1989 dhe 2001



periudhe 12 vjeçare dhe është në këtë mënyrë rrethi i Shqipërisë që është shpopulluar në mënyrë të ndjeshme. Shumica (13 000 persona, 77%) e kësaj humbjeje në banorë ka ndodhur për shkak të një balance migratore të ndjeshme negative. Afërsisht 30% e popullsisë së regjistruar në “Regjistrimin e 1989”, është larguar për të jetuar diku gjatë në Shqipëri. Këto shifra konfirmojnë rezultatin e një analize të kohëve të fundit, e cila përcakton se veriu i Shqipërisë është burimi kryesor i një migrimi të brendshëm (INSTAT 2002). Autorë të tjerë janë përpjekur të gjejnë arsyen e emigrimit shqiptar nëpërmjet evidencave nga mikrodata (Kule A. të tjerë 2002). Ato, gjithashtu, përcaktuan variablet, të cilat mund të shpjegojnë vendimin për të qendruar brenda vendit. Së pari, arsytet familjare, së dyti arsye të moshës (tepër i ri ose tepër i vjetër) dhe së treti dashuria për vendin dhe shtëpinë.

Duke pasur parasysh mënyrën tradicionale të jetesës, si dhe karakterin familjar të migracionit joselektiv, këto evidenca mund të jenë një përgjigje e mundshme për pyetjet se pse njerëzit që erdhën nga veriu nuk tentuan të largohen nga vendi. Duke pasur parasysh koeficientin e lartë të lindjeve në rreth, humbjet reale që lidhen me lëvizjet migratore nuk janë marrë parasysh nga shifrat e publikuara. Një analizë mbi jetëgjatësinë tregon që i grupet të lindur rreth viteve 1970-1979, aktualisht humbën 36% të numrit të tyre ndërmjet dy Regjistrimeve, ndërsa ata të lindur ndërmjet viteve 1950-1959 patën një rënie prej 32%.


Si pasojë e këtij emigracioni të fshehtë, i cili ndikoi në grupet që lindën ndërmjet viteve 1960-1980 si dhe tek fëmijët e tyre më shumë se tek të tjerët, raporti relativ i të rinjve (mosha 20-34 vjeç) në popullsi ra në mënyrë të ndjeshme. Një mplakje e shpejtë e popullsisë zuri vend. Në këtë mënyrë, raporti i grupmoshës 35-50 vjeç, u rrit me 5% pikë dhe qendroi tek 24% në 2001, një rritje që ishte më e dukshme ndër gra sesa ndër burra.

Koeficienti i varësisë për moshën e vjetër, që qëndroi në 9% në '89 (4% në zonat urbane dhe 10% në zonat rurale) arriti 11% në 2001. Karakteri selektiv i migrimit është gjithashtu impresionues, veçanërisht migrimi ndërkombëtar, ai ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme koeficientin gjinor në këtë rreth. Ndërsa emigracioni i brendshëm karakterizohet nga një përfshirje e njëjtë e burrave dhe grave (më 6 500 emigrantë të brendshëm secili), rënia e përgjithshme e popullsisë është më e madhe tek burrat sesa tek gratë: për të qenë më të saktë 56% tëk burrat dhe 44% tek gratë.

Të rinjtë në moshë pune në veçanti u larguan nga rrethi më shumë se sa gratë e së njëjtës moshë, sic mund të vihet re përgjatë kurbës së migracionit, me një dominim të meshkujve e që ndiqet më tej nga femrat. Numri absolut i burrave me moshë 20-34 vjeç u zvogëlua me 3 396 individë (ose -55% krahasuar me 1989), ndërsa numri absolut i grave ra me 2011 individë (ose -38%). Për këtë arsye, koeficienti gjinor në rreth ra me 11% pikë ndërmjet 1989-2001 (11 pikë në zonat rurale dhe 8 pikë në zonat urbane). Sot ka po aq gra sa edhe burra që jetojnë në Tropojë, megjithëse kjo situatë nuk është e balancuar për të gjitha grupmoshat (figura 9). Duke marrë parasysh ata në moshën e punës (15-64 vjeç) koeficienti është konsiderueshëm jashtë ekuilibrit.

Ai lëviz nga 113 burra për 100 gra në 1989, në 96 burra për 100 gra në 2001. Në zonat rurale ky raport ra me 17% pikë (97 burra për 100 gra) krahasuar me 13% pikë në rajonet urbane (93 burra për 100 gra). Analiza e jetëgjatësisë së popullsisë, sidoqoftë, tregon që ky fenomen është më kompleks.

Pjesa dërrmuese e migrantëve që i takon grupeve të lindur ndërmjet 1970-1979 (të cilët ishin 10-19 vjeç në 1989), janë burra dhe koeficienti gjinor i këtyre emigrantëve është 170 burra për 100 gra. Pra duket të ketë përfshirë të rinjtë që lënë rrethin e vendlindjes

Figura 8: Piramida e moshës, rrethi i Tropojës 1989 dhe 2001

Burimi: Regjistrimi i popullsisë të 1989 dhe 2001

në kërkim të një pune ose për studime. Emigrantët që i takojnë grupeve të lindur ndërmjet 1955 dhe 1969, nga ana tjetër, janë më të paktë dhe kryesisht gra (78% e totalit). Duke qenë se prefektura e Tropojës është kryesisht bujqesore, po të qëndrosh në shtëpi nuk mund të kesh ofertë dhe perspektivë për punë, fakt ky që i nxit gratë kur ato nuk janë të martuara që të largohen. Një shpjegim tjetër i mundshëm mund të jetë bashkimi familjar: gruaja largohet për t'u bashkuar me kryefamiljarin, sapo që ky i fundit ka gjetur punë jashtë rrethit të vendbanimit.


Brezat më të vjetër karakterizohen përsëri nga një dominancë e burrave ndër emigrantët. Këta mund të jenë baballarët e familjeve që janë detyruar të pranojnë një punë diku tjetër ose që të paktën përpiqen të gjejnë punë për të siguruar jetesën e pjesës tjetër të familjes. Hipoteza e një strategjie familjare (Stark 1991), sipas së cilës fenomenet migruese janë pjesë e një procesi vetregullues ndërmjet familjes dhe atij që largohet, (domethënë kryefamiljarit

ose të riut), nuk mund të provohet këtu, por, mund të përbëjë një shpjegim të mundshëm. Rezultati përfundimtar është se, si pasojë e migrimit të të rinjve, balanca ndërmjet grupeve social-profesionale dhe anëtarëve aktivë dhe jo aktivë të popullsisë ka ndryshuar thellësisht. Një rivështrim i kësaj situate, bën Tropojën të jetë tashmë një rreth me një nivel popullsie të vjetëruar, të barabartë me nivelet e regjistruara në vendet e Evropës Perëndimore, që tregon se ka patur një rritje në moshën e pensionit, si metoda e vetme e mundshme për të garantuar një forcë pune të përshtatshme. Ka një pikë tjetër të fundit dalluese, për popullsinë e Tropojës, krahasuar me pjesën tjetër të Shqipërisë, ajo që, transformimi i strukturës moshore dhe humbja e individëve të grupmoshës 20-34 vjeç, nuk nuk ka qenë i shoqëruar nga zhogelimi i numrit të fëmijëve.

Sot ende raporti është dy fëmijë të moshës 0-4 vjeç për çdo 5 gra në moshë riprodhimit



Figura 9. Raporti gjinor i popullsisë vendase dhe popullsisë që emigroi ose vdiq (1989-2001), Rrethi i Tropojës, 2001



Burimi: Regjistrimi i popullsisë të 1989 dhe 2001

(15-49 vjeç), raport që tregon se koeficienti i lindshmërisë është ende i lartë. Në disa nga rrethet të tjera veriore të Shqipërisë, për shembull në Kukës, ky koeficient është akoma më i lartë, me një fëmijë për çdo dy gra. Sjellja riprodhuese tradicionale duket se akoma karakterizon disa rajone të Shqipërisë.

3.3.3 Sarandë

Rrethi i Sarandës shtrihet në ekstremin jugor të Shqipërisë duke përbër një shembull ilustrimi për pasojat e fenomenit migrues që kanë ndodhur në këtë rajon. Në 1989, popullsia e Sarandës kishte 64 000 banorë dhe karakterizohej nga një piramidë me formë të çrregullt. Ka një dallim të qartë ndërmjet grupeve të lindur përpara 1949, nga të cilët shumë pak janë banorë vendas dhe atyre që kanë lindur më vonë, të cilët përbëjnë një grup më të madh. Pra popullsia e rrethit është shumë e re.

Midis 1989-2001 Saranda humbi 45% të popullsisë së saj dhe arriti shifrën 35 100 banorë (Figura 10). Kjo humbje e popullsisë


shpjegohet së pari dhe mbi të gjitha me migracionin ndërkombëtar; bilanci migrator i brendshëm neto është pozitiv. Ky vëzhgim mbështet pikëpamjen e një numri autores, të cilët besojnë se Shqipëria e Jugut është burimi kryesor për emigracionin ndërkombëtar, kryesisht në Greqi dhe Itali (INSTAT 2002, Morokvasic-Muller 2001, Leibich 1997). Piramida e moshës në 2001 nuk tregon vetëm për një rënie të numrit të fëmijëve (që duket qartë në tkurrjen e bazës së piramidës), por gjithashtu edhe humbjet në numrin e grupmoshës 20-39 vjeç dhe më pak e grupmoshës 45-59 vjeç. Numri i të rinjve ekonomikisht aktivë të grupmoshës 20-34 vjeç ranë me 63% ndërmjet 1989-2001, domethënë 11 300 individë. Tani ata përbëjnë vetëm 19% të popullsisë krahasuar me 28% në vitin 1989. Kjo tendencë ka qenë paralelisht me zvogëlim të raportit të fëmijëve të grup-moshës 0-9 vjeç që sot është vetëm 16%, që është niveli më i ulët në të gjithë Shqipërinë. Në ndryshim nga veriu, emigracioni nga Saranda u dominua nga gratë, për këtë arsye koeficienti gjinor u rrit nga 94 në 103 burra për 100 gra, ndërmjet 1989 dhe 2001.

Si pasojë e këtyre tendencave, grupmosha 34 vjeç e sipër, ka marrë më shumë rëndësi. “Grupmosha më e vjetër aktive” tani përbënë 35% të popullsisë (+5% pikë krahasuar me 1989) dhe grupmoshën e pensionistëve numërojnë 11% +5 pikë. Ndryshe nga të gjithë grupmoshat e tjera të cilat kanë pësuar humbje në numër, popullsia mbi 65 vjeç është rritur me 3% (ose 99 individë), ndërmjet dy Regjistrimeve. Përgjithësisht, numri i pensionistëve është i barabartë me 18% me numrin e popullsisë në moshë aktive për punë (përkundrajt 7% që ishte në 1989). Në këtë mënyrë, emigracioni masiv ka patur një ndikim të madh në përshpejtimin e fenomenit të mplakjes së popullsisë, duke duke e privuar rrethin në mënyrë të ndjeshme prej e popullsisë të re dhe gjithashtu duke kufizuar numrin e të lindurve. Vlen të përmendet se ka një predominancë rurale në humbjet në numër që përshkruam më sipër⁸.

Humbja aktuale e individëve në zonat rurale kap shifrën 34 500, ose 56% të popullsisë të

1989. Në zonat urbane popullsia ra vetëm 28%, raporti i popullsisë që jetojnë në zonat urbane në anën tjetër u rrit nga 29% në 1989, në 40% në 2001, gjë që tregon për ekzistencën e një eksodi masiv rural. Emigracioni nga Saranda e Delvina është kompleks dhe përbëhet pjesërisht nga eksodi rural drejt qendrave duke hapur në këtë mënyrë procesin e urbanizimit, dhe pjesërisht emigrimin drejt prefektuarave të tjera ose vendeve të tjera. Mund të renditen disa arsye për të shpjeguar këtë fenomen migrator në jug. Njëra prej tyre është, vështirësia me të cilat u përballën bujqit kur ju kthye toka, në vitet pas rënies së komunizmit dhe riorganizimit të bujqësisë, mund të ketë detyruar një numër të madh të njerëzve të emigrojnë drejt qyteteve dhe jashtë vendit. (De Harper, 2000). Afërsia etnike, gjuhësore dhe fetare ndërmjet epirotëve me minoritetin grek që jetojnë në Shqipërinë e jugut dhe me Greqinë, si dhe tërheqja ndaj këtij vendi për shkak të nevojës për një numër të madh punonjësish sezonale (OECD 99) janë dy

Figure 10: Piramida e moshës, rrethi i Sarandës 1989, 2001



Burimi: Regjistrimi i popullsisë të 1989 dhe 2001

⁸Në këtë seksion Saranda dhe Delvina janë marrë së bashku



faktorë të tjerë që mund të shpjegojnë shkallën e lartë të emigrimit. Të tjerë faktorë gjithashtu mund të përmenden në veçanti afërsia gjeografike. Kufiri me Greqinë mund të kalohet dhe me këmbë. Dallimet në të ardhurat ekonomike ndërmjet dy vendeve janë shumë të mëdha, dhe ky mund të jetë edhe një faktor që shpjegon migrimin. Siç u parashtrua në këtë kapitull, emigrimi pret 600 000 deri 650 000 persona Ndërmjet viteve 1989-2001 dhe lëvizjet e brendëshme të popullsisë kanë patur ndikime të ndryshme për sa i përket secilit rajon. Faktorët më evidentë janë rënia historike e popullsisë shqiptare, intensifikimi i urbanizimit dhe procesi i mplakjes së popullsisë. Rënia më e madhe e popullsisë ndikon në grupmoshan e re 20-34 vjeç, veçanërisht tek burrat. Ne gjithashtu mund të propozojmë një model specifik gjinor migracioni për Shqipërinë: burrat tentojnë më shumë se gratë të migrojnë jashtë vendit, ndërsa gratë tentojnë më shumë drejt migrimit të brendshëm.

4

Ndikimi i lëvizjeve migratore mbi ecurinë e ekonomisë.

4.1 Ndikimi i migrimit mbi popullsinë në moshë pune.

4.1.1 Prirjet kryesore të tregut të punës.


Është më se e logjikshme që qysh në fillim të pranohet fakti se janë ndeshur një numër prirjesh të përgjithshme të lidhura, veçanërisht, me rritjen e moshës së daljes në pension nga 54 deri 64 për gratë dhe nga 59 deri 64 për burrat, hyrë në fuqi gjatë viteve '90. Ky ndryshim institucional e bën akoma më komplekse matjen e ndikimit neto të migrimit mbi tregun e punës, meqenëse ka patur dhe luhatje në balancin midis moshave.

Popullsia në moshë pune.

Si rrjedhojë e kësaj mase, është shtuar popullsia e aftë për punë duke u rritur nga 1,833,000 në 1989, në 1,939,100 në 2001, që korrespondon me 58% të të gjithë popullsisë në 1989 dhe me 63% të saj në 2002. Kjo rritje

Ndryshimet politike të viteve '90, hapja ekonomike e Shqipërisë dhe shkalla e lartë e lëvizjeve migruese në drejtim të vendeve të tjera, të gjitha këto së bashku ushtruan ndikimin e tyre mbi zhvillimin e ekonomisë shqiptare (shih për shembull: Instat, në botim). Në vijim të demokratizimit të vendit, u përcaktua radha e reformave ekonomike (privatizimi, mosmbajtja nën kontroll e çmimeve, e kështu me radhë) objektivi i të cilave ishte rigjallërimi i infrastrukturës prodhuese të vendit, e cila u dëmtua seriozisht gjatë viteve '80. Industria, e cila përbënte 42% të GDP në 1980, pësoi ulje të konsiderueshme që nga ajo kohë (11.5% në 2001), ndërsa bujqësia dhe sektori i shërbimeve fituan terren në ekonominë e vendit (51% dhe 19%, respektivisht të GDP; Treichler, 2002). Ky tranzicion ekonomik çoi në zhvillime pozitive ekonomike, megjithëse në përmasa modeste. Ekonomia shqiptare që në vitin 1995 ka mbetur tepër e varur nga prurjet e kapitalit nga jashtë vendit dhe nga prodhimet e huaja, pa përmendur këtu tronditjen e madhe të shkaktuar nga kolapsi i skemës mashtroese të 'piramidës financiare' në vitin 1997 (Gëdeshi, 2000). Që nga ajo kohë, ka patur disa përpjekje për ta ringritur ekonominë dhe për të siguruar një rritje pozitive të saj. Megjithatë, vendi ende varet në masë të gjërë nga transfertat e fondeve, që vijnë pjesërisht nga firmat e huaja dhe pjesërisht nga emigrantët (të cilët tranferojnë një shumë të përgjithshme të barabartë me 25% të GDP së Shqipërisë; Gëdeshi, 2000). Të dhënat e regjistrimit të popullsisë ofrojnë një numër treguesish mbi marrëdhëniet që ekzistojnë midis migrimit dhe ecurisë së ekonomisë. Është kjo arsyeja që në këtë kapitull kemi përfshirë një sasi informacioni mbi mënyrën sesi lëvizjet migratore ndikojnë mbi popullsinë në moshë pune, mbi kapitalin njerëzor të popullsisë shqiptare (nivelin e arsimimit) dhe popullsinë e saj aktive, si dhe mbi zhvillimin e zonave urbane e rurale dhe prefekturat e veçanta që mbulojnë ato.

tërësore është rrjedhojë e drejtpërdrejt e ndryshimit të moshës së pensionit, që do të thotë se 116,200 individë të tjerë janë mbajtur



në tregun e punës në 2001 (të moshës 55-64 për gratë dhe 60-64 për burrat). Një nga efektet e kësaj mase ka qenë theksimi i mplakjes demografike të krahut të punës, e cila gjithsesi ka qenë theksuar me largimin nga vendi i tyre i punëtorëve në moshë të re. Në vijim të pakësimit të popullsisë së grupmoshës 15-39 dhe shtyrjes së moshës së daljes në pension, popullsia e moshës prej 40-64 përbën tanimë më shumë se gjysmën e popullsisë (53%) së përgjithshme të aftë për punë. Moshë mesatare e popullsisë po ashtu është ngritur dhe shënoi 36 vjeç në 2001, krahasuar me 34 vjeç në 1989. Siç jepet në piramidën e moshës së njerëzve të aftë për punë (Figura 11), gratë përbënin numrin më të madh në 2001 (me një raport gjinor prej 98 burrash për 100 gra, krahasuar me 114 në 1989). Kjo shpjegohet me faktin që rritja e moshës së pensionit ishte më e lartë për gratë se për burrat (10 dhe 15 vjet, respektivisht), si dhe nga diferencalet gjinore në përbërjen e emigrimit ndërkombëtar.

Numri i popullsisë mashkullore në moshë për punë zbriti me 2% midis viteve 1989 e 2001, ndërsa popullsia femërore u rrit me 14%. Veprimtaria ekonomike tani funksionon mbi bazën e një krahu pune ku gratë përbëjnë peshën më të madhe specifike, megjithëse

po të llogaritet numri i personave të zënë me punë, ende rezultojnë që numri më i madh i personave të zënë në punë janë burrat.

Popullsia aktive nga pikëpamja ekonomike.

Prej numrit 1,939,100 të personave në moshë për punë në Shqipëri në vitin 2001, vetëm 1,347,300 klasifikoheshin si 'ekonomikisht aktivë'⁹, që i korrespondon shifrës prej 69%. Kjo shifër pat rënë me 18% në krahasim me 1989. Ndër burrat u shënuar një rënie prej 3%, ndërsa ndër gratë prej 33%. Ndeshen interpretime të ndryshme përse i përket pyetjes përse një pjesë e popullsisë femërore të jetë tërhequr nga veprimtaria ekonomike.

Një faktor është, sigurisht, kthimi në vlerat tradicionale të familjes, sipas të cilave gratë duhet të përgjigjen për mirëmbajtjen e shtëpisë, ndërsa burrat të punojnë jashtë saj (INSTAT, 2002). Në anën tjetër, janë vetë kushtet që mbizotërojnë në tregun e punës

⁹Termi 'aktiv nga pikëpamja ekonomike' përfshin si ata që janë në punë ashtu dhe ata që kërkojnë një vend pune. 'Popullsia inaktive' përbëhet nga studentë, pensionistë të moshuar, të pa-aftët për punë dhe njerëzit që nuk kërkojnë punë.

Tabela 24: Treguesit e krahut të punës, Shqipëria 1989 dhe 2001

	1989			2001			Ecuria		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Të punësuar	1443167	779271	663896	1041775	649646	392129	-401392	-129,625	-271,767
Të papunë	156599	62435	94164	305506	150098	155408	148907	87,663	61,244
Popullsia ekonomikisht aktive	1599766	841706	758060	1347281	799744	547537	-252485	-41,962	-210,523
Popullsia ekonomikisht joaktive	233,237	136,797	96,440	591,793	161,218	430,575	358,556	24,421	334,135
Popullsia në moshë ekonomikisht aktive	1,833,003	978,503	854,500	1,939,074	960,962	978,112	106,071	-17,541	123,612
Koeficienti i aktivitetit (%) 1	87.3	86.0	88.7	69.5	83.2	56.0			
Koeficienti i punesimit (%) 2	78.7	79.6	77.7	53.7	67.6	40.1			
Koeficienti i papunesisë (%) 3	9.8	7.4	12.4	22.7	18.8	28.4			

1 Popullsia ekonomikisht aktive / Popullsia në moshë ekonomikisht aktive

2 Të punësuar / Popullsia në moshë ekonomikisht aktive

3 Të papunësuar / Popullsia ekonomikisht aktive

Burimet: Regjistrimi i popullsisë në 1989 dhe 2001.

Regjistrimi i 1989: meshkujt 15-59 vjeç, femrat 15-54 vjeç.

Regjistrimi i 2001: meshkuj e femra 15-64 vjeç (përfshirë këtu edhe 4,136 punëtorë më të moshuar -65+).

dhe në veçanti, vështirësitë me të cilat ndeshen femrat për gjetjen e një vendi pune, si dhe varësia në masë të konsiderueshme nga të hollat që dërgojnë në familje bashkëshortët që punojnë në vendet e tjera (shuma që transferohet në këtë mënyrë vlerësohet të jetë midis 300 dhe 400 milionë dollarë çdo vit; Courier des Balkans, 2001; Gëdeshi 2000), gjë që po ashtu ka peshën e vetë për këtë dukuri (më shumë se 20,000 gra të martuara jetonin pa bashkëshortët e tyre në kohën e regjistrimit të popullsisë në 2001). Tabela 24 tregon se ndër gratë u rrit numri i atyre që u larguan nga tregu i punës (numri i atyre që nuk kishin veprimtari ekonomike u rrit me një faktor prej 4.5), ndërsa

ndër burrat u rrit përqindja e papunësisë. Sot, numri i personave në kërkim të punës është i barabartë midis dy gjinive, në një kohë kur pjesa e popullsisë pa veprimtari ekonomike po zotërohet gjithmonë e më shumë nga gjinia femërore. Papunësia shënonte 10% në vitin 1989 dhe u rrit në 23% në 2001. Kjo shifër është më e lartë për gratë sesa për burrat. Struktura moshore së popullsisë ekonomikisht aktive tregon një rritje në grupmoshën 40+ (prej +15%), dhe një rënie në grupmoshën 15-39 (prej -46%) gjatë periudhës midis dy Regjistrimeve të popullsisë. Numri i individëve të aftë për punë në grupmoshën 25-29 të zënë aktualisht me punë, ra në 60.8% ndër burrat dhe në 69.5%

Tabela 25: Shpërndarja e popullsisë së punësuar sipas gjinise dhe moshës shqipëria 1989 dhe 2001

Moshë	1989			2001			Ecuria 1989-2001 (%)		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
15-19	138364	68274	70090	124512	69990	54522	-10.0	2.5	-22.2
20-24	211816	91729	120087	78992	35743	43249	-62.7	-61.0	-64.0
25-29	276909	145887	131022	97109	57161	39948	-64.9	-60.8	-69.5
30-39	423568	223471	200097	271454	180124	91330	-35.9	-19.4	-54.4
40-49	263657	148940	114717	281230	182879	98351	6.7	22.8	-14.3
50+	142985	112189	30796	188478	123749	64729	31.8	10.3	110.2
Pa të dhëna	365	199	166			
Gjithsej	1457664	790689	666975	1041775	649646	392129	-28.5	-17.8	-41.2

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 1989 dhe 2001



ndër gratë (Tabela 25). Në skajin e kundërt të shkallës krahasuese, numri i burrave të grupmoshës 40-49 të aftë për punë dhe të zënë aktualisht me punë u rrit me 23% dhe i grave mbi 50 vjeç me më shumë se 110%. Këto prirje çuan si në një zhvendosje të raportit gjinor të popullsisë së aftë për punë të zënë aktualisht me punë, ashtu dhe në mplakjen e kësaj popullsie. Brenda grupmoshës 20-24 vjeç raporti burrë grua është 83 burra për çdo 100 gra, ndërkohë që në të gjitha grupmoshat e tjera ka një mbizotërim të dukshëm të meshkujve. Kjo dukuri, e pranishme që në vitin 1989, është ndoshta rezultat i një mbi-përfaqesimi të burrave në skemat e treinimeve. Në kundërshti me këtë, mbi-përfaqësimi i burrave në grup-moshat mbi 25 vjeç theksohet më tej. Për aq kohë që mplakja e popullsisë ekonomkisht aktive aktualisht të zënë me punë është shqetësuese, kjo pasqyrohet në një proporcion të grupmoshës 40+ prej 45% të të gjithë të punësuarve krahasuar me 28% në 1989. Nga ana tjetër, proporcioni i 20-29 vjeçarëve ra nga 33% në 17% (Tabela 25). Kështu pra, mund të dallohet që ndryshimet më të rëndësishme që u vunë re në Shqipëri në periudhën midis dy Regjistrimeve të popullsisë, kishin të bënin me zgjatjen e kohës në punë dhe mplakjen e popullsisë, pjesërisht, edhe për shkak të emigrimit të moshës më të re të krahut të punës. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm është rritja e proporcionit mashkullor të krahut të punësuar, në dallim me proporcionin e rritur të popullsisë femërore në moshë pune. Faktorët që kontribuan për këto ndryshime nuk duhet të kërkohen vetëm në rritjen e lëvizjeve migratore. Ata duhet të konsiderohen edhe në dritën e transformimit të ekonomisë për pasojë të ndryshimeve politike, dhe pjesërisht edhe në lidhje me zhvendosjen prapa drejt një perceptimi tradicional të një çifti të martuar.¹⁰

¹⁰ Moshë mesatare e një gruaje në moshë martesë në vitin 1999 ishte 23.5. Rezulton që martesë ishte një dukuri thujasë universale deri të paktën në fillim të viteve nëntëdhjetë, dhe numri i lindjeve mbetet i lartë – Këshilli i Europës 2002

4.2 Migrimi dhe zhvillimi i tregut të punës

Në kontekstin e një tregu pune që është në transformim e sipër, lëvizjet migratore luajnë një rol të vërtetë, por që është i vështirë të matet me saktësi, meqenëse faktorët që do të mund të shpjegojnë këto prirje janë tepër të ndërthurur me njëri - tjetrin. Megjithatë, duke përdorur një metodë përshkuese nga njera anë, dhe atë të simulimit demo-ekonomik nga ana tjetër, mundësohet nxjerrja e një numri linjash interpretimi. Ky është dhe qëllimi kryesor i këtij seksioni të veçantë, i cili nxjerr në pah një vlerësim të ndikimit të migrimit mbi kapitalin njerëzor (në lidhje me nivelin e arsimimit të popullsisë shqiptare) dhe mbi popullsinë ekonomkisht aktive të gatshme për punë. Në këtë fazë, analiza përqendrohet mbi situatën e vendit në tërësi, ndërsa ndikimi i lëvizjeve të brendshme migratore nëpër rrethe trajtohet në seksionin në vazhdim. (4.3).

4.2.1 Ndikimi i migrimit mbi kapitalin njerëzor dhe nivelin e kualifikimit.

Të dhënat nga një sërë burime tregojnë qartë që imigrimi në Europën Perëndimore (nga cilido vend i origjinës) prek si një popullsi me nivel të ulët arsimor, ashtu dhe atë me nivel të lartë kualifikimi. Ata që kanë një nivel kualifikimi mbi mesataren kanë prirje për të emigruar më pak. Në rastin e Shqipërisë, ekziston një konfirmim shumë i qartë i kësaj dukurie dhe, në veçanti, i një 'migrimi të madh të trurit'. Nga mjediset universitare dhe shkollat e mesme, nga Qendrat Studimore Shkencore dhe Institucionet Artistike e Kulturore, kanë emigruar jo më pak se 27% e personelit nga viti 1991 deri në 1994 (Misja.V., Gëdeshi I. – Emigracioni i Elitës Intelektuale) dhe 13% më shumë nga 1995 dhe 1998. Proporcioni i të emigruarve nga mjediset universitare arrin në 60% të mësuesve (Courier des Balkans, 2001). Strukturat e e

Tabela 26: Shpërndarja e popullsisë 6 vjeç e lart sipas nivelit të arsimit, Shqipëria 1989 dhe 2001

Niveli i arsimit	1989			2001			Ecuria 1989-2001 (%)		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Arsimi fillor	597093	299861	297232	509825	246489	263336	-14.6	-17.8	-11.4
Arsimi 8-vjeçar	1065558	563155	502403	1109756	549992	559764	4.1	-2.3	11.4
Arsimi i mesëm	664917	358452	306465	535871	283058	252813	-19.4	-21.0	-17.5
Arsimi i lartë	137316	90288	47028	134110	78947	55163	-2.3	-12.6	17.3
Gjithsej	2464884	1311756	1153128	2289562	1158486	1131076	-7.1	-11.7	-1.9

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 1989 dhe 2001

migrimit të elitës intelektuale në tregun ndërkombëtar kanë tiparet e tyre nga pikëpamja sociale, gjeografike dhe demografike. Strukturat sociale dhe demografike të emigrimit të studiuesve me kualifikim të lartë karakterizohen nga mosha e tyre e pjekur, nga një pjesëmarrje relativisht e gjërë e femrës në proceset emigratore (32% e emigrantëve janë femra), dhe nga emigrimi në familje (62% e personave me kualifikim të lartë kanë emigruar me familjet e tyre). Kjo popullsi ka emigruar në Kanada, Francë, SHBA, Gjermani dhe Angli, dhe më pak, në Itali e Greqi. Largimi i individëve me një nivel të ulët kualifikimi, që kërkojnë të provojnë fatin e tyre jashtë vendit (kryesisht në Itali e Greqi) është, po ashtu, një fakt i konfirmuar nga disa

autorë (Kule, 2002). Ky kontekst migrator të çon në një modifikim në strukturën e popullsisë së klasifikuar sipas nivelit të arsimit.¹¹ Po të merret në konsideratë e gjithë popullsia, atëherë humbja në numër ka ndikuar fillimisht mbi popullsinë që ka mbaruar shkollën e mesme dhe më lart (vetëm meshkujt), por edhe mbi ata që nuk kanë vazhduar shkollën e mesme (Tabela 26). Nga ana tjetër, është shtuar popullsia me nivel arsimor më të ulët se shkolla e mesme. Krahasimi i shifrave të disponueshme për 1989 dhe 2001 (të cilat i referohen të gjithë popullsisë me moshë mbi 6 vjeç), pasqyron, jo vetëm një dukuri të një migrimi selektiv, por ndikon edhe në lidhjet me nivelin present të shkollës në Shqipëri, si dhe tiparet e atyre që

Tabela 27: Shpërndarja e popullsisë në moshë pune sipas nivelit të arsimit, Shqipëria 2001.

Moshë	Meshkuj				Femra			
	Arsimi fillor	Arsimi 8-vjeçar	Arsimi i mesëm	Arsimi i lartë	Arsimi fillor	Arsimi 8-vjeçar	Arsimi i mesëm	Arsimi i lartë
15-19	8.0	81.2	10.8	0.0	5.9	81.3	12.8	0.0
20-24	3.9	65.7	26.8	3.6	2.6	62.6	28.0	6.9
25-29	2.3	57.5	33.5	6.6	1.8	54.1	35.1	8.9
30-34	2.3	54.1	35.3	8.3	2.1	55.5	34.6	7.7
35-39	2.7	51.4	38.6	7.3	2.9	56.8	34.2	6.1
40-44	3.4	48.1	39.4	9.1	5.4	54.7	33.8	6.1
45-49	6.8	43.7	36.3	13.1	13.8	48.8	29.2	8.3
50-54	16.4	40.0	28.5	15.2	33.6	40.3	18.9	7.2
55-59	32.3	35.8	20.0	11.9	54.0	30.5	11.8	3.7
60-64	43.2	29.6	17.5	9.7	65.0	23.3	9.3	2.4
Gjithsej	9.3	54.2	28.9	7.6	12.4	55.7	26.2	5.7

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

¹¹ Për arsye praktike, janë përdorur klasifikimet si vijon: a) arsimi fillor që zgjat deri në katër vjet, b) arsimi i detyrueshëm tetëvjeçar që zgjat gjithsej 7-8 vjet, që mund të pasohet me një vit ose edhe më pak arsimim profesional, c) shkolla e mesme dhe d) tipat e ndryshëm të arsimit të lartë universitar.



kanë vdekur në periudhën midis 1989 dhe 2001. Megjithëse po ta marrim vendin në tërësi, niveli i arsimimit mund të ketë qendruar konstant, kjo ndoshta vjen në sajë të përmirësimit të mundësisë së shkollimit. Përsa i takon atyre që janë me nivel më të lartë arsimor, është vënë re një rënie e numrit të burrave, por jo e numrit të grave, gjë që ndoshta mund të shpjegohet me diferencat gjinore në koeficientin e emigracionit të këtyre grupeve. Shpërndarja meshkuj/femra në bazë të nivelit të arsimimit, po ashtu, tregon një ekuilibër gjinor më të madh ndër ata që kanë ndjekur arsim më të lartë, që lidhet me largimet më të shpeshta të meshkujve me kualifikim universitar, por gjithashtu edhe me faktin që është bërë më e lehtë për femrat që të ndjekin arsimin e lartë. Sot, kjo kategori provon të ketë një koeficient 143 burra për çdo 100 gra, krahasuar me 192 në 1989.

Në popullsinë në moshë pune, numri i atyre që kanë marrë arsim të lartë është më i vogël se 7% (meshkujt 7.6%, femrat 5.7%), ndërsa 28% e kësaj popullsie ka marrë arsim të mesëm. Ndërsa statistikat për gjininë femërore, tregojnë një rritje të nivelit të edukimit në grupmoshat më të reja, në krahasim me grupmoshat më të rritura. Kjo dukuri nuk është e njëjtë për gjininë tjetër pasi grupmosha 45-49 vjeç aktualisht është me një mesatare më të lartë arsimimi sesa grupmosha 25-29. Migrimi ndërkombëtar do ta vështirësojë në të ardhmen zvendësimin e nëpunësve që dalin në pension për vende pune ku kërkohet një nivel i lartë kualifikimi (Tabela 27). Prirjet duket se konfirmojnë faktin që emigrimi ndërkombëtar ka përfshirë mbi të gjitha ata që kanë përfituar nga arsimitet e tetëvjeçar dhe i mesëm, si dhe ata që nuk kanë shkuar tej arsimin fillor. Kjo është duke kontribuar në një fenomen homogjenizimi për popullatën shqiptare, përsa i përket niveleve të arsimimit. Ata që kanë arsim më të ulët se tetëvjeçarja kanë prirje të qëndrojnë në vendin e tyre, ndërsa ata që kanë arsim më të lartë kanë prirje të largohen.

4.2.2 Ndikimi i migrimit mbi krahun aktiv të punës.

Edhe në mungesë të emigrimit, numri i popullsisë ekonomiksht aktive do të kishte rënë për llogari të tkurrjes së kefiçientit të punësimit midis grave, e cila nuk shkaktohet nga rritja e moshës së daljes në pension. Kështu, duke përdorur modelin e përshkruar në Kapitullin 3 dhe zbatimin e tij për popullatën që do të regjistrohej po të mos kishte migrim të saj (metoda e simulimit), do të kishim një zbritje prej 100,000 në numrin e popullsisë në punë në vitin 2001, e cila mund të ballafaqohet me numrin aktual prej 415,000. Me fjalë të tjera dhe duke mbajtur një farë rezerve, mund të vlerësohet që migrimi ka ndihmuar në uljen në tri të katërtat të numrit të popullsisë ekonomiksht aktive dhe aktualisht të zënë në punë, duke marrë parasysh kufijtë e metodës së simulimit e cila nuk llogarit mekanizmat e hyrjes në tregun e punës.

4.3 Ndikimi i migrimit mbi popullsinë rurale dhe urbane në moshë pune.

4.3.1 Ndikimi i migrimit të brendshëm mbi punësimin nëpër rrethe.

Prirjet e tregut të punës, të përshkruara më lart, nuk janë shfaqur në mënyrë të njëtrajtshme nëpër territorin e Shqipërisë, dhe kjo ka ardhur si pasojë, deri në një farë shkalle, e flukseve migratore të brendshme. Kështu, me lëvizjet migratore të shfaqura në zonat rurale dhe urbane, numri i personave në moshë pune u rrit me 14% në periudhën midis 1989 dhe 2001 në qytetet e vogla dhe të mëdha, ndërsa u pakësua me 4% në fshat (Tabela 28). Shpërndarja hapësinore e personave në moshë pune pasqyrohet me një rënie shumë më të theksuar në rradhët e popullsisë ekonomiksht aktive që banon në zonat rurale (284,000 më pak të punësuar)

sesa në zonat urbane (117,400). Analiza e numrit të të papunëve na jep një pamje të diferencuar: rritja e numrit të papunësisë urbane (+108,100 ose + 132%) ka qenë shumë më e lartë se ajo e papunësisë rurale (+40,800 ose 5%), ku numri i grave në kërkim të punës ka shkuar në ulje.

Ky është një tjetër fakt i njërës prej rrjedhëve më të dokumentuara të ekzodit rural; me tejkalimin e numrit të imigrantëve mbi një shifër të caktuar, infrastrukturat urbane dhe strukturat ekonomike nuk arrijnë të integrojnë gjithsecilin në botën e punës. Ekzodi rural ka ndihmuar, në këtë mënyrë, në një ndarje funksionale të territorit shqiptar. Ekziston një dallim i qartë midis atyre zonave që karakterizohen nga një model tradicional i jetës, me gra të shumta në numër që tërhiqen nga tregu i punës dhe në ato zona që karakterizohen nga një përqendrim i

veprimtarisë ekonomike, duke u shndërruar në këtë mënyrë në zona të tejnigopura që nuk arrijnë të integrojnë krahun e punës të ardhur rishtas. Analiza e numrit të punëmarrësve sipas grup-moshës ofron elemente të tjera për kuptimin e kësaj dukurie, duke sjellë në pah një plakje shumë të theksuar si të popullatës aktive rurale, ashtu dhe të asaj urbane (Figura 12). Në krahasim me 1989, popullsia rurale e punësuar e grup-moshës 20-29 ka humbur më shumë se 96,000 individë, dhe grup-mosha 25-29 ka humbur më shumë se 110,000 (Tabela 29). Në zonat urbane humbjet respektive për të njëjtat grup-mosha kanë qenë 36,500 dhe 68,100. Tek moshat midis 30 dhe 39 vjeç, numri i anëtarëve të humbur të popullsisë ekonomiksht aktive aktualisht të zënë në punë ka qenë i njëjtë me tipin e vendbanimit, ndërsa në grup-moshën 40+, shfaqen përsëri prirje të ndryshme. Në zonat urbane është rritur

Tabela 28: Treguesit e krahut të punës sipas vendbanimit, Shqipëria 1989 dhe 2001

	1989			2001			Diferenca		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Rurale									
Të punësuar	906659	494,431	412,228	622708	386,906	235,802	-283951	-107,525	-176,426
Të papunë	75192	28,642	46,550	116032	76,047	39,985	40840	47,405	-6,565
Popullsia ekonomiksht aktive	981851	523,073	458,778	738740	462,953	275,787	-243111	-60,120	-182,991
Popullsia ekonomiksht joaktive	152,860	90,911	61,949	352,125	83,610	268,515	199,265	-7,301	206,566
Popullsia në moshë ekonomiksht aktive	1,134,711	613,984	520,727	1,090,865	546,563	544,302	-43,846	-67,421	23,575
Koeficienti i aktivitetit (%) 1	86.5	85.2	88.1	67.7	84.7	50.7			
Koeficienti i punesimit (%) 2	79.9	80.5	79.2	57.1	70.8	43.3			
Koeficienti i papunesisë (%) 3	7.7	5.5	10.1	15.7	16.4	14.5			
Urbane									
Të punësuar	536508	284840	251668	419067	262740	156327	-117441	-22,100	-95,341
Të papunë	81407	33793	47614	189474	74051	115423	108067	40,258	67,809
Popullsia ekonomiksht aktive	617915	318633	299282	608541	336791	271750	-9374	18,158	-27,532
Popullsia ekonomiksht joaktive	80,377	45,886	34,491	239,668	77,608	162,060	159,291	31,722	127,569
Popullsia në moshë ekonomiksht aktive	698,292	364,519	333,773	848,209	414,399	433,810	149,917	49,880	100,037
Koeficienti i aktivitetit (%) 1	88.5	87.4	89.7	71.7	81.3	62.6			
Koeficienti i punesimit (%) 2	76.8	78.1	75.4	49.4	63.4	36.0			
Koeficienti i papunesisë (%) 3	13.2	10.6	15.9	31.1	22.0	42.5			

1 Popullsia ekonomiksht aktive / Popullsia në moshë ekonomiksht aktive

2 Të punësuar / Popullsia në moshë ekonomiksht aktive

3 Të papunësuar / Popullsia ekonomiksht aktive


Burimet: Regjistrimi i popullsisë në 1989 dhe 2001.

Regjistrimi i 1989: meshkujt 15-59 vjeç, femrat 15-54 vjeç.

Regjistrimi i 2001: meshkuj e femra 15-64 vjeç (përfshirë këtu edhe 4,136 punëtorë më të moshuar -65+).



Figura 12. Piramida e popullsisë të punësuar (15 vjeç e lart), sipas vendbanimit, Shqipëria 1989 dhe 2001.



Burimi: Regjistrimi i popullsisë të 1989 dhe 2001

popullsia mashkullore e zënë në punë, ndërsa popullsia femërore ka ruajtur një karakter të stabilizuar. Në zonat rurale shihet një rritje e numrit të grave me moshë 40+ që punojnë, ndërsa numri i burrave ka mbetur relativisht i stabilizuar. Është për t'u vënë në dukje që numri i adoleshentëve të grupmoshës 15-19 vjeç të zënë në punë në zonat urbane është rritur atje ku vendet e punës

kërkojnë një nivel të ulët kualifikimi, por jo në zonat rurale. Megjithatë, proporcioni i adoleshentëve të zënë në punë mbetet më i lartë në fshat. Numri relativisht i lartë i personave në moshë më të madhe midis popullatës së punësuar mund të shpjegohet me ekzodin rural. Lejimi i banorëve të zonave rurale që të shkojnë për punë në ndonjë qytet të vogël apo të madh krijoi një mundësi të

Tabela 29: Ecuria dhe shpërndarja e popullsisë të punësuar sipas vendbanimit, gjinisë dhe moshës, Shqipëria 1989-2001.

Grupmosha	Ecuria e popullsisë së punësuar				Popullsia e punësuar sipas grupmoshës			
	(1989-2001)				(në % të totalit, 2001)			
	RURALE		URBANE		RURALE		URBANE	
	meshkuj	femra	meshkuj	femra	meshkuj	femra	meshkuj	femra
15-19	-5571	-23453	7287	7885	13.0	16.1	7.6	10.6
20-24	-38548	-57750	-17438	-19088	7.4	11.9	2.7	9.7
25-29	-54522	-57136	-34204	-33938	10.3	9.9	6.5	10.6
30-39	-19553	-58481	-23794	-50286	27.5	20.9	28.1	26.9
40-49	5277	-10193	28662	-6173	24.3	22.3	33.8	29.3
50+	-4226	28784	15786	5149	17.5	18.9	21.3	13.0
Gjithsej	-117279	-178343	-23764	-96503	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 1989 dhe 2001

hapur për të gjithë të rriturit në moshë, pavarësisht nga mosha e tyre. Lejimi për të shkuar jashtë shtetit, nga ana tjetër, është një proces më selektiv, dhe të papriturat e tij të shumta apo distancat më të largëta që ndajnë emigrantët nga familjet e tyre, frenojnë largimin e punëmarrësve më në moshë (Dahinden, 1998). Struktura moshore dhe gjinore tregon mjaft qartë pasojat e tipit mashkullor të migrimit: burrat e moshës midis 20 dhe 29 vjeç zënë vetëm 9.2% të të gjithë personave të zënë në punë në zonat urbane krahasuar me 20.3% për gratë. Në një analizë të fundit, migrimet e brendshme kanë një ndikim komplimentar ose ndihmës mbi ekonominë në krahasim me migrimet jashtë vendit të lindjes. Nga ana tjetër, ato ndikojnë shumë mbi çpopullimin e fshatit, meqenëse pjesa më e madhe e migriemeve drejtohen prej rajoneve periferike drejt qendrave urbane. Nga ana tjetër, këto lëvizje migratore kompensojnë pjesërisht largimet jashtë vendit të banorëve të qendrave, duke ofruar krah pune që është ose shumë i ri në moshë (vjeç 15-19), ose është në gjysmën e dytë të jetës së tij aktive

(vjeç 40-64) dhe me një nivel kualifikimi që nuk është domosdoshmërisht i lartë (Tabela 29).

4.3.2 Ndikimi i migrimit të brendshëm mbi kapitalin njerëzor të rretheve.

Shqiptarët me nivel arsimimi më të lartë po përqendrohen gjithmonë e më shumë nëpër zonat urbane. Kjo dukuri është vënë në dukje nga Regjistrimi i popullsisë në 2001, sipas të cilit 46% e individëve me kualifikim tetëvjeçar e lart ishin të përqëndruar nëpër qytetet e vogla dhe të mëdha, krahasuar me vetëm 16% në zonat rurale. Në 1989 kjo kategori përbënte 22% në zonat rurale dhe 50% në ato urbane. Midis këtyre dy datave, zonat rurale humbën afërsisht 41% të numrit të individëve me arsim të lartë, ndërsa zonat urbane e rritën këtë numër me 9% (kjo rritje kishte të bënte vetëm me gratë, meqenëse për këtë kategori u bë më e lehtë të vazhdonte arsimin e mesëm). Në këtë mënyrë, migrimi ka shkaktuar një pasojë qartësisht të dukshme në pakësimin e kapitalit njerëzor të kualifikuar të zonave

Tabela 30: Shpërndarja e popullsisë me moshën 6 vjeç e lart sipas nivelit të arsimimit dhe venbanimit, Shqipëria, 1989-2001

	1989			2001			Ecuria (%)		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Rurale									
Arsimi fillor	429623	221111	208512	329047	163367	165680	-23.4	-26.1	-20.5
Arsimi 8-vjeçar	764317	400818	363499	743908	367408	376500	-2.7	-8.3	3.6
Arsimi i mesëm	309998	183906	126092	186133	111768	74365	-40.0	-39.2	-41.0
Arsimi i lartë	31657	23955	7702	18708	12661	6047	-40.9	-47.1	-21.5
Gjithsej	1535595	829790	705805	1277796	655204	622592	-16.8	-21.0	-11.8
Arsimi fillor	28.0	26.6	29.5	25.8	24.9	26.6			
Arsimi 8-vjeçar	49.8	48.3	51.5	58.2	56.1	60.5			
Arsimi i mesëm	20.2	22.2	17.9	14.6	17.1	11.9			
Arsimi i lartë	2.1	2.9	1.1	1.5	1.9	1.0			
Urbane									
Arsimi fillor	167470	78750	88720	180778	83122	97656	7.9	5.6	10.1
Arsimi 8-vjeçar	301241	162337	138904	365848	182584	183264	21.4	12.5	31.9
Arsimi i mesëm	354919	174546	180373	349738	171290	178448	-1.5	-1.9	-1.1
Arsimi i lartë	105659	66333	39326	115402	66286	49116	9.2	-0.1	24.9
Gjithsej	929289	481966	447323	1011766	503282	508484	8.9	4.4	13.7
Arsimi fillor	18.0	16.3	19.8	17.9	16.5	19.2			
Arsimi 8-vjeçar	32.4	33.7	31.1	36.2	36.3	36.0			
Arsimi i mesëm	38.2	36.2	40.3	34.6	34.0	35.1			
Arsimi i lartë	11.4	13.8	8.8	11.4	13.2	9.7			

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 1989 dhe 2001



Tabela 31: Popullsia e arsimuar në moshë pune, sipas nivelit arsimor, gjinisë dhe vendbanimit, Shqipëria 2001.

	Arsimi fillor		Arsimi 8-vjeçar		Arsimi i mesëm		Arsimi i lartë		Gjithsej	
Meshkuj										
rurale	63837	12.0	345935	65.0	109873	20.7	12319	2.3	531964	100.0
urbane	23340	5.7	162958	40.1	160996	39.6	59099	14.5	406393	100.0
Gjithsej	87177	9.3	508893	54.2	270869	28.9	71418	7.6	938357	100.0
Femra										
rurale	81929	15.7	359780	68.9	74241	14.2	5992	1.1	521942	100.0
urbane	34965	8.3	166593	39.4	173719	41.0	48057	11.4	423334	100.0
Gjithsej	116894	12.4	526373	55.7	247960	26.2	54049	5.7	945276	100.0

Burimi: Regjistrimi i Popullsisë 2001

rurale, dhe një numër studimesh e kanë lidhur këtë rënie me emigrimin ndërkombëtar (Le Courier des Balkans 2000). Nga ana tjetër, ka baza të mendohet që fluksi i brendshëm migrator drejt qendrave lidhet, gjithashtu, me persona vetëm me arsim fillor, pjesa më e madhe e të cilëve gra që zhvendosen drejt qyteteve për të shërbyer në sektorë që mjaftohen me një nivel të ulët kualifikimi (Tabela 30). Studimi i profilit arsimor të popullsisë në moshë pune e bën të mundur zbulimin e strukturës së arsimit mbi të cilën mbështeten ekonomitë rurale dhe urbane në Shqipëri (Tabela 31). Është qartësisht e dukshme, në veçanti, që ka një përqindje shumë të vogël personash me arsim më të lartë dhe pjesa dërrmuese të tyre me arsim tetëvjeçar. Një nga rezultatet e dukurisë së migrimit bipolar (largimi i trurit në njërin anë dhe emigrimi i individëve me nivel të ulët arsimor nga ana tjetër) është që ekonomia shqiptare tani mbështetet kryesisht mbi një popullatë me nivel të mesëm arsimor dhe shumë homogjene nga pikëpamja e kualifikimeve arsimore.

4.4 Ndikimi i migrimit mbi gjendjen ekonomike të prefekturave.

Një vështrim i shpejtë mbi gjendjen e tregut të punës të prefekturave dhe të rretheve flet për pabarazi rajonale shumë të theksuara (Tabela 32). Mund të jetë e vështirë që të lidhen prirjet e niveleve të punësimit me lëvizjet migratore, por, megjithatë, nga vërtetimi i

tabelës rezultojnë që ato rrethe që kanë bilanc pozitiv migrator nuk përfitojnë ndonjë gjendje më të mirë ekonomike, në krahasim me ato rrethe që kanë humbur pjesë të popullsisë së tyre nga kjo dukuri. Migrimi, sigurisht, nuk është vetëm një përgjigje për mundësi të tjera profesionale, por është edhe një projek për jetën, një dëshirë për t'u larguar nga vendi i origjinës, gjë që disa herë shoqërohet me humbje të mundësisë së punësimit. Një studim më i hollësishëm i katër rretheve tipike do të ndihmojë në qartësimin e kësaj ideje.

4.4.1 Rrethi i Tiranës.

Siç është vënë më parë në dukje, Tirana është një nga polet kryesore të imigrimit të brendshëm dhe popullsia e saj nga 15 deri 64 vjeç u rrit me 51% midis 1989 dhe 2001. Presioni migrator sigurisht ka krijuar tensione në tregun e saj të punës dhe niveli i punësimit ka zbritur (në 70% krahasuar me 89% në 1989). Gratë janë ato që kanë ndier ndikimin më të madh të kësaj rënieje të nivelit të punësimit dhe papunësia femërore sot qendron në shifrën e 34%. Pavarësisht nga kjo, Tirana është i vetmi rreth në Shqipëri që ka krijuar vende pune të reja nga 1989 në 2001 dhe numri i personave në punë shënoi një rritje të lehtë. Kjo tregon qartë pabarazitë hapësinore përsa i takon rritjes ekonomike: në 1989, 82% e ndërmarrjeve të huaja dhe 40% e të gjitha ndërmarrjeve shqiptare ishin vendosur në Tiranë (UNICEF 2000). Megjithatë, janë të dukshme disa tipare të

Tabela 32: Treguesit e krahut të punës (sipas përkufizimit në 1989 dhe 2001).

Rrethet e Shqipërisë 1989 dhe 2001.

Rrethet	Popullsia në moshë pune		% aktive në grupmoshën 15-34		Koefficienti i aktivitetit		Koefficienti gjinor i pop.ek.aktive		Koefficienti i papunësisë		Migrimi neto
	2001	1989	2001	1989	2001	1989	2001	1989	2001	1989	
Tiranë	339764	224955	48.1	60.2	70.5	88.8	140.4	106.5	25.4	12.5	130,819
Durrës	162285	147156	45.1	63.6	71.5	88.8	123.2	109.3	23.9	13.0	37,004
Krujë	72882	62492	51.5	66.0	69.3	87.8	159.4	110.8	24.0	15.4	3,855
Elbasan	161815	35457	53.0	65.0	69.5	87.0	136.9	106.4	12.9	9.2	-1,878
Gramsh	22122	27338	54.8	67.1	74.3	81.7	156.0	112.8	25.1	7.7	-8,931
Librazhd	44612	136361	56.9	66.1	76.1	88.0	155.3	111.4	22.1	11.4	-9,069
Fier	151668	23329	48.1	64.8	72.5	85.9	144.5	109.6	17.7	4.6	98
Lushnje	91845	38185	50.2	65.3	72.5	85.3	139.2	112.1	17.5	8.3	4,709
Lezhë	42036	143695	50.0	65.9	72.3	88.4	140.8	111.1	19.5	10.1	5,573
Mirditë	22902	78381	55.6	67.4	75.2	87.9	121.6	111.3	14.9	6.3	-10,703
Berat	105717	101897	49.9	65.1	77.0	88.2	131.4	110.8	19.8	9.6	-10,840
Skrapar	19554	26482	49.6	64.6	78.7	83.9	122.6	115.2	17.0	4.9	-10,576
Shkodër	137528	136541	46.9	62.6	69.8	87.8	140.8	111.5	26.9	7.9	-1,976
Pukë	20580	25498	58.9	67.8	70.2	83.1	150.9	115.6	26.8	6.8	-13,617
Dibër	76392	80356	55.7	66.7	68.4	84.2	173.8	113.9	25.6	6.3	-20,983
Mat	37054	41175	53.5	67.8	66.1	84.1	166.9	113.0	17.9	8.5	-13,075
Kukës	47667	51656	59.4	67.8	66.3	83.6	170.4	110.7	32.9	6.5	-29,174
Tropojë	16834	24271	55.0	68.5	62.8	82.9	168.2	117.3	21.4	10.5	-12,965
Gjirokastër	35255	38677	45.8	61.6	67.0	87.2	163.9	117.2	23.3	8.5	498
Përmet	16445	22588	44.0	65.1	71.2	86.6	141.2	118.5	18.1	4.5	-6,118
Tepelenë	20472	28282	48.5	67.3	64.0	83.7	180.9	118.3	19.9	10.5	-8,792
Korçë	115806	127614	45.2	61.0	74.0	88.6	136.7	111.8	21.7	8.7	-10,474
Kolonjë	11037	14545	43.9	62.8	66.0	87.3	169.8	117.4	20.3	5.3	-3,946
Pogradec	45059	40798	50.3	64.2	65.7	86.3	174.4	111.8	28.5	8.6	-3,175
Vlorë	92887	103526	45.0	64.4	66.3	87.8	160.2	114.7	27.4	12.4	4,478
Sarandë	28856	51748	43.1	64.2	64.4	86.9	184.8	115.0	20.0	7.7	2,602

Burimet: Regjistrimi i popullsisë në 1989 dhe 2001.

Regjistrimi i 1989: meshkujt 15-59 vjeç, femrat 15-54 vjeç.

Regjistrimi i 2001: meshkuj e femra 15-64 vjeç (përfshirë këtu edhe 4,136 punëtorë më të moshuar -65+).

Tabela 33: Treguesit e krahut të punës. Rrethi i Tiranës, 1989 dhe 2001.


	1989			2001			Ecuria		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Të punësuar	174892	92539	82353	175877	110131	65746	985	17592	-16607
Të papunë	24897	10505	14392	63724	29802	33922	38827	19297	19530
Popullsia ekonomikisht aktive	199789	103044	96745	239601	139933	99668	39812	36889	2923
Popullsia ekonomikisht joaktive	25166	14614	10552	100163	28812	71351	74997	14198	60799
Potencialisht aktivë	224955	117658	107297	339764	168745	171019	114809	51087	63722
Koefficienti i aktivitetit (%) 1	88.8	87.6	90.2	70.5	82.9	58.3			
Koefficienti i punesimit (%) 2	77.7	78.7	76.8	51.8	65.3	38.4			
Koefficienti i papunësisë (%) 3	12.5	10.2	14.9	26.6	21.3	34.0			

Burimet: Regjistrimi i popullsisë në 1989 dhe 2001.

Regjistrimi i 1989: meshkujt 15-59 vjeç, femrat 15-54 vjeç.

Regjistrimi i 2001: meshkuj e femra 15-64 vjeç

Figura 13. Piramida e moshës e popullsisë në moshë pune. Rrethi i Tiranës, 1989 dhe 2001.



qarta strukturore, pasi flitet për një ekonomi që bazohet mbi punën e kryer nga burrat (Tabela 33), dhe, në mënyrë të veçantë, të moshës 40 vjeç e lart (Figura 13).

Është, gjithashtu, për t'u vënë në dukje që shënohet një shtim në numrin e adoleshentëve (15-19) të punësuar, mesa duket si rrjedhojë e migrimit të të rinjve nga qendrat rurale, meqenëse bilancet migratore për këto moshë janë pozitive. Ndër të rinjtë nën 20 vjeç, është shtuar numri i atyre të zënë në punë si në zonat urbane, ashtu dhe rurale të Rrethit të Tiranës, ndërsa numri i grave ka shkuar në zbritje në zonat rurale, por në rritje në qendrën urbane. Në këtë mënyrë, të rinjtë e kësaj moshe kanë migruar në të dyja drejtimet: drejt fshatit, ku ndoshta janë marrë me punë fizike dhe nëpër ferma, dhe drejt qytetit. Gratë e reja, në të kundërt, kanë prirje të zhvendosen drejt qyteteve të vogla dhe të mëdha në kërkim të punëve në sektorin e shërbimeve.

4.4.2 Rrethi i Tropojës.

Nuk teprohet po të thuhet që në krahasim me 1980 ekonomia e Tropojës funksionon me një ritëm të ngadaltë. Ndërkohë që numri i popullsisë që ka mundësi të jetë ekonomikiisht aktive është pakësuar me rreth një të tretën, numri i vendeve të punës është përgjysmuar (Figura 14). Koefficientët e papunësisë janë dyfishuar dhe niveli i punësimit në radhët e femrave është i ulët (vetëm 32.5% e grave me aftësi për punë rezultojnë të jetë të punësuar) dhe ndeshet ndër to pavarësisht nga gjendja civile e tyre (Tabela 34).

Për më tepër, ky rreth ka nivelin më të ulët të punësimit në të gjithë Shqipërinë. Emigrimi i banorëve të Tropojës ka pasur një ndikim, veçanërisht, negativ mbi ecurinë e tregut të punës në këtë rreth. Rënia më e madhe në numrin e të punësuarve preku më së shumti popullsinë aktive me moshë të re, veçanërisht gratë e reja: numri ekonomikiisht aktiv i grupmoshës 20-39 vjeç u përgjysmua. Shifra e të

Tabela 34: Treguesit e krahut të punës. Rrethi i Tropojës, 1989 dhe 2001.

	1989			2001			Ecuria		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Të punësuar	17992	9781	8211	7992	5196	2796	-10000	-4585	-5415
Të papunë	2117	1076	1041	2584	1436	1148	467	360	107
Popullsia ekonomisht aktive	20109	10857	9252	10576	6632	3944	-9533	-4225	-5308
Popullsia ekonomisht joaktive	4162	2372	1790	6258	1607	4651	2096	-765	2861
Potencialisht aktivë	24271	13229	11042	16834	8239	8595	-7437	-4990	-2447
Koeficienti i aktivitetit (%) 1	82.9	82.1	83.8	62.8	80.5	45.9			
Koeficienti i punesimit (%) 2	74.1	73.9	74.4	47.5	63.1	32.5			
Koeficienti i papunesisë (%) 3	10.5	9.9	11.3	24.4	21.7	29.1			

Burimet: Regjistrimi i popullsisë në 1989 dhe 2001.


Regjistrimi i 1989: meshkujt 15-59 vjeç, femrat 15-54 vjeç.

Regjistrimi i 2001: meshkuj e femra 15-64 vjeç

punësuarve u pakësua me 66% ndër gratë dhe me 47% ndër burrat. Transformimi i karakterit të krahut të punës lidhet qartësisht me statusin emigrator të Tropojës, i cili është një fakt përfaqësues i gjendjes së Shqipërisë veri-lindore. Emigrimi i më të rinjve nuk ka rritur mundësitë e punësimit për personat që nuk migruan. Pjesa dërrmuese e banorëve

punojnë në fermat e tyre dhe madhësia e tokave bujqësore nuk është mjaftueshmërisht e madhe sa të thithë forcën shtesë të punës (UNICEF, 2000).

Figura 14. Piramida e moshës e popullsisë në moshë pune. Rrethi i Tropojës, 1989 dhe 2001.





4.4.3 Rrethet Sarandë dhe Delvinë.

Saranda dhe Delvina, të vendosura në jug të Shqipërisë, ndodhen në të njëjtën gjendje, me një pakësim të theksuar të popullsisë në moshë pune dhe të krahut të punës. Numri i grave ekonomisht aktive të grup-moshës 20-29 vjeç u pakësua gjashtë herë midis viteve 1989 dhe 2001. Humbja e popullsisë aktive ishte më e madhe në zonën rurale, (-67%), sesa në pjesët urbane të këtyre rretheve (-38%). Dhe përsëri kjo dukuri shpjegohet me flukset e migrimit. Duket se emigrimi ka pasur një ndikim mbi shpërndarjen hapësinore të punëtorit në moshë të re: numri i popullsisë aktive të zënë në punë të grup-moshës 15-19 vjeç ra me 60% në zonat rurale të rretheve, duke ruajtur të njëtin nivel nëpër qytete. Në krahasim me rastin e Tropojës, emigrimi në këto rrethe nuk u shoqërua me një degradim të madh të ekonomisë, e shprehur kjo në përqindjen e papunësisë: kjo përqindje është më pak se 20% në 2001, nën nivelin kombëtar. Në përfundim, këta tre shembuj tregojnë qartë që migrimi dhe shpërndarja

hapësinore e popullsisë kanë një ndikim të fortë jo vetëm mbi ecurinë demografike në rrethe, por edhe mbi zhvillimin ekonomik të tyre. Pavarësisht nga përqendrimi dhe rritja në numër e krahut të punës të mbizotëruar nga gjinia femërore dhe plakja e popullsisë së aftë për punë, veprimtaria ekonomike ka rënë me 18% midis viteve 1989 dhe 2001. Këto dy dukuri janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën: vështirësitë ekonomike (përqindja e papunësisë u rrit në 16%) ka nxitur një numër të madh të rinjsh, kryesisht burra, të emigrojnë jashtë vendit, nga njera anë, dhe të detyrojnë gratë të tërhiqen nga veprimtaria ekonomike, nga ana tjetër. Në këtë mënyrë, tiparet cilësore të krahut shqiptar të punës janë bërë gjithmonë e më shumë homogjene: në fakt ne vumë re një bipolaritet të migrimit, nga njera anë të një migranti me aftësi të larta profesionale, dhe nga ana tjetër, të një migranti me nivel të ulët arsimor.

Tabela 35: Treguesit e krahut të punës. Rrethet e Sarandës dhe Delvinës, 1989 dhe 2001.



	1989			2001			Ecuria		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Të punësuar	41520	22749	18771	14317	9749	4568	-27203	-13000	-14203
Të papunë	3464	1313	2151	3540	1881	1659	76	568	-492
Popullsia ekonomisht aktive	44984	24062	20922	17857	11630	6227	-27127	-12432	-14695
Popullsia ekonomisht joaktive	6764	4040	2724	10999	3071	7928	4235	-969	5204
Potencialisht aktive	51748	28102	23646	28856	14701	14155	-22892	-13401	-9491
Koeficienti i aktivitetit (%) 1	86.9	85.6	88.5	61.9	79.1	44.0			
Koeficienti i punësimit (%) 2	80.2	81.0	79.4	49.6	66.3	32.3			
Koeficienti i papunësisë (%) 3	7.7	5.5	10.3	19.8	16.2	26.6			

Burimet: Regjistrimi i popullsisë në 1989 dhe 2001.

Regjistrimi i 1989: meshkujt 15-59 vjeç, femrat 15-54 vjeç.

Regjistrimi i 2001: meshkuj e femra 15-64 vjeç

Figura 15. Piramida e moshës e popullsisë në moshë pune. Rrethi i Sarandës dhe Delvinës, 1989 dhe 2001.



Burimi: Regjistrimi i popullsisë të 1989 dhe 2001

5

Përfundimet dhe Gjetjet Kryesore.

Një dhjetëvjeçar pas tranzicionit politik në Shqipëri, që e kthen vendin nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi të tregut të lirë, pamja e Shqipërisë ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Thyerja e izolacionizmit politik dhe ekonomik, i imponuar nga regjimi komunist, solli në jetë probleme të shoqërisë dhe me karakter ekonomik, të cilat kontribuan në shtimin e lëvizshmërisë së popullsisë në hapësirë.

Ngjarjet e turbullta politike që pasuan procesin e demokratizimit, kompromentuan zhvillimin e qendrueshëm ekonomik dhe, për rrjedhojë, e zhytën një pjesë të madhe të shoqërisë në varfëri. Për shkak të infrastrukturës së vjetëruar të industrisë shqiptare (industria e rëndë dhe minerare), prodhimi industrial u pakësua në mënyrë të konsiderueshme pas tranzicionit, madje në disa raste këto industri u detyruan të mbyllen.

Privatizimi i bujqësisë rriti prodhimin bujqësor nga njera anë, por krijoi edhe një sërë problemesh – si copëtimin e tokës në zonat periferike apo malore – nga ana tjetër. Punimi i këtyre copëzave të tokës nuk mundësoi mbijetesën e familjeve dhe i detyroi ato të kërkojnë burime të ndryshme të të ardhurave. Pra, këto transformime politike dhe ekonomike patën një ndikim të konsiderueshëm mbi demografinë shqiptare. Analiza e regjistrimeve

të popullsisë tregon se në periudhën midis 1989 e 2001 u largua nga vendi rreth 20% e popullatës, ndërsa 8% u zhvendos në një tjetër prefekturë. Meqenëse procesi i demokratizimit u ofroi shqiptarëve mundësi më të mira për migrim dhe për shkak të moshës së re të popullsisë në vitin 1989, për herë të parë në shumë dhjetëvjeçarë u vu re një rënie demografike. Megjithatë, jo të gjitha rrethet e Shqipërisë e përjetuan këtë migrim dhe evolucion demografik me të njëjtin intensitet.

Ndërkohë që zhvendosjet e para brendapërbrenda vendit midis prefekturave u drejtuan për nga qendra kryesore e vendit – zonat e rëndësishme ekonomike dhe bregdetare të Tiranës dhe Durrësit thithën 72% të kësaj zhvendosjeje – si dhe për në qendrat e tjera dytësore apo porte detare, veçanërisht në Fier, Vlorë dhe Lezhë, disa prefektura të tjera, veçanërisht ato të lokalizuara në thellësi të veriut, humbën deri në 34% të popullsisë së tyre të regjistruar në 1989, për shkak të dukurisë së migrimit të brendshëm.

Rrethet jugore shfaqin një nivel të moderuar të migrimit. Në fakt, banorët e veriut migruan kryesisht brenda vendit, ndërsa ata që vinin nga zonat jugore apo qendrore kishin prirje për t'u larguar jashtë vendit. Migrimi ndërkombëtar shpesh mendohet të jetë një vazhdimësi e një lëvizjeje të brendshme më të hershme, pasi destinacionet kryesore të




migrimit të brendshëm përputhen me pikat kryesore nga niset migrimi ndërkombëtar. Është po ashtu me interes të vihet në dukje selektiviteti progresiv i flukseve të brendshme. Migrimi nuk është homogjen nga pikëpamja e gjinisë, e moshës dhe e nivelit arsimor: ndërkohë që flukset e brendshme migratore nga rrethet veriore të vendit përfshinë të gjitha grupet e popullsisë, migrimet nga qendrat dytësore karakterizohen nga një strukturë femërore, e re në moshë dhe e arsimuar. Kjo provë, e plotësuar dhe nga fakti që djemtë e rinj mbizotëronin në strukturën e migrimit ndërkombëtar, krijoi një model specifik migrimi gjinor që karakterizoi periudhën 1989-2001, si dhe një hipotezë të një strategjie komplekse familjare.

Megjithëse ne nuk arritëm të kalonim në një analizë gjatësore (horizontale) të regjistrimeve të popullatës, metoda transversale solli në dritë një sërë pasojash të proceseve të migrimit, si mbi popullsinë ashtu dhe mbi tregun e punës. Ekzodi masiv e ka modifikuar në mënyrë të konsiderueshme strukturën moshore të popullsisë midis viteve 1989 dhe 2001. Meqenëse jashtë vendit kanë migruar kryesisht djemtë e rinj, duke sjellë për rrjedhojë një rënie të shifrave të lindshmërisë në Shqipëri, popullsia me moshë 35 vjeç e lart fitoi një peshë të rëndësishme specifike. Për këtë arsye, popullsia shqiptare ka hyrë tashmë në procesin e plakjes së saj, aq të njohur për Europën.

Ky evoluim ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme mbi krahun e punës. Për shkak të moshës së re të migrantëve, është kompromentuar për të ardhmen rinovimi i këtij faktori ekonomik. Gjendja është veçanërisht kritike në rrethet periferike të ekonomisë, pra në veri dhe në jug. Zhvendosjet e brendshme të popullsisë kanë shkaktuar urbanizimin e vendit. Forcat ekonomike janë përqendruar shumë më tepër në Qendër dhe në Bregdet.

Tregu i punës i këtyre rretheve nuk arriti të integrojë të ardhurit rishtaz. Për rrjedhojë, dukuria e shtimit të papunësisë nxiti të rinjtë që të emigrojnë jashtë vendit dhe shkaktoi një tërheqje të grave nga veprimtaria ekonomike. Vendi mbeti i varur nga rrogat e atyre që punonin jashtë, si dhe nga investimet e huaja.

Migrimi shqiptar, po ashtu, karakterizohet nga migrimi i trurit. Meqenëse migrantët ishin ose tepër të kualifikuar ose me arsim të ulët, niveli arsimor i popullsisë që mbeti në vendin e saj u bë gjithmonë e më shumë homogjen dhe i nivelit mesatar arsimor. Si pasojë, vendi humbi pjesën më inovative të popullsisë. Për këtë arsye, zhvillimi i mëtejshëm i vendit varet nga aftësia e tij për të ri-integruar këto elemente inovative, si dhe nga aftësia për të përfituar nga njohuritë e tyre të reja apo nga të hollat që dërgojnë. Për shkak të përqendrimit të flukseve të brendshme migratore, që tregojnë më së miri nivelin e ulët të integritit rajonal në Shqipëri, reformat strukturore duhet të sjellin një zhvillim më të ekuilibruar, si dhe një barazi relative midis rretheve në të ardhmen.



Bibliografia

- Barjaba Kosta, Dêrvishi Zydi, Perrone Luigi** (1992). "L'Emigrazione Albanese. Spazi, tempi e cause." Studi Emigrazione/Etudes Migrations **29**(107): 513-537.
- Barjaba Kosta, Perrone Luigi** (1996). Forme e Grado di Adattamento dei Migrati di Cultura Albanese in Europa. Naufragi Albanesi, Studi, Ricerche e Riflessioni sull'Albania. K. e. a. **E. Barjaba**. Roma, Sensibili alle Foglie: 123-168.
- Bribosia Emmanuelle, Rea Andrea** (2002) *Les nouvelles migrations – un enjeu européen*. Ed. Complexe : Bruxelles, 183-205.
- DE RAPPER Gilles, DESLONDES O. and ROUX M.** « Dimance à Miras, lundi à Dipotamia – La frontière albanico-grecque dans la région de Bilisht et de Kastoria », in *Cahiers d'études sur la Méditerranée orientale et le monde turco-iranien* ; No 29 ; p.199-223.
- INSTAT** (1993) La situation démographique en Albanie – Institut de la Statistique – Tirana, 8p.
- INSTAT** (2002) The population of Albania in 2001, Tirana : **INSTAT**.
- INSTAT** (2000) Indicators by prefectures 1996-1999, Tirana : **INSTAT**.
- INSTAT** (to be published) Labour Force, Employment and Unemployment, Tirana: **INSTAT**.
- King Russell L., Iosifides Theodoros, Myrivili Lenio** (1998). "A migrant's story: From Albania to Athens." Journal of Ethnic and Migration Studies **24**(1): 159-176.
- LE BRAS Hervé** (1991) « *L'impact démographique des migrations d'après-guerre dans quelques pays de l'OCDE* », in Les migrations. Aspects démographiques edited by **OECE**, Paris : **OECD**, 117-29.
- LEIBICH André** (1997) *Les minorités nationales en Europe centrale et occidentale*, George, Collection Europe, P. 70-74.
- GEDESHI Ilir, DITTER Jean-Guillaume**(2000) « Dix ans de transition économique albanaise de l'autarcie à l'extraversion », in *Cahiers d'études sur la Méditerranée orientale et le monde turco-iranien* ; No 29 ; p.121-138.
- KULE Dorhi, MANCELLARI Ahmet, PAPAGANOS Harry** et al. (2002), « The causes and Consequences of Albanian Emigration during Transition: Evidence from Micro Data », in *International Migration Review*, vol. 36, Nr. 1, p. 229-239.

-
- Massey Douglas S.**, et al. (1993). "Theories of International Migration: A Review and Appraisal." *Population and Development Review* 19 (3): 431-466.
- MOROKVASIC-MULLER Mirjana** (2000), « Balkans : les exclus de l'élargissement » in *Hommes et Migration* ; No 1230 ; p. 81-93.
- OECD** (1999) *Trends in International migration*; p.147-150. Paris: OECD
- OIM** (1995) *Profiles and motives of potential migrants from Albania*. Geneva: **OIM**
- RAVENSTEIN E.G.** (1885), The laws of migration, *Journal of the Statistical Society*, London, 48(2), 167-227.
- PAPAPANAGOS Harry, SANFEY Peter** (2001) « Intention to emigrate in transition countries: the case of Albania » in *Journal of Population Economics*; No 14 –2001; p.491-504.
- Sardon Jean-Paul** (2000) « L'évolution démographique des Balkans depuis la fin de la décennie 1980 », in *Population*, 2000(4-5), 765-786.
- TREICHLER Volker** (2000) *Stabilization Policies and Structural Reforms in Albania Since 1997 – Achievements and Remaining Changes*, IMF Policy Discussion Paper.
- UNICEF** (2000) *Assessment of Social & Economic Conditions of Districts in Albania*, Albania. Tirana: **UNICEF**.
- UNITED NATIONS** (2002) *World Population Prospects*. New York: United Nations.
- UNITED NATIONS DEVELOPMENT PROGRAM** (2000), *Economic and Social Security. Emigration and Migration*. New York: United Nations

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikës

Migration in Albania=Migracioni në Shqipëri / Instituti i Statistikës.

– Tiranë: INSTAT, 2004.

66; 21 x 29.7 cm.

ISBN 99927-973-7-1

311.3 : 314.7(496.5) "1989/2001"

314.7(496.5) "1989/2001" (083.41)